



LIGJ
Nr. 43/2015

PËR SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendos rregullat lidhur me:

- a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
- b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
- c) dhënien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;
- ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;

¹ Ky ligj është përafruar plotësisht me direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, e cila shfuqizon direktivën 2003/54/KE”, numri CELEX: 32009L0072, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 211, datë 14.8. 2009, faqe 55 - 93.

d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë elektrike.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksesi i palëve të treta” është e drejta e të gjithë përdoruesve të sistemit për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, bazuar në kushte të përcaktuara dhe të publikuara, në përputhje me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit, kundrejt tarifave të miratuara nga ERE.

2. “Aktivitete të energjisë elektrike” janë aktivitetet ekonomike që lidhen me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike, si dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

3. “Balancim” është tërësia e proceseve, nëpërmjet të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të përcaktuar të qëndrueshmërisë së tij.

4. “Bordi” është organi vendimmarrës i ERE-s, i emëruar sipas këtij ligji.

5. “Burime të rinovueshme të energjisë” janë burimet e rinovueshme jofosile të energjisë, si era, energjia diellore, energjia aerotermale, energjia gjeotermale, energjia hidrotermale dhe oqeanike, energjia hidrike, biomasa, gazi i përfutur prej vendgroposjes së mbetjeve, gazi i përfutur prej impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së rinovueshme.

6. “Burim rezervë” është një burim dytësor i furnizimit me energji elektrike, që nuk është i lidhur me sistemin elektroenergetik.

7. “Central prodhues” është një tërësi godinash dhe impiantesh të caktuara, të cilat kanë si destinacion bazë prodhimin e energjisë elektrike.

8. “Certifikim” është procedura, e cila përcakton përputhshmërinë me kushtet që sigurojnë pavarësinë dhe ndarjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si një parakusht për përcaktimin dhe miratimin e këtij operatori.

9. “Derivativ elektrik” është një instrument financiar që mund të përdoret nga pjesëmarrësit e



tregut të energjisë elektrike si mjet sigurie ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg.

10. “Detyrimi i shërbimit publik” është detyrimi që vendoset ndaj një të licencuari për kryerjen e një shërbimi publik, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, efikasitetin e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.

11. “Dispeçerimi” është veprimtaria e kryer nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, që konsiston në menaxhimin në kohë reale të flukseve të energjisë elektrike dhe zbatimin e masave të nevojshme për operimin e bashkërenduar të komponentëve të sistemit elektroenergjetik, përfshirë centralet prodhuese, rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse të nevojshme për operimin e sistemit.

12. “Eficienca e energjisë/menaxhimi i kërkesës” është përdorimi i energjisë elektrike në mënyrë të tillë që të ndikojë në reduktimin në sasi dhe në kohë piku të konsumit të energjisë elektrike.

13. “Eksport i deklaruar” është dispeçerimi i energjisë elektrike që i korrespondon sasisë së energjisë elektrike që lëvrohët njëkohësisht në një vend tjetër si import i deklaruar mbi bazën e një marrëdhënieje kontraktuale.

14. “ENTSO-e (*European Network of Transmission System Operators for Electricity*)” është Rrjeti European i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

15. “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për sektorin e gazit natyror.

16. “Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbajtjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë

ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

17. “Furnizim” është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

18. “Furnizues” është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.

19. “Furnizues i mundësisë së fundit” është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.

20. “I licencuar” është një person i pajisur me licencë për aktivitete të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

21. “Import i deklaruar” është energjia elektrike që lëvrohët në një vend, e cila, në të njëjtën kohë, dispeçerohët si eksport i deklaruar nga një vend tjetër.

22. “Interkonektor” është një linjë transmetimi e ndërtuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose një palë e tretë, e cila kalon nëpërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe të një vendi tjetër dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të të dyja vendeve.

23. “Interkonektor i ri” është një interkonektor i papërfunduar dhe/ose i përfunduar por i pakomisionuar, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

24. “Klient” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

25. “Klient familjar” është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale.

26. “Klient fundor” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

27. “Klient jofamiljar” janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.

28. “Klient i vogël jofamiljar” është një person fizik apo juridik, i lidhur në nivel tensioni 0,4 kV, i cili blen energji për përdorim në mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij dhe jo për qëllim rishitjeje.



29. “Klient shumice” është një person fizik ose juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitje brenda ose jashtë sistemit të vendit ku është regjistruar.

30. “Klient në nevojë” është një klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

31. “Kodet e Rrjetit” janë Kodi i Transmetimit dhe Kodi i Shpërndarjes.

32. “Kodi i Shpërndarjes” është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosin kushtet e shërbimit që ofrohen nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

33. “Kodi i Transmetimit” është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-e.

34. “Kodi i Matjes” është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.

35. “Kontrata e furnizimit” është një kontratë për furnizimin me energji elektrike, por që nuk përfshin derivativët e energjisë elektrike.

36. “Kontratë e plotë furnizimi” është kontrata e furnizimit, e cila përfshin përgjegjësitë e përdorimit të rrjetit të transmetimit ose shpërndarjes.

37. “Kontrata e furnizimit me ndërprerje” është kontrata e furnizimit, e cila i jep të drejtën Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të ndërpresë përkohësisht furnizimin me energji elektrike të klientit fundor, në përputhje me kushtet e shërbimit, të përcaktuara në Kodet e Rrjetit dhe aktet e tjera rregullatore.

38. “Kontroll” janë të drejtat, kontratat ose çdo mënyrë tjetër, që, veç e veç apo në mënyrë të kombinuar, duke u bazuar në një rrethanë apo në një ligj, i japin një subjekti mundësinë e ushtrimit të një ndikimi përcaktues mbi një shoqëri të caktuar në veçanti nëpërmjet:

a) pronësisë ose së drejtës për të përdorur të gjitha ose pjesë të aseteve të kësaj shoqërie;

b) të drejtave apo kontratave, të cilat japin një ndikim të theksuar në hartimin, votimin apo vendimmarrjen e organeve të asaj shoqërie.

39. “Kapacitet i kufizuar” është situata në të cilën një linjë interkoneksioni nuk mund të sigurojë transmetimin e të gjithë fluksit fizik të energjisë elektrike që rezulton nga kërkesa e pjesëmarrësve të tregut, për shkak të mungesës apo reduktimit të kapaciteteve të linjave të interkoneksionit dhe/ose të sistemit kombëtar të transmetimit.

40. “Licencë” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

41. “Linjë direkte” është një linjë elektrike që lidh një prodhues të veçuar nga rrjeti me një klient të veçuar nga rrjeti, brenda ose jashtë vendit, ose një linjë elektrike që lidh një prodhues me një shoqëri furnizimi, e cila furnizon me energji elektrike drejtpërdrejt ambientet, filialet ose klientët e saj.

42. “Matës inteligjent” është një pajisje elektronike që regjistron në kohë reale të dhënat e konsumit të energjisë elektrike dhe komunikon këtë informacion, të paktën çdo ditë, tek operatori i sistemit për qëllime të monitorimit dhe të faturimit.

43. “Menaxhimi i kërkesës” janë masat që ndërmerren, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të rrjetit, si reduktimi i ngarkesës ose ndërprerja e furnizimit, për të cilat është rënë dakord paraprakisht midis palëve.

44. “Ministria” është ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë.

45. “Modeli i tregut të energjisë elektrike” është një dokument i përgatitur dhe i miratuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili përcakton marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të energjisë elektrike.

46. “Operatori i pavarur i matjes” është një shoqëri me eksperiencë në matjen e energjisë për kryerjen dhe menaxhimin e sistemit të matjes.

47. “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” ose “OSSH” është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe,



kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe efikasitetin e energjisë.

48. “Operator i Sistemit të Transmetimit” ose “OST” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

49. “Operator i Rrjetit” është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes.

50. “Operimi i tregut” është veprimtaria që kryen operatori i tregut lidhur me menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e raporteve financiare për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e rregullave të tregut.

51. “Operatori i tregut” është struktura përgjegjëse e licencuar për operimin, organizimin dhe menaxhimin e tregut të energjisë elektrike.

52. “Pagesa rregullatore” është pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike paguajnë për llogari të ERE-s, për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij. Pagesa rregullatore për çdo shoqëri të licencuar miratohet çdo vit nga ana e ERE-s në bazë të një metodologjie të miratuar nga ky institucion.

53. “Pagesa e licencës” është pagesa e përcaktuar nga ERE për dhënien e licencave për ushtrimin e një aktiviteti në sektorin e energjisë elektrike.

54. “Pala përgjegjëse për balancimin” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij, përgjegjës përballë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për disbalancat e krijuara gjatë operimit të tij.

55. “Palët e Komunitetit të Energjisë” janë palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Bashkimi European dhe shtetet anëtare të tij.

56. “Person” është një person fizik ose juridik.

57. “Përdoruesit e sistemit” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose

furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes.

58. “Përgjegjësia e balancimit” është një detyrim i pjesëmarrësve të tregut për balancimin e prodhimit, konsumit, proceseve të shitblerjes të energjisë elektrike, në përputhje me programin e pranuar, duke qenë përgjegjës financiarisht kundrejt Operatorit të Sistemit të Transmetimit për sistemin e disbalancave të krijuara.

59. “Ofrues i shërbimit të balancimit” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike, që siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, në bazë të një kontrate për pjesëmarrje në tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit të sistemit elektrik.

60. “Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike” është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatori i tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

61. “Planifikim afatgjatë” është planifikimi i nevojave për investime në kapacitetet prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse në baza afatgjata, me qëllim përmbushjen e kërkesës së sistemit për energji elektrike dhe sigurinë e furnizimit të klientëve.

62. “Prodhimi i energjisë” është procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga burime primare të energjisë.

63. “Prodhues” është një person i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike.

64. “Prodhues i lidhur në shpërndarje” është një prodhues, centrali i të cilit është i lidhur në sistemin e shpërndarjes.

65. “Prodhues me përparësi i energjisë elektrike” janë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit për energjitë e rinovueshme të energjisë elektrike.



66. “Rregullat e tregut” janë rregulla të hollësishme, të cilat përcaktojnë mënyrën e operimit dhe menaxhimit të tregut, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, rregullat për llogaritjen e disbalancës për palët përgjegjëse të balancimit, rregullat për përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të balancimit në rast të disbalancimit, si dhe çështje të tjera lidhur me funksionimin e tregut.

67. “Rrjeti e energjisë elektrike” është tërësia e linjave, nënstationeve, pajisjeve të transmetimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë linjat e interkoneksionit.

68. “Siguri” është siguria e furnizimit dhe garantimit të energjisë elektrike, si dhe sigurimi teknik.

69. “Siguruesi i shërbimeve të balancimit” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike, i cili siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, bazuar në kontratën për pjesëmarrjen në tregun e balancimit, sipas rregullave përkatëse të sigurimit të balancimit të sistemit të energjisë elektrike.

70. “Sistemi i energjisë elektrike” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet elektrike, linjat elektrike, nënstationet dhe pajisjet e transmetimit e shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët.

71. “Sistemi i shpërndarjes” është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.

72. “Sistemi i transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshijn midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

73. “Shërbimi i balancimit” është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

74. “Shërbime ndihmëse” janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

75. “Shërbim publik” është shërbimi që sigurohet nga një i licencuar që operon në sektorin e energjisë elektrike, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, efikasitetin e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.

76. “Shërbim universal i furnizimit” është një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t’u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.

77. “Shoqëri elektroenergetike” është një person fizik ose juridik që kryen të paktën një nga veprimtaritë: prodhim, transmetim, shpërndarje, furnizim ose blerje të energjisë elektrike, i cili është përgjegjës për detyrimet tregtare, teknike ose të mirëmbajtjes, lidhur me këto veprimtari, pa përfshirë klientët fundorë.

78. “Shoqëri e integruar e energjisë elektrike” është një shoqëri e licencuar në sektorin e energjisë elektrike, e integruar vertikalisht ose horizontalisht.

79. “Shoqëri e integruar horizontalisht” është një shoqëri, e cila kryen të paktën një nga veprimtaritë: prodhimin për shitje, transmetimin, shpërndarjen ose furnizimin e energjisë elektrike, si dhe një aktivitet tjetër jashtë fushës së energjisë elektrike.

80. “Shoqëri e integruar vertikalisht” është një shoqëri ose grup shoqërish të licencuara në sektorin e energjisë elektrike, ku i njëjti person ose persona, ushtrojnë kontroll mbi këto shoqëri në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe ku shoqëria ose grupi i shoqërive kryejnë të paktën një prej veprimtarive të transmetimit ose shpërndarjes, si dhe të paktën një prej veprimtarive të prodhimit ose furnizimit me energji elektrike.

81. “Shpërndarje” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.



82. “Transit i deklaruar” është sasia e energjisë elektrike që vjen nga një vend tjetër, e cila nuk konsumohet në vend, por kalon në një vend të tretë.

83. “Tregu i balancimit” është menaxhimi, i bazuar në treg, i funksioneve të balancimit të sistemit të energjisë elektrike, i operuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

84. “Tregu i organizuar i energjisë elektrike” është platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës dite.

85. “Tregu i energjisë elektrike” është një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive, përfshirë edhe derivativët e energjisë elektrike, nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në periudha afatgjata dhe afatshkurtra.

86. “Tregtar” është çdo person juridik, i cili kryen veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

87. “Tregtimi i energjisë elektrike” është procesi që kryhet nga një person juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitjen e saj brenda ose jashtë sistemit të vendit ku kryen veprimtarinë.

88. “Vetëprodhues” është një person që prodhon energji elektrike, i cili konsumon kryesisht për nevojat e veta pjesën më të madhe të energjisë së prodhuar.

PJESA E DYTË

POLITIKAT E SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 4

Politikat e sektorit të energjisë elektrike

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikën e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike të Shqipërisë, në përputhje me politikën e zhvillimit ekonomik dhe sektorët e tjerë të vendit.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë:

a) harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë;

b) harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë;

c) vlerëson nevojën e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese dhe fuqizimin e rrjeteve, në përputhje me programet afatmesme, duke marrë parasysh:

i) bilancet e përgjithshme të pritshme të energjisë elektrike në të ardhmen;

ii) sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike;

iii) koston, duke përfshirë çdo mekanizëm të minimizimit të saj, për këto kapacitete të reja prodhuese;

ç) mbikëqyr zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit energjetik, në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Neni 5

Të dhëna dhe informacione për bilancin e energjisë elektrike

1. Çdo person fizik ose juridik që prodhon, transmeton, shpërndan, importon, eksporton ose furnizon energji elektrike është i detyruar të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë të dhëna lidhur me veprimtarinë e tij, me qëllim hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit energjetik dhe komunikimin me institucionet e specializuara, në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, si dhe përgatitjen dhe publikimin e bilancit vjetor energjetik.

2. Ministri përgjegjës për energjinë miraton mënyrën dhe formatin e raportimit të të dhënave.

3. Ky nen nuk kufizon të drejtat e ERE-s dhe të institucioneve të tjera përgjegjëse për statistikën, për akses ndaj të dhënave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi.

PJESA E TRETË

SIGURIA E FURNIZIMIT

Neni 6

Rregullat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim



me institucionet ose entet e tjera që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike, miraton rregullat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, të cilat përfshijnë:

a) masat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike;

b) masat që ndërmerren për rastet kur rrezikohet siguria e furnizimit;

c) masat që ndërmerren për rastet e situatave emergjente;

ç) rolin dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

2. Rregullat për sigurimin e furnizimit me energji elektrike duhet të marrin në konsideratë:

a) rëndësinë e sigurisë së furnizimit të vazhdueshëm me energji elektrike;

b) rëndësinë e një kuadri rregullator transparent dhe të qëndrueshëm;

c) tregun e brendshëm dhe mundësinë e bashkëpunimit ndërkufitar, lidhur me sigurinë e furnizimit me energji elektrike;

ç) nevojën për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, me qëllim ruajtjen e sigurisë së performancës së rrjetit;

d) promovimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme;

dh) nevojën e sigurimit të kapaciteteve transmetuese dhe prodhuese të mjaftueshme rezervë, për të ruajtur qëndrueshmërinë e rrjetit;

e) rëndësinë e inkurajimit të krijimit të një tregu të qëndrueshëm të shitjes me shumicë;

ë) shumëllojshmërinë e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike;

f) rëndësinë e zvogëlimit të efekteve afatgjata ndaj rritjes së kërkesës për energji elektrike;

g) rëndësinë e nxitjes së efikasitetit të energjisë dhe përdorimit të teknologjive të reja, në veçanti lidhur me menaxhimin e kërkesës, burimet e rinovueshme dhe prodhimin prej centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes;

gj) rëndësinë e shmangies së pengesave administrative ndaj investimeve në rrjet dhe kapaciteteve prodhuese.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk duhet të jenë diskriminuese apo të parashikojnë detyrime të paarsyeshme ndaj pjesëmarrësve ekzistues e të rinj të tregut.

4. Pjesëmarrësit e tregut duhet të veprojnë në përputhje me masat dhe rregullat e sigurisë së furnizimit, të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, dhe do të jenë përgjegjës për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në përputhje me veprimtarinë që ushtrojnë.

Neni 7

Siguria e rrjetit dhe cilësia e furnizimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes hartojnë rregulla specifike që përcaktojnë mënyrën e operimit të rrjeteve të tyre, përfshirë kushtet për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit. Gjatë hartimit të tyre, operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes konsultohen me grupet e interesit, vendase dhe të huaja. Rregullat e cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit miratohen dhe monitorohen nga ERE.

2. ERE mbikëqyr mbajtjen e një niveli të përshtatshëm të kapacitetit rezervë teknik të transmetimit prej Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i cili bashkëpunon edhe me operatorët e transmetimit të vendeve fqinje që është i ndërlidhur, me qëllim garantimin e sigurisë së rrjetit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben informacion me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për funksionimin e rrjetit në mënyrë efektive, në kohën e duhur dhe në përputhje me kërkesat operative të përmendura në pikën 1, të këtij neni, si dhe me operatorët e huaj të sistemeve të ndërlidhura të transmetimit.

Neni 8

Balanca midis kërkesës dhe prodhimit

1. Me qëllim ruajtjen e balancës midis kërkesës për energji elektrike dhe sasisë së disponueshme të energjisë, merren masat si më poshtë:

a) ERE përcakton rregulla, që mundësojnë dhe nxitin krijimin dhe funksionimin e një tregu të hapur, për prodhimin, shitjen me shumicë dhe furnizimin.

b) Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron një kapacitet rezervë.

2. Me qëllim ruajtjen e balancës ndërmjet kërkesës për energji elektrike dhe kapacitetit të disponueshëm prodhues, Këshilli i Ministrave merr masa të tjera shtesë, përfshirë, por pa u kufizuar në



masat e mëposhtme:

a) përfshirjen e dispozitave në aktet përkatëse nënligjore që ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe futjen e shoqërive të reja prodhuese në treg;

b) eliminimin e pengesave që ndalojnë përdorimin e kontratave të furnizimit me ndërprerje, sipas udhëzimeve të ENTSO-e;

c) eliminimin e pengesave që ndalojnë përfundimin dhe lidhjen e kontratave me afate të ndryshueshme si për prodhuesit, ashtu edhe për klientët;

ç) nxitjen e përdorimit të teknologjive të menaxhimit në kohë reale të kërkesës, nëpërmjet sistemeve të avancuara të matjes, sipas kërkesës së konsumatorëve;

d) nxitjen e masave të përdorimit eficient të energjisë elektrike;

dh) zbatimin e procedurave konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese për investimet e reja në kapacitetet prodhuese, sipas parashikimeve të nenit 50 të këtij ligji.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit përgatit një parashikim të përgjithshëm afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të kërkesës për energji elektrike dhe burimeve të mundshme të furnizimit, duke marrë parasysh kriteret dhe kërkesat e sigurisë së furnizimit.

PJESA E KATËRT ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)

SEKSIONI I ORGANIZIMI

Neni 9

Organizimi i ERE-s

1. ERE është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit në Shqipëri që drejtohet nga bordi. Bordi përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë.

2. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e ERE-s hartohet e miratohet nga bordi dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit.

Neni 10

Pavarësia e ERE-s

1. ERE është një person juridik publik, i pavarur nga çdo institucion tjetër publik ose privat. Bordi dhe personeli teknik i ERE-s:

a) ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente;

b) veprojnë në mënyrë të pavarur nga interesat e tregut, nga çdo institucion apo subjekt publik ose privat.

2. ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të këtij ligji që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Neni 11

Përzgjedhja dhe emërimi i kryetarit dhe anëtarëve të bordit

1. Kryetari dhe anëtarët e bordit emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Ekspertit Përzgjedhës, në përputhje me pikat 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

2. Kryetari dhe anëtarët e bordit emërohen për një mandat prej 5 vjetësh, me të drejtë riemërimi për një mandat të dytë radhazi.

3. Eksperti Përzgjedhës i bordit përbëhet nga dy përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, përkatësisht, kryetari i komisionit përgjegjës për energjinë dhe kryetari i komisionit përgjegjës për ekonominë dhe nga ministri përgjegjës për energjinë.

4. Jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit apo njërit prej anëtarëve të bordit, Kuvendi publikon njoftimin për vendin vakant. Eksperti Përzgjedhës përzgjedh paraprakisht dy kandidatë që plotësojnë kërkesat e pikës 5 të këtij neni dhe ia propozon Kuvendit të Shqipërisë.

5. Kryetari dhe anëtarët e bordit janë persona që duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Kryetari është një person i shquar në fushën e energjisë. Ai/ajo duhet të ketë të paktën 15 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë;

b) një nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë elektrike dhe të jetë me profesion inxhinier elektrik;



c) një nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e hidrokarbureve dhe të jetë me profesion inxhinier në sektorin e naftës dhe/ose gazit;

ç) dy anëtarët e tjerë, respektivisht njëri me profesion jurist dhe tjetri ekonomist, duhet të kenë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune, prej të cilave të paktën 5 vjet duhet të jetë eksperiencë në sektorin energjetik.

6. Kur vendi i kryetarit të bordit mbetet vakant, anëtari i bordit me kohën më të gjatë në detyrë kryen funksionet e kryetarit deri në emërimin e kryetarit të ri. Vjetërsia llogaritet nga data kur është emëruar si anëtar bordi.

7. Bordi përcakton strukturën organizative të ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të kryetarit, të anëtarëve të bordit, si dhe të personelit teknik. Në përcaktimin e masës së pagës dhe trajtimeve financiare apo jofinanciare të personelit teknik, bordi merr parasysh kushtet e tregut dhe nivelin e pagave në shoqëritë që kontrollohen në sektorin që mbulon.

Neni 12

Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i kryetarit dhe anëtarëve të bordit

1. Kryetari dhe anëtarët e bordit shkarkohen nga detyra nga Kuvendi vetëm në rast se:

a) veprojnë në kundërshtim me parimin e pavarësisë apo janë në konflikt interesi;

b) dënohen për kryerjen e një veprë penale me një vendim gjykatë të formës së prerë.

2. Kryetari dhe anëtarët e bordit lirohen nga detyra nga Kuvendi kur:

a) japin dorëheqjen;

b) kandidojnë për t'u zgjedhur deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;

c) kandidojnë për t'u zgjedhur në organet e një njësie vendore;

ç) bëhen të paaftë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e ERE-s për një periudhë mbi 6 muaj;

d) mungojnë në detyrë, pa shkak, për një periudhë mbi një muaj.

3. Para se të shkarkohen, kryetarit dhe anëtarit të bordit të ERE-s u jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tyre para komisioneve të Kuvendit. Vendimi për të liruar dhe shkarkuar kryetarin apo anëtarët duhet të jetë i bazuar në ligj

dhe të jetë i arsyetuar për shkaqet që çojnë shkarkimin e tyre.

4. Kryetari dhe anëtarët e bordit, të shkarkuar nga detyra, nuk kanë të drejtë të rizgjidhen më në bordin e ERE-s.

5. Shkarkimi ose lirimi i kryetarit dhe anëtarëve të bordit, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, bëhet me miratim të Kuvendit të Shqipërisë, me propozim të Ekipit Përzgjedhës.

Neni 13

Kryetari i bordit

1. Kryetari i bordit është administratori i përgjithshëm i ERE-s. Ai është përgjegjës për administrimin e institucionit dhe drejtimin e mbledhjeve të bordit.

2. Në rastet kur kryetari i bordit mungon në detyrë, ai autorizon një nga anëtarët e bordit që të ushtrojë funksionin e kryetarit gjatë kësaj periudhe.

Neni 14

Personeli teknik dhe këshilltarët

1. Personeli teknik ndihmon bordin në kryerjen e detyrave të tij. Personeli përzgjidhet, emërohet, ngrihet në detyrë dhe largohet nga detyra sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e miratuar nga bordi.

2. Përveç personelit teknik të përhershëm, bordi, kur e sheh të arsyeshme, ndihmohet nga këshilltarë apo ekspertë në përmbushjen e funksioneve të tij.

3. Kostot për këshilltarët apo ekspertët, sipas pikës 2 të këtij neni, mbulohen nga buxheti i ERE-s.

Neni 15

Konflikti i interesit

1. Kryetari, anëtarët e bordit apo personeli teknik i ERE-s nuk mund:

a) të jenë pronarë, aksionarë ose zotërues të pasurisë ose të një pjese të saj të një të licencuari që mban një licencë sipas kushteve të këtij ligji;

b) të jenë të punësuar ose nënkontraktorë të një të licencuari, që mban një licencë sipas kushteve të këtij ligji;

c) të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës apo organeve të tjera drejtuese të një të licencuari që mban një licencë sipas kushteve të këtij ligji;



ç) të jenë drejtues, administratorë ose në një pozicion tjetër drejtues të një i licencuar.

2. Nëse gjatë procedurave aplikuese për dhënien e një licence sipas këtij ligji ose gjatë një procedure në të cilën përfshihen interesa financiare të një të licencuari, përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në çështje të tarifave, kryetari, anëtari i bordit dhe/ose personeli teknik gjendet në një situatë konflikti interesi, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, por që përfshihet në përcaktimet e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ai nuk merr pjesë në vendimmarrjen përkatëse.

3. Kryetari i bordit, anëtari dhe/ose personeli teknik mund të jetë klient i një të licencuari, por, në asnjë rast, i licencuari nuk i ofron anëtarit të bordit apo personelit teknik një shërbim favorizues, të ndryshëm nga shërbimi i përgjithshëm i ofruar për publikun.

4. Kryetari i bordit, anëtari dhe/ose personeli teknik ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit.

Neni 16

Mbledhjet dhe vendimet e bordit

1. Mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat dëgjimore të bordit janë të hapura. Në raste të veçanta, që kanë të bëjnë me trajtimin e çështjeve me karakter të brendshëm, bordi mund të zhvillojë mbledhje me dyer të mbyllura, në përputhje me përcaktimet e rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s.

2. Mbledhjet e bordit zhvillohen me pjesëmarrjen e jo më pak se tre anëtarëve dhe vendimet merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të bordit.

3. Të gjitha vendimet e bordit shoqërohen me një relacion argumentues.

4. Të gjitha vendimet e bordit, përveç atyre me karakter të brendshëm organizativ të ERE-s, botohen në Fletoren Zyrtare. ERE publikon në faqen zyrtare të internetit vendimet e marra dhe njoftimin për shtyp për çdo vendim.

5. Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e

një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

6. Vendimet e bordit të ERE-s ankimohen në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike, nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 17

Financimi i ERE-s

1. Buxheti i ERE-s miratohet nga bordi. ERE ka autonomi në përdorimin e buxhetit të tij.

2. Burimet financiare të ERE-s përbëhen nga pagesat rregullatore dhe pagesat e licencave, të miratuara nga ERE.

3. ERE mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin.

4. ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse. Pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.

5. ERE njofton të licencuarin për vlerën dhe afatet e pagesës rregullatore. Nëse i licencuari nuk bën pagesën brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ERE ka të drejtë të aplikojë masat administrative, në përputhje me nenin 107 të këtij ligji.

6. Pagesat rregullatore depozitohen në një llogari të veçantë në një nga bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Çdo fond në llogarinë e ERE-s, që nuk shpenzohet gjatë një viti, transferohet për vitin pasardhës, duke reduktuar proporcionalisht pagesat rregullatore për vitin pasardhës.

7. Auditimi i veprimtarisë financiare të ERE-s kryhet nga ekspertë të miratuar kontabël, të cilët përzgjidhen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

SEKSIONI II

OBJEKTIVAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E ERE-S

Neni 18

Objektivat e përgjithshëm të ERE-s

1. Objektivat e ERE-s, në kryerjen e funksioneve rregullatore, të përcaktuara në këtë ligj, janë:



a) promovimi i krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera;

b) krijimi i kushteve lehtësuese për futjen në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe heqja e barrierave që mund të pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj të tregut dhe atyre që prodhojnë nga burimet e rinovueshme;

c) angazhimi në zhvillimin dhe funksionimin e një tregu rajonal konkurrues në Komunitetin e Energjisë;

ç) eliminimi i kufizimeve në tregtimin e energjisë elektrike me vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit.

d) angazhimi në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jodiskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit, në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, efikasitetit të energjisë elektrike, si dhe integritet në shkallë të gjerë të prodhimit të energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme;

dh) sigurimi i përfitimit të klientëve prej funksionimit të tregut të brendshëm, duke promovuar konkurrencën dhe mbrojtjen e klientëve;

e) garantimi i standardeve në përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike, mbrojtja e klientëve në nevojë dhe sigurimi i përputhshmërisë gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave, lidhur me ndryshimin e furnizuesit.

2. Në përmbushjen e objektivave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ERE bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe me institucione të tjera të pavarura.

Neni 19

Përgjegjësitë e ERE-s

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ERE ka këto përgjegjësi:

a) miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike;

b) miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës, metodologjitë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, shpërndarjes, si dhe metodologjitë e tjera të aplikueshme;

c) miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës dhe duke marrë në konsideratë koston e shërbimit të ofruar, tarifat për:

i) lidhjen dhe aksesin në rrjetet kombëtare, përfshirë tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes;

ii) kryerjen e shërbimeve të balancimit, të cilat ofrojnë stimujt e përshtatshëm ndaj përdoruesve të rrjetit për të balancuar energjinë hyrëse në rrjet dhe energjinë që konsumojnë prej rrjetit;

iii) veprimtaritë e licencuara, për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik;

ç) siguron aksesin në infrastrukturën ndërkufitare, përfshirë procedurat e alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara;

d) vendos ndaj të licencuarve detyrimin e shërbimit publik, përfshirë shërbimin universal të furnizimit, në përputhje me nenet 47 dhe 85 të këtij ligji;

dh) siguron ndarjen e detyrimeve të operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

e) bashkëpunon me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera fqinje, si dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për harmonizimin e kuadrit rregullator për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, përfshirë edhe shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike dhe rregullat për menaxhimin e kapaciteteve të interkoneksionit;

ë) merr masa për shmangien e ndërsubvencionimit ndërmjet veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit, si dhe ndërmjet kategorive të klientëve;

f) siguron, në bashkëpunim me institucione të tjera, zbatimin me efektivitet të masave mbrojtëse ndaj klientëve fundorë, përfshirë ato të parashikuara në nenet 86, 88 dhe 96 të këtij ligji;

g) bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës dhe të mbikëqyrjes së tregut për shqyrtimin e sjelljeve apo veprimeve të mundshme antikonkurruese të pjesëmarrësve të tregut;



gj) u siguron klientëve mundësinë e aksesit ndaj të dhënave të konsumit në një format të kuptueshëm, të përgatitur nga operatori i sistemit;

h) publikon kushtet për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët e rrjetit;

i) kontribuon në shkëmbimin e të dhënave kryesore të tregut rajonal;

j) merr masa për nxitjen e efikasitetit të energjisë dhe menaxhimin e kërkesës, si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorin e energjisë elektrike;

k) publikon në faqen e tij të internetit të dhëna katërmujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike;

l) miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për:

i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

ii) sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes.

Neni 20

Të drejtat e ERE-s

ERE ka të drejtat e mëposhtme:

a) merr vendime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike;

b) përcakton rregullat dhe kërkesat për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike;

c) miraton tarifa të përkohshme transmetimi, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese;

ç) monitoron dhe kontrollon funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe detyron të licencuarit të ndërmarrin masa të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut;

d) kërkon informacion prej të licencuarve, në kuadër të realizimit të detyrave të tyre;

dh) vendos masa administrative efektive, proporcionale dhe parandaluese ndaj të licencuarve;

Faqe | 4592

e) shqyrton dhe miraton në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët, planet e investimeve të operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe monitoron zbatimin e tyre;

ë) zgjidh mosmarrëveshjet, në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve, sipas parashikimeve të këtij ligji;

f) monitoron zbatimin e kontratave të lidhura midis të licencuarve duke ushtruar të drejtën e aksesit mbi dokumentacionin dhe informacionin e të licencuarit dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë;

g) kontrollon nëse shërbimi është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet e licencës apo rregulloret e miratuara nga ERE;

gj) raporton, në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi, në institucionet e Komunitetit të Energjisë dhe institucionet e tjera përkatëse ndërkombëtare;

h) miraton kontratat tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Neni 21

Parimet e vendosjes së tarifave për operimin dhe shërbimet e rrjetit

1. Tarifat e aplikueshme për aksesin në rrjet duhet të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese ndaj të gjithë përdoruesve të rrjetit dhe duhet të jenë transparente, të reflektojnë kostot reale dhe nevojën për garantimin e sigurisë së rrjetit.

2. Niveli i tarifave të aksesit në rrjet nuk duhet të ndikohet nga distanca e përdoruesit me rrjetin e energjisë elektrike. Vendosja e tarifave të aksesit në rrjet, sipas këtij neni, bëhet pavarësisht detyrimeve mbi eksportet dhe importet e deklaruar, që rezultojnë prej menaxhimit të kapaciteteve të kufizuara të interkoneksionit, referuar nenit 67 të këtij ligji.

3. Niveli i tarifave për lidhjen me rrjetin e prodhuesve dhe klientëve përcaktohet duke konsideruar nivelin e humbjeve në rrjet, kapacitetin e kufizuar që mund të shkaktohet nga këto lidhje dhe kostot e nevojshme të investimeve infrastrukturore që mundësojnë lidhjen me rrjetin.



4. Tarifat e miratuara dhe metodologjitë e përlllogaritjes së tyre duhet të mundësojnë kryerjen e investimeve të nevojshme në rrjet, në mënyrë të tillë që të garantohet se këto investime do të sigurojnë qëndrueshmërinë e sistemit. Në përcaktimin e tarifave të aksesit në rrjet duhet të merren në konsideratë edhe:

a) pagesat dhe faturat që rezultojnë nga mekanizmi i kompensimit ndërkufitar i operatorëve të sistemit të transmetimit të vendeve kufitare;

b) pagesat e kryera dhe pagesat e marra, përfshirë edhe pagesat e pritshme të periudhave të ardhshme, vlerësuar mbi bazën e periudhave të mëparshme.

5. Nuk aplikohen tarifa për aksesin në rrjet për transaksionet individuale të eksportit dhe/ose transiteve të deklaruara.

6. Në miratimin e tarifave të aksesit në rrjet dhe të metodologjiave të tyre, ERE siguron incentivat e duhur afatshkurtër dhe afatgjatë ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për rritjen e efektivitetit, rritjen e integritetit të tregut dhe sigurinë e furnizimit dhe mbështetjen e veprimtarive kërkimore.

Neni 22

Monitorimi nga ERE

ERE monitoron:

a) zbatimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike;

b) zbatimin e detyrimit të transparencës prej të licencuarve;

c) efektivitetin e konkurrencës së tregut në nivel shitjeje me shumicë dhe pakicë, shkëmbimet, rregullat e ndryshimit të furnizuesit, rregullat e shkëputjes nga rrjeti, pagesat e shërbimeve të mirëmbajtjes, ankesat e klientëve dhe çdo shtrembërim apo kufizim të konkurrencës, duke informuar Autoritetin e Konkurrencës për rastet e konstatuara;

ç) nënshkrimin e kontratave kushtëzuese, përfshirë këtu edhe kontrata me kushte të veçanta përjashtuese, të cilat mund të pengojnë klientët jofamiljarë të mëdhenj të kontratojnë njëkohësisht më tepër se një furnizues apo të kushtëzojnë zgjedhjen e kësaj mundësie prej tyre. Në këto raste, ERE duhet të informojë Autoritetin e Konkurrencës;

d) afatet brenda të cilave operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes përfundojnë lidhjen në rrjet të klientëve të rinj apo kryejnë riparimet në rrjete;

dh) zbatimin e rregullave lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, furnizuesve, klientëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut;

e) investimet në kapacitetet e reja prodhuese, lidhur me sigurinë e furnizimit;

ë) zbatimin e masave të sigurisë së furnizimit, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji;

f) sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit;

g) bashkëpunimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit me operatorët e transmetimit të vendeve fqinje apo operatorët e rrjeteve europiane të transmetimit të energjisë elektrike, përfshirë monitorimin e zbatimit të mekanizmit të kompensimit ndërtransmetues të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, vendosur në kuadër të këtij bashkëpunimi;

gj) zbatimin e rregullave për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të interkoneksioneve, në bashkëpunim me autoritetet rregullatore ose autoritetet përgjegjëse të vendeve të tjera fqinje, me të cilat është vendosur interkoneksioni;

h) menaxhimin e kapacitetit të kufizuar në rrjetin e transmetimit, përfshirë interkoneksionet dhe zbatimin e rregullave të menaxhimit të kapacitetit të kufizuar;

i) publikimin e informacionit të duhur prej Operatorit të Sistemit të Transmetimit, lidhur me interkonektorët, përdorimin e rrjetit dhe alokimin e kapaciteteve ndaj palëve të interesuara, duke ruajtur konfidencialitetin për informacionin e marrë;

j) ndarjen efektive të llogarive, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për të shmangur ndërsubvencionimet midis aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit;

k) kushtet dhe tarifat e lidhjes së prodhuesve të rinj.

Neni 23

Regjimi rregullator për çështjet ndërkufitare

1. ERE bashkëpunon me autoritetet rregullatore të vendeve fqinje të rajonit dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për:



a) hartimin dhe lidhjen e marrëveshjeve operative për menaxhimin optimal të rrjetit, promovimin e shkëmbimeve të ndërsjella dhe alokimin e kapaciteteve ndërkufitare, si dhe rritjen e kapaciteteve të interkoneksionit nëpërmjet interkoneksioneve të reja, duke mundësuar rritjen e konkurrencës, përmirësimin e sigurisë së furnizimit pa diskriminim të të licencuarve dhe tregtarëve të vendeve të ndryshme, palë të Komunitetit të Energjisë;

b) koordinimin e hartimit dhe zbatimit të Kodeve të Rrjetit prej operatorit të rrjetit të transmetimit dhe aktorëve të tjerë të tregut;

c) koordinimin e hartimit të rregullave që rregullojnë menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara.

2. ERE ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet rregullatore të vendeve të rajonit për forcimin e bashkëpunimit rajonal rregullator.

Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga ERE

1. ERE vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura midis të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave.

2. Çdo palë e interesuar, që ka ankesa ndaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, si dhe ndaj të licencuarve të tjerë, lidhur me zbatimin e detyrimeve të tyre, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji apo akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, mund t'i paraqesë për zgjidhje pranë ERE-s. ERE merr vendim brenda një afati prej 30 ditësh nga marrja e ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

3. ERE mund të vendosë mospranimin e ankesës nëse, bazuar në legjislacionin në fuqi, konstaton se shqyrtimi i ankesës nuk është kompetencë e saj.

4. Paraqitja e ankesës, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk i heq të drejtën palës së interesuar për t'u drejtuar pranë organeve të tjera kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 25

Raportimi i ERE-s

1. ERE, brenda datës 31 mars të çdo viti, paraqet në Kuvend një raport vjetor mbi situatën e sektorit të energjisë elektrike dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin paraardhës. Pas paraqitjes dhe miratimit në Kuvend, ky raport publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

2. Në raportin e përgatitur nga ERE, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, përshkruhet gjendja e përgjithshme e sistemit të energjisë elektrike, përfshirë në veçanti:

a) sigurinë operative të rrjetit;

b) balancën e parashikuar të kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare;

c) nivelin e pritshëm të kërkesës dhe perspektivën e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetëvjeçare nga data e raportit;

ç) kapacitetin shtesë prodhues të propozuar, të planifikuar apo në fazë ndërtimi;

d) parashikimin e investimeve, për jo më pak se pesë vitet e ardhshme, që planifikohen të realizohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo çdo palë tjetër, lidhur me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkoneksionit;

dh) cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve;

e) masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike;

ë) masat e përshtatshme, në rast nevojë, të rritjes së sigurisë së furnizimit.

3. Informacioni i raportit vjetor, të përmendur në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij neni, bazohet në:

a) parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit;

b) modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës;

c) objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe europian.



ç) informacionin e hollësishëm të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, për investimet e parashikuara për linjat e interkoneksionit dhe për ndërtimin e linjave të brendshme të rrjetit, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndikojnë në linjat e interkoneksioneve ndërkufitare.

PJESA E PESTË SISTEMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 26

Funksionimi i integruar i sistemit të energjisë elektrike

Sistemi i energjisë elektrike operon si një sistem i integruar me procese të vazhdueshme prodhimi, transmetimi, shpërndarjeje dhe konsumi të energjisë elektrike.

Neni 27

Lidhja me rrjetin

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jodiskriminuese. ERE, në bashkëpunim me operatorët e rrjeteve, miraton rregullat që përcaktojnë kostot që do t'i ngarkohen përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë lidhjen në rrjet të një përdoruesi të rrjetit me arsyetimin e kufizimeve të mundshme në të ardhmen të kapaciteteve aktuale të rrjetit apo krijimit të një kufizimi të kapacitetit në pjesë të largëta të sistemit të transmetimit. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë një pikë lidhjeje të re, bazuar në arsyetimin se do të krijojë kosto shtesë lidhur me nevojën e krijimit të kapaciteteve shtesë të elementeve të sistemit në zonën përreth pikës së lidhjes.

3. ERE miraton rregulloren për procedurat për lidhjet e reja, të propozuara nga i licencuari, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe efikente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes. Këto rregulla e procedura specifikojnë edhe të drejtat dhe

detyrimet e operatorit të rrjetit përkatës dhe të palës që kërkon lidhjen, në veçanti, kushtet për lidhjen, afatet, pikat e matjes, si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit.

4. Rregullorja merr në konsideratë kostot dhe përfitimet që shoqërojnë lidhjen në rrjet të përdoruesve, si dhe rrethanat e veçanta të prodhuesve të ndodhur në zona të largëta dhe zona me dendësi të ulët të popullsisë.

5. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes i japin çdo përdoruesi të ri që dëshiron të lidhet me rrjetin informacion të plotë, përfshirë:

a) një vlerësim të plotë dhe të hollësishëm të kostove për realizimin e lidhjes së kërkuar;

b) afatin e nevojshëm e të arsyeshëm për përpunimin e kërkesës dhe të realizimit të lidhjes me rrjetin.

6. Përdoruesit e rinj që dëshirojnë të lidhen në rrjet, pas miratimit të kërkesës për lidhjen e tyre nga ana e operatorit përkatës të sistemit, mund të kontraktojnë operatorë të licencuar nga organet kompetente për kryerjen e punimeve të nevojshme për lidhjen në rrjet, në përputhje me dispozitat dhe specifikimet e përcaktuara në marrëveshjen e lidhjes, të nënshkruar ndërmjet përdoruesit të ri dhe operatorit të sistemit. Operatori i sistemit përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin.

Neni 28

Kostot për lidhjen me rrjetin

1. Kostot e plota për lidhjen me rrjetin ekzistues mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet.

2. Në llogaritjen e kostos së lidhjes merren në konsideratë pika e lidhjes dhe kapaciteti i saj, qëllimi i synuar, modeli i konsumit, kostot që lidhen me përforcimin ose përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose përmirësimin e operimit të rrjetit që mund të nevojitet për lidhjen, statusi i përdoruesit të rrjetit, si dhe karakteristika të tjera të lidhjes.

3. Kur lidhja realizohet prej operatorit të sistemit, kostot e lidhjes parapaguhën nga pala kërkuuese, bazuar në rregulloren për procedurat e lidhjeve të reja.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në rast



mungese të kapaciteteve të nevojshme për lidhjen e përdoruesve të rinj, mund të hyjë në marrëveshje me palën kërkuese për përmirësimin e sistemit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e kërkuar, me kusht që kostot të përballohen nga pala kërkuese. Kjo marrëveshje duhet të miratohet nga ERE, pas propozimit nga operatorët e rrjetit.

5. Në rast të lidhjes së përdoruesve të rinj të rrjetit, pronësia e aseteve të lidhjes që i shtohen rrjetit ekzistues është e përdoruesit, deri në amortizim të plotë të aseteve apo në përfundim të autorizimit të dhënë, bazuar në marrëveshjen e lidhjes, nënshkruar ndërmjet palëve. Pas amortizimit të plotë të aseteve të lidhjes, pronësia e tyre kalon tek operatori i rrjetit. Lidhjet operohen prej operatorëve të rrjetit, të cilët kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e tyre. Kostoja për mirëmbajtjet paguhet prej përdoruesit.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit, bazuar në kushtet teknike të rrjetit, autorizon lidhjen e një përdoruesi të ri në sistemin e transmetimit, nëpërmjet aseteve të lidhjes së re të realizuar nga një përdorues i mëparshëm. Përdoruesi i ri përgjigjet për kompensimin e drejtë të kostove ndaj përdoruesit që ka kryer investimin, në përputhje me rregulloren e lidhjeve të reja.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në rastin kur vlerëson rëndësinë që kanë asetet e lidhjes, në zhvillimin e sistemit të transmetimit apo shpërndarjes, apo kur këto asete i shërbejnë më shumë se një klienti, ka të drejtën e marrjes në pronësi të një pjese ose të gjithë lidhjes së ndërtuar nga ana e përdoruesit, sipas legjislacionit civil, kundrejt një kompensimi të plotë të kostove të llogaritura në përputhje me këtë ligj dhe rregulloren e lidhjeve të reja.

Neni 29

Akresi i palëve të treta

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes garantojnë aksesin në rrjet për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit, mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar në tarifata e miratuara dhe të publikuara nga ERE. Prodhoesit, që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme, kanë përparësi në aksesin në rrjetet elektrike.

Faqe | 4596

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë aksesin në rrjetin e tyre, në rast se mungon kapaciteti i nevojshëm. Vendimi për refuzimin e aksesit në rrjet duhet të jetë i arsyetuar, të bazohet në kushte teknike dhe ekonomike objektive dhe duhet të marrë në konsideratë detyrimin e shërbimit publik si dhe detyrimet për mbrojtjen e klientëve fundorë, të përcaktuara nga ky ligj. Vendimi për refuzimin e aksesit i njoftohet palës së interesuar.

3. Në rast se një pale të interesuar i është refuzuar aksesin në rrjet, ajo mund të kërkojë fillimin e procedurës për zgjidhje të mosmarrëveshjes pranë ERE-s.

4. Në rast refuzimi të aksesit, ERE, nëpërmjet operatorit të rrjetit, i siguron palës së interesuar informacionin shtesë të nevojshëm.

Neni 30

Interkoneksioni me sistemet e tjera elektroenergjetike

1. Sistemi kombëtar i transmetimit lidhet me sistemet e transmetimit të vendeve të tjera nëpërmjet linjave ekzistuese të interkoneksionit, atyre që do të ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, në përputhje me planin e investimit të rrjetit, të miratuar nga ERE, apo që do të ndërtohen prej palëve të treta, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Operimi i Sistemit të Transmetimit, në paralel me sistemet e ndërlidhura të vendeve të tjera, kryhet në përputhje me marrëveshjet dy ose shumëpalëshe midis operatorëve të sistemeve të ndërlidhura të transmetimit, duke respektuar kërkesat teknike, kërkesat e operimit të sigurt dhe standarde të tjera për interkoneksionet, të përcaktuara nga ERE.

Neni 31

Ndërtimi i interkonektorëve të rinj

1. Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

2. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e interkonektorëve të rinj, sipas parashikimeve të



këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 32

Përjashtimi nga detyrimi për akses

1. Interkonektorët e rinj me rrymë të vazhduar dhe çdo rritje e konsiderueshme e kapacitetit të interkonektorëve ekzistues në rrymë të vazhduar, që do të ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kërkesën e investitorit, mund të përjashtohen, me vendim të ERE-s, tërësisht ose pjesërisht nga detyrimi për t'u siguruar të drejtë aksesit palëve të treta mbi këtë linjë, sipas parashikimeve të nenit 29, të këtij ligji, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) investimi përmirëson konkurrencën në furnizimin e energjisë elektrike;

b) niveli i riskut, lidhur me investimin, është i tillë, që investimi nuk do të mund të kryhej nëse nuk jepet përjashtimi nga detyrimi për t'u siguruar të drejtë aksesit palëve të treta;

c) interkonektori është pronë e një personi, i cili është i ndarë nga pikëpamja ligjore nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

ç) ndaj përdoruesve të interkonektorit aplikohen pagesa për shfrytëzimin e kapaciteteve të tij;

d) asnjë pjesë e kapitalit ose kostove operacionale të interkonektorit nuk është mbuluar prej ndonjë komponenti tarifash, të aplikuara ndaj përdorimit të rrjetit të transmetimit apo shpërndarjes, të lidhur nga interkonektori;

dh) përjashtimi nga detyrimi për t'u siguruar të drejtë aksesit palëve të treta nuk dëmton konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm apo të tregut të vendit tjetër, me të cilin është lidhur interkonektori.

2. Në raste të veçanta, pika 1 është e zbatueshme edhe për interkonektorët me rrymë alternative, me kushtin që kostot dhe rreziqet e investimit në fjalë të jenë veçanërisht të larta, krahasuar me kostot dhe risqet e hasura normalisht për lidhjen me rrjetin e transmetimit të një vendi fqinj, nëpërmjet një interkonektori me rrymë alternative.

3. Përjashtimi mund të përfshijë një pjesë ose të gjithë kapacitetin e interkonektorit të ri ose të kapacitetit shtesë të interkonektorit ekzistues, në

përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Vendimi i ERE-s për dhënien e përjashtimit merret rast pas rasti dhe në përputhje me vendimin e autoriteteve rregullatore të shteteve të përfshira. Në vendim vendosen kushte lidhur me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe aksesin jodiskriminues në interkonektor, si dhe mënyrën e funksionimit të interkonektorit gjatë dhe pas periudhës së përjashtimit. Në vendosjen e këtyre kushteve merren në konsideratë të veçantë kapacitetet e reja transmetuese që do të ndërtohen, rritja e kapaciteteve ekzistuese, afatet kohore të projektit dhe rrethanat specifike të vendeve të interesuara. Vendimi për përjashtimin merret në bashkërendim me autoritetet rregullatore të vendeve të përfshira.

5. Para dhënies së përjashtimit, ERE përcakton mekanizmin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve, në marrëveshje të përbashkët me autoritetin rregullator të vendit të interesuar, ku parashikohet edhe detyrimi i ofrimit të kapaciteteve të papërdorura në treg. Në vlerësimin e kriterëve të përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, merren në konsideratë rezultatet e procedurës së alokimit të kapaciteteve.

6. Kur ERE së bashku me autoritetet rregullatore të vendeve të interesuara kanë arritur një marrëveshje për vendimin e përjashtimit, brenda gjashtë muajve, ata informojnë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë lidhur me:

a) arsytet në bazë të të cilave është dhënë ose refuzuar përjashtimi, përfshirë informacionin financiar që justifikon nevojën për përjashtim;

b) analizën e bërë për efektin mbi konkurrencën dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm që rezulton nga dhënia e përjashtimit;

c) arsyet për periudhën kohore dhe kapacitetin për të cilin është dhënë përjashtimi;

ç) rezultatet e procesit të konsultimit të ERE-s.

7. ERE, para se të marrë vendimin përkatës, ia dërgon për mendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. ERE pret opinionin e sekretariatit jo më shumë se 2 muaj nga dita e dërgimit të tij. Ky afat mund të zgjatet me pëlqim të ERE-s, nëse Sekretariati i Komunitetit të Energjisë kërkon informacion shtesë.

8. Në marrjen e vendimit, ERE merr në konsideratë opinionin e Sekretariatit të Komunitetit



të Energjisë. Në rastet kur vendimi përfundimtar i ERE-s është i ndryshëm nga opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE njofton sekretariatin për vendimin e marrë dhe arsyet mbi të cilat është mbështetur ky vendim.

9. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë merr vendimin e përjashtimit:

a) në rastet kur autoritetet rregullatore të përfshira nuk arrijnë në një vendim brenda 6 muajve nga data e fundit e depozitimit të kërkesës për përjashtim pranë autoriteteve rregullatore përkatëse;

b) në bazë të kërkesës së autoriteteve rregullatore të përfshira.

10. Vendimi i përjashtimit, përfshirë dhe çdo kusht të vendosur, duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të publikohet.

11. Pas periudhës së përjashtimit, nëse pronari nuk do që të përdorë linjën e interkoneksionit në regjimin e aksesit të lirë ndaj palëve të treta, sipas rregullave dhe kërkesave që rregullojnë funksionimin e rrjetit kombëtar, fillimisht i ofron të drejtën e blerjes, për vlerën kontabël të mbetur të asetit për pjesën e ndodhur brenda territorit kombëtar, Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit refuzon ofertën, atëherë pronari, duke respektuar rregullat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave sipas nenit 31, të këtij ligji, mund të ofrojë shitjen e aseteve që gjenden brenda territorit të vendit ndaj palëve të treta, të cilat do të përdorin linjën në përputhje me rregullat dhe kërkesat që rregullojnë veprimtarinë e rrjetit kombëtar të transmetimit.

Neni 33

Linjat direkte

1. Të gjithë prodhuesit dhe furnizuesit e energjisë elektrike brenda një territori të caktuar mund të furnizojnë mjediset e tyre, filialet dhe klientët e tyre, nëpërmjet një linje direkte.

2. Linjat direkte, që ndërtohen për eksportimin e energjisë elektrike nga prodhuesi vendas drejt një konsumatori jashtë vendit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas marrjes së mendimit nga ana e ERE-s.

3. Linjat direkte, të cilat ndërtohen për lidhjen e një prodhuesi brenda vendit me një konsumator

brenda vendit apo një shoqëri furnizimi që furnizon mjediset e veta apo klientët e vet të kualifikuar, miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë, pas marrjes së mendimit nga ana e ERE-s.

4. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e linjave direkte miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministri miraton ndërtimin e një linje direkte, edhe në rastet kur aplikuesit i është refuzuar aksesit në rrjet për rastet e parashikuara në nenin 29, të këtij ligji, ose nëse është iniciuar një procedurë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, sipas parashikimeve të nenit 24 të këtij ligji.

6. Ministri refuzon ndërtimin e një linje direkte në rast se dhënia e një autorizimi të tillë pengon përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik dhe mbrojtjen e klientit, të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji. Argumentet për një refuzim të tillë duhet të jenë të arsyetuara dhe i njoftohen aplikuesit.

7. Mundësia e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet një linje direkte, sikurse përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, nuk pengon të drejtën e klientit për të lidhur marrëveshje furnizimi me energji elektrike nga një furnizues tjetër i zgjedhur prej tij.

8. Shpenzimet për ndërtimin dhe operimin e linjave direkte përballohen nga mbajtësi i autorizimit.

9. Për krijimin, ushtrimin dhe përfundimin e të drejtave, lidhur me ndërtimin dhe operimin e linjave direkte që kalojnë nëpërmjet pasurisë së një pale të tretë, zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Neni 34

Standardet teknike dhe të sigurisë në sektorin elektrik

1. Rregullat teknike për projektimin, ndërtimin dhe operimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike, sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes, linjave të interkoneksionit ose linjave direkte në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe rregullat e sigurimit teknik, hartohen nga ministri përgjegjës për energjinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardeve dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



2. Rregullat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, duhet të jenë objektive, jodiskriminuese dhe të sigurojnë një operim të qëndrueshëm e të sigurt të sistemit të energjisë elektrike, përfshirë edhe ndërveprimin me sistemet e energjisë elektrike të vendeve fqinje, si dhe të sigurojnë një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

3. Projektimi, ndërtimi dhe operimi i centraleve të prodhimit të energjisë elektrike, sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes, linjave të interkoneksionit ose linjave direkte bëhet në përputhje me rregullat teknike të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe në përputhje me standardet teknike të harmonizuara shqiptare në fuqi.

4. Kontrolli i zbatimit dhe mbikëqyrja e rregullave teknike të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, për sektorin e energjisë elektrike, kryhen nga inspektorati përgjegjës në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 35

Ndarja e llogarive të shoqërive të sektorit elektrik

1. Çdo i licencuar mban llogari të veçanta për secilën nga veprimtaritë e licencuara që ushtron, si dhe për çdo aktivitet tjetër që nuk lidhet me sektorin e energjisë elektrike, me qëllim shmangien e ndërsubvencionimit dhe cenimit të konkurrencës. Këto llogari mund të paraqiten të konsoliduara, përveç rastit kur aktivitetet e kryera lidhen me shpërndarjen apo transmetimin e energjisë elektrike.

2. Të ardhurat që siguron i licencuari nga çdo e drejtë mbi rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes duhet të specifikohen në llogaritë e të licencuarit.

3. Çdo i licencuar paraqet për auditim dhe publikon pasqyrat financiare vjetore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për standardet e kontabilitetit. Auditimi verifikon edhe nëse është respektuar detyrimi për shmangien e ndërsubvencionimit ndërmjet veprimtarive të licencuara.

4. Të licencuarit duhet të bëjnë të disponueshme për palët e interesuara pasqyrat financiare vjetore të tyre.

Neni 36

Zonat e sigurisë

Për mbrojtjen dhe operimin normal të objekteve elektrike dhe të aseteve të tyre ndihmëse, si dhe për shmangien e rrezikut ndaj njerëzve, pasurisë dhe mjedisit, Këshilli i Ministrave miraton kushtet për përcaktimin e zonave të sigurisë, si dhe kufizimet e zbatueshme për këto zona.

SEKSIONI II

LICENCIMI

Neni 37

Veprimtaritë e licencuara dhe përjashtimet

1. Çdo person juridik, që kryen një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike, sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të pajiset me licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. ERE lëshon licencë për veprimtaritë e mëposhtme:

- a) prodhimin e energjisë elektrike;
- b) operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
- c) operimin e sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike;
- d) furnizimin e energjisë elektrike;
- e) tregtimin e energjisë elektrike;
- dh) operimin e tregut të energjisë elektrike.

3. Për kryerjen e secilës veprimtari, objekt i licencimit nga ERE, lëshohen licenca të veçanta edhe në rastin kur i jepen të njëjtës shoqëri. Në vendosjen e kushteve të licencave, ERE shmang mospërputhjet e mundshme midis kushteve të licencave, të lëshuara për veprimtari të ndryshme, të kryera nga e njëjta shoqëri.

4. Njësitë e qeverisjes vendore mund të kryejnë secilën prej veprimtarive të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, nëse ato pajisen me licencën përkatëse nga ERE, me përjashtim të veprimtarisë së përcaktuar në shkronjat “b” dhe “dh” të pikës 2.

5. Për operimin e një linje direkte nuk nevojitet licencë transmetimi apo shpërndarjeje.

6. Nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike:

- a) vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar, ose kur lidhja me rrjetin kombëtar bëhet për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së tij të prodhimit;



b) prodhuesit, përfshirë edhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW;

7. Subjektet e parashikuara në pikën 6, të këtij neni, në çdo rast janë të detyruar të respektojnë rregullat e tregut dhe Kodet e Rrjetit.

Neni 38

Kushtet e licencimit

1. ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera:

a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

b) vendndodhjet dhe zonat, në të cilat do të kryhen veprimtaritë e licencuara të energjisë elektrike;

c) sigurinë operative dhe qëndrueshmërinë e objekteve, pajisjeve apo rrjetit, në përputhje me rregullat teknike të përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji;

ç) kërkesat për natyrën e burimeve parësore të energjisë;

d) kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, mbrojtjen e jetës, pasurisë, shëndetit të qytetarëve, si dhe rendin publik;

dh) kërkesat financiare;

e) mbrojtjen e mjedisit;

ë) nxitjen e efikasitetit të energjisë në sektorin e energjisë elektrike;

f) detyrimet e shërbimit publik, siç parashikohet në këtë ligj;

g) nxitjen e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;

gj) nëse aplikuesi është i organizuar në përputhje me parimin e ndarjes së veprimtarive dhe ndarjes strukturore, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Licenca për operimin e sistemit të transmetimit i jepet vetëm një subjekti, i cili certifikohet në përputhje me parashikimet e nenit 58 të këtij ligji.

Neni 39

Procedurat e licencimit

1. ERE miraton rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose

heqjen e licencave, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikim për çdo licencë.

2. ERE mund të miratojë procedura të thjeshtuara licencimi për prodhuesit e lidhur në rrjetin e shpërndarjes dhe veprimtarinë e tregutit të energjisë elektrike.

3. ERE merr vendim për dhënien ose jo të një licence prodhimi të energjisë elektrike, brenda 60 ditëve nga data e aplikimit dhe brenda 30 ditëve nga data e aplikimit për licencat e tjera, përveç rastit kur mund të vendosë zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit, në përputhje me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e ERE-s. Në çdo rast, zgjatja e afatit të marrjes së vendimit nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

4. ERE mund të japë licencë me kusht kur gjykon se ndonjë nga kushtet e paplotësuara nuk është thelbësor dhe i licencuari merr përsipër ta përmbushë atë brenda një periudhe të caktuar kohore të përcaktuar në vendim.

Neni 40

Publikimi për aplikimet për licencë

1. ERE publikon, brenda 14 ditëve nga data e kryerjes së aplikimit për marrjen e një licence, njoftimin për aplikimin e bërë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në rregulloren për procedurat e licencimit.

2. Gjatë marrjes së vendimit, ERE duhet të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë vërejtjet ose kundërshtimet e arsyeshme e të bazuara, të paraqitura nga institucionet publike apo palët e tjera të interesuara, në lidhje me kërkesën për licencë, duke arsyetuar në vendim pranimin ose jo të tyre.

Neni 41

Refuzimi i një licence

1. ERE refuzon dhënien e një licence nëse:

a) aplikuesi nuk përmbush ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji;

b) aplikuesi është në proces falimentimi ose likuidimi, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi për falimentimin;

c) aplikuesit i është revokuar ose hequr licenca dhe nuk ka përfunduar periudha, brenda së cilës është i ndaluar riaplikimi për licencë, siç është



përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s për heqjen e licencës.

2. Vendimi i ERE-s arsyeton shkaqet për refuzimin e licencës.

Neni 42

Heqja e një licence

1. ERE heq një licencë kur i licencuari:

a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë sipas këtij ligji;

b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji;

d) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;

dh) me kërkesë të të licencuarit;

e) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

2. Në rastet e heqjes së licencës, sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni, ERE:

a) njofton me shkrim të licencuarin për fillimin e procedurave për heqjen e licencës. Njoftimi duhet të shprehë qartësisht arsyet për heqjen e licencës;

b) i jep mundësinë të licencuarit të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës;

c) kur është në interesin publik, mund t'i japë të licencuarit 30 ditë kohë pas përgjigjes së tij me shkrim, që të veprojë në përputhje me kushtet e licencës dhe të shmangë shkakun për heqjen e saj.

3. Në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të licencuarit që ushtron veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes apo furnizimit, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve, ERE, bazuar në rregulloren përkatëse të procedurave të heqjes së licencës, vendos një nga masat e përkohshme, të përcaktuara më poshtë:

a) merr vendim për të vendosur nën administrim të kufizuar, për një periudhë të caktuar

kohore, shoqërinë së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave sipas pikës 7 të këtij neni;

b) cakton një shoqëri tjetër për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, e cila duhet të përmbushë kushtet përkatëse të licencimit;

c) merr vendim për të vendosur një administrator të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas pikës 6 të këtij neni. Në këtë rast, ERE, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, emëron një administrator, i cili është përgjegjës për të siguruar një aktivitet normal, përfshirë edhe operimin e aseteve të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca sipas kushteve përkatëse.

4. Për rastet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, ERE përcakton kushtet dhe detyrimet që duhet të zbatohen nga shoqëria, së cilës i është hequr licenca, gjatë periudhës së zbatimit të masave të përkohshme.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të këtij neni.

6. Derisa licenca të transferohet te një shoqëri tjetër, do të aplikohen masat e përkohshme, të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e heqjes së licencës, zbatimi i të cilave monitorohet nga ERE.

7. Rregullat, procedurat dhe kriteret për zbatimin e kërkesave, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, përcaktohen nga ERE në rregulloren përkatëse të procedurave të heqjes së licencës.

8. Kur ERE heq licencën e prodhimit, transmetimit shpërndarjes apo furnizimit, për rastet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij neni, Këshilli i Ministrave, brenda 12 muajve nga data e heqjes së licencës, kryen procedurën e shpronësimit, në bazë të një kompensimi të drejtë të aseteve të të licencuarit, bazuar në legjislacionin në fuqi.



Neni 43

Modifikimi i kushteve të një licence

1. ERE mund të modifikojë licencën, me iniciativën e vet, në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare ose me kërkesën e të licencuarit. ERE merr në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e licencës së tij.

2. Përpara miratimit të modifikimit të një licence, ERE publikon modifikimet e propozuara dhe shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme, të paraqitura nga palët e interesuara lidhur me këtë proces.

Neni 44

Transferimi i licencës ose aseteve

1. Transferimi i licencës ose aseteve të të licencuarit, që shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të licencuara, bëhet me miratimin paraprakt të ERE-s, bazuar në rregulloret e miratuara prej saj. Miratimi i ERE-s nuk është i nevojshëm në rastet e transferimit të aseteve me vlerë minimale, apo aseteve që nuk lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e licencuar, sipas rregullores të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

2. ERE miraton rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nëpërmjet shitjes, dhënies me qira, transferimit, hipotekimit, barrës ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, përfshirë përjashtimet nga miratimi për asetet me vlerë minimale.

Neni 45

Standardet e njësuar të llogarive

1. ERE, harton dhe miraton një sistem të njësuar dhe standard të llogarive për të gjithë të licencuarit që veprojnë në tregun të energjisë elektrike, mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe standardet e pranuara ndërkombëtare mbi kontabilitetin.

2. Raportimi vjetor financiar i të licencuarve tek ERE bëhet sipas këtij sistemi.

Neni 46

Aksesi ndaj llogarive të të licencuarve

1. Të licencuarit, që operojnë në tregun e energjisë elektrike, janë të detyruar të paraqesin në ERE pasqyrat e plota financiare për çdo vit ushtrimor. Pasqyrat financiare depozitohen në ERE brenda datës 31 janar të vitit pasardhës ushtrimor. Të licencuarit, që operojnë në tregun e energjisë elektrike, janë të detyruar gjithashtu të depozitojnë kopjen e audituar të pasqyrave financiare, brenda datës 31 qershor të vitit pasardhës.

2. Në kryerjen e funksioneve të saj, ERE ka të drejtën e aksesit ndaj të dhënave, në bazë të të cilave janë hartuar pasqyrat financiare të shoqërive që operojnë në tregun e energjisë elektrike.

3. ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të marrë nga shoqëritë e licencuara që veprojnë në tregun e energjisë elektrike. ERE mund të transmetojë këtë informacion të ndjeshëm tregtar kur kërkohet nga autoritetet kompetente, në përputhje me funksionet e tyre, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 47

Detyrimet e shërbimit publik

1. Këshilli i Ministrave, duke marrë në konsideratë interesin publik, përcakton kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, që lidhen me:

- a) sigurinë e furnizimit;
- b) cilësinë e shërbimit;
- c) tarifat për kryerjen e një detyrimi të shërbimit publik;
- c) mbrojtjen e mjedisit;
- d) mbrojtjen e konkurrencës;
- dh) burimet e rinovueshme të energjisë;
- e) efikasitetin e energjisë;
- ë) çdo rrethanë tjetër që ndikon në interesin publik;
- f) ndryshimet klimaterike.

2. ERE vendos ndaj një të licencuari, që ushtron aktivitet në sektorin e energjisë elektrike,



detyrimin e shërbimit publik, sipas kushteve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Çdo detyrim i shërbimit publik, i vendosur nga ERE, përfshihet në licencën e të licencuarit, duke ndjekur procedurën për dhënien e një licence të re ose procedurën për modifikim të një licence aktuale të të licencuarit.

3. Vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari, sipas pikës 2, të këtij neni, bëhet në mënyrë transparente, jodiskriminuese, duke mos penguar hapjen e tregut të energjisë elektrike.

4. Në vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari, ERE merr në konsideratë aftësinë teknike, financiare dhe organizative të të licencuarit dhe nëse ky i fundit ka ofruar një shërbim publik për të njëjtën zonë apo kategori klientësh, përpara vendosjes së këtij detyrimi.

5. Të licencuarit nuk do t'i vendoset si detyrim i shërbimit publik ndërtimi i një rrjeti në një zonë të caktuar, në të cilën nuk ka rrjet para datës së vendosjes së këtij detyrimi, me përjashtim të zonave objekt i një plani rregullimi, të miratuara sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Vendimi i ERE-s, nëpërmjet të cilit vendoset detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari, duhet:

a) të përcaktojë në mënyrë të qartë detyrimin e shërbimit publik;

b) të përcaktojë në mënyrë të qartë të licencuarin në sektorin e energjisë elektrike, që do të jetë i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

c) të marrë në konsideratë mbulimin e kostove të të licencuarit të ngarkuar me këtë detyrim;

ç) të specifikojë natyrën e çdo të drejte ekskluzive ose të veçantë që i është caktuar të licencuarit në fjalë;

d) të përcaktojë kategoritë e klientëve, zonën dhe periudhën për të cilën është vendosur detyrimi i shërbimit publik;

dh) të përcaktojë qartësisht mënyrën e financimit dhe mënyrën e përlogaritjes së kompensimit që do të merret nga i licencuari, të cilit i është ngarkuar realizimi i detyrimit të shërbimit publik;

e) të përcaktojë dhe të argumentojë në mënyrë të qartë se detyrimi i vendosur përbën kufizimin më të vogël dhe se është proporcional dhe i

domosdoshëm për sigurimin e shërbimit publik në fjalë.

7. Kostot e shkaktuara për realizimin e detyrimit të shërbimit publik nga i licencuari njihen nga ERE në miratimin e tarifave për shërbimet e realizuara, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. ERE përcakton alokimin e kostove të përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik te klientët fundorë, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

8. Për çdo kosto shtesë që i shkaktohet të licencuarit, si rezultat i realizimit të detyrimit të shërbimit publik, që nuk përfshihet në tarifën e përcaktuar nga ERE, sipas pikës 7, të këtij neni, bëhet kompensim financiar apo kompensim në formë të tjera, i cili përcaktohet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. Kompensimi për këto kosto shtesë përfshin kostot e shkaktuara për kryerjen e detyrimit të shërbimit publik, për shkak të të cilit të licencuarit i ulen të ardhurat që do të siguronte. Çdo kompensim që i bëhet të licencuarit për realizimin e detyrimit të shërbimit publik, sipas kësaj pike, vlerësohet nga komisioni i ndihmës shtetërore në bashkëpunim me ERE-n, Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Konkurrencës dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Në rast se një pjesëmarrës i tregut, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, refuzon të nënshkruajë një kontratë të miratuar nga ERE, atëherë ERE vendos hyrjen në fuqi të kontratës dhe detyrimin e palëve për zbatimin e saj brenda një afati 30-ditor.

10. Të licencuarit, të cilëve u vendoset detyrimi i shërbimit publik gjatë kryerjes së veprimtarive të tyre, monitorohen nga ERE për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara.

11. ERE, pas vendosjes së detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari të sektorit të energjisë elektrike, informon Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë lidhur me të gjitha masat e marra për të plotësuar detyrimet e shërbimit publik, për mbrojtjen e klientëve e të mjedisit, si dhe efektet e mundshme të këtyre masave mbi konkurrencën.

12. ERE njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë periodikisht, çdo dy vjet, për çdo ndryshim në masat e marra në përputhje me pikën 10 të këtij neni.



SEKSIONI III PRODIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 48

Të licencuarit në prodhimin e energjisë elektrike

1. Prodhimi i energjisë elektrike mund të kryhet vetëm nga persona fizikë ose juridikë që janë të pajisur me licencën e prodhimit të energjisë elektrike, përveç kur përcaktohet ndryshe nga dispozitat e tjera të këtij ligji.

2. Në rastin kur prodhuesi i energjisë elektrike është një shoqëri që kontrollohet plotësisht ose pjesërisht nga shteti, Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të tij, i cili duhet të jetë i pavarur nga pronari i sistemit të transmetimit, në kuptimin e nenit 54 të ligjit.

Neni 49

Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese

1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, të cilat nuk janë objekt koncesioni, ose çdo kapacitet i ri prodhues deri në 2MW, miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese mbi 2 MW, të cilat nuk janë objekt koncesioni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, miraton rregullat dhe procedurat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, mbi baza transparente dhe jodiskriminuese, bazuar në:

- a) sigurinë e sistemit të energjisë elektrike, instalimeve dhe pajisjeve të lidhura me to;
- b) mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë publike;
- c) mbrojtjen e mjedisit;
- ç) përdorimin e truallit dhe vendndodhjen;
- d) efikasitetin e energjisë;
- dh) natyrën e burimeve parësore të energjisë;
- e) karakteristikat e veçanta të aplikuesit, të tilla si aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare;
- ë) përpunimin me masat e marra për shërbimin publik dhe mbrojtjen e klientëve;
- f) kontributin e kapacitetit prodhues në përmbushjen e objektivit për energjinë që duhet të prodhohet nga burimet e rinovueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Faqe | 4604

g) kontributin e kapacitetit gjenerues në reduktimin e emetimeve të gazrave të efektit serë;

gj) shitjen e energjisë elektrike;

h) vlerën e tarifës që do të paguhet në favor të shtetit përfituesi i autorizimit.

3. Në rast refuzimi të dhënies së autorizimit, shkakët e refuzimit duhet të jenë të argumentuara, objektive dhe jodiskriminuese dhe i njoftohen palës së interesuar.

4. Parashikimi i pikës 1 të këtij neni nuk zbatohet për vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW.

Neni 50

Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese për menaxhimin e kërkesës dhe efikasitetit të energjisë

1. Për përmbushjen e objektivave kombëtarë për menaxhimin e kërkesës dhe efikasitetit të energjisë, në rastet kur kapaciteti i instaluar është i pamjaftueshëm të garantojë sigurinë e furnizimit me energji, ministri përgjegjës për energjinë, fillon procedurat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese.

2. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet nëpërmjet një procedure konkurruese të bazuar në legjislacionin në fuqi.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat dhe procedurat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese për menaxhimin e kërkesës dhe efikasitetit të energjisë, mbështetur në parashikimet e pikës 2, të nenit 49, të këtij ligji.

Neni 51

Të drejtat dhe përgjegjësitë e prodhuesit

1. Prodhuesit kanë të drejtë:

a) të përdorin në centralet e tyre elektrike burimet parësore të energjisë, në përputhje me teknologjinë e prodhimit, karakteristikat teknike dhe kushtet e mbrojtjes së mjedisit, që përcaktohen në licencat e tyre dhe legjislacionin në fuqi;

b) të shesin energjinë elektrike dhe të sigurojnë shërbimet ndihmëse dhe të balancimit në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera të ERE-s;



c) të sigurojnë komunikimin në kohë reale me objektet e tyre prodhuese, klientët ose nivelet operative të kontrollit;

ç) të kenë akses në rrjetet e transmetimit e të shpërndarjes, duke paguar tarifat përkatëse, të miratuara nga ERE.

2. Prodhuesit kanë detyrim:

a) të respektojnë kushtet e licencës, përcaktimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) të veprojnë në përputhje me urdhrat e lëshuar nga operatori i sistemit;

c) të sigurojnë shërbime ndihmëse ndaj operatorit të sistemit në përputhje rregullat e tregut; ç) të njoftojnë operatorin e sistemit menjëherë për çdo situatë të krijuar, e cila rrezikon apo do të rrezikojë sigurinë e furnizimit ose përmbushjen e ndonjë detyrimi tjetër kontraktor;

d) të ofrojnë kapacitetin e tyre, bazuar në parimet e tregut, ndaj të gjithë klientëve të tregut me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, përfshirë edhe ata që janë të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

dh) të japin të dhëna në përputhje me detyrimin e transparencës dhe monitorimin e tregut.

Neni 52

Rezerva e lëndës djegëse ose e kapacitetit prodhues

1. Prodhuesit e energjisë elektrike janë të detyruar të mbajnë rezerva të veçanta të lëndëve djegëse ose kapacitete rezervë prodhuese të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurojnë një furnizim të qëndrueshëm të klientëve.

2. Lloji dhe sasia e rezervës së lëndës djegëse ose e kapacitetit rezervë për tipa të ndryshëm të centraleve prodhuese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Kostot e rezervës së lëndës djegëse dhe të kapacitetit rezervë të një prodhuesi konsiderohen si kosto operimi.

SEKSIONI IV TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 53

Operatori i Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik i licencuar për kryerjen e

veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji.

2. ERE jep licencën e re për Operatorin e Sistemit të Transmetimit jo më vonë se data 1 qershor 2016.

3. Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i cili duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e prodhimit apo furnizimit, në kuptim të nenit 54 të ligjit.

Neni 54

Ndarja e pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit ka në pronësi sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, që përfshin linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, nënstacionet e transformimit të energjisë elektrike me nivele të transformimit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe zbarat 110 kV në të gjitha nënstacionet 110/TM kV, deri në pikën e matjes së energjisë në anën 110 kV të transformatorëve 110/TM kV, përfshirë pajisjet kyçëse/shkyçëse të linjave 110 kV. Operatori i Sistemit të Transmetimit operon infrastruktura të tjera të ngjashme të këtij niveli tensioni, të cilat nuk janë në pronësi të tij, që shërbejnë për lëvrimin e energjisë tek operatorit i shpërndarjes dhe/ose klientët e lidhur direkt me sistemin e transmetimit.

3. Duke filluar nga data 1 janar 2016, i njëjti person nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë:

a) të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe të ushtrojë kontroll ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e



transmetimit dhe të ushtrojë kontroll ose të ushtrojë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

c) të emërojë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojë kontroll apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

ç) të jetë anëtar i këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

4. Ndalimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij neni, do të zbatohen në mënyrë të veçantë për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

5. Detyrimi i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

6. Kur personi i përmendur në pikën 3, të këtij neni, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit, i cili ka qenë pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, merr masat që të mos përhapë apo të transferojë informacione të ndjeshme tregtare të njësitë e tjera të shoqërisë së mëparshme të integruar vertikalisht, që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit me energji elektrike dhe të gazit natyror.

Neni 55

Të drejtat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit ka të drejtë të faturojë dhe të arkëtojë tarifën e transmetimit, të miratuar paraprakisht nga ERE, në përputhje me metodologjinë e tarifave.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të blejë dhe të shesë energji elektrike, përveç rastit për mbulimin e humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse e të balancimit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operationale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe parashikimeve të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve, duke përfshirë gjithashtu edhe sistemin *wireless* të nevojshëm për sistemin e transmetimit. Në varësi të mundësive, një pjesë e infrastrukturës së fibrës optike dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e tjera brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-s.

Neni 56

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit ka këto detyra kryesore:

a) siguron aftësinë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetimin e



energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase sistemin e transmetimit, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;

b)kontribuon në sigurinë e furnizimit nëpërmjet sigurisë së sistemit dhe kapaciteteve të qëndrueshme të transmetimit;

c)përdor rrjetin e transmetimit, në përputhje me rregullat dhe standardet teknike;

ç)siguron ofrimin e shërbimeve të sistemit në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, në bazë të parimit të kostos dhe ndikimit mjedisor më të ulët;

d)menaxhon flukset e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet e energjisë elektrike me sistemet e tjera të ndërlidhura dhe siguron të gjitha shërbimet ndihmëse të nevojshme;

dh) ofron ndaj përdoruesve të sistemit të gjithë informacionin e nevojshëm për përdorimin e efektshëm të rrjetit;

e) siguron lidhjen e përdoruesve të sistemit me rrjetin e transmetimit, në bazë të parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë procesin e lidhjes në rrjet;

ë) harton dhe publikon procedura transparente, të efektshme dhe jodiskriminuese për lidhjen e përdoruesve dhe të centraleve të reja të prodhimit të energjisë me sistemin e transmetimit;

f) lidh kontrata, me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe për rezervën e energjisë dhe shërbimet e tjera ndihmëse, të kërkuara për operimin e sigurt të sistemit, bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, rregullave të tregut dhe kostos minimale;

g) harton dhe publikon Kodin e Transmetimit;

gj) kryen balancimin e sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe rregullat e tregut;

h) zbaton rregulla objektive, transparente dhe jodiskriminuese për alokimin e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare;

i) shkëmben informacionin e kërkuar me operatorët e transmetimit të sistemeve fqinje, me qëllim funksionimin e sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve;

j) krijon një mekanizëm të trajtimit të ankesave për çështjet që kanë të bëjnë me aksesin dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit;

k) menaxhon kapacitetin e kufizuar me operatorët e rrjeteve të transmetimit fqinje, në bazë të kritereve objektive, transparente e jodiskrimi-nuese dhe publikon informacionin në lidhje me kapacitetet ndërkufitare, në përputhje me dispozitat e nenit 67 të këtij ligji;

l)ruan informacionin e nevojshëm për vlerësimin e parametrave të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në sistemin e transmetimit, bazuar në rregullat për cilësinë e furnizimit me energji elektrike, përfshirë informacionin mbi sigurimin e furnizimit, cilësinë e tensionit, cilësinë e shërbimit dhe informacione të tjera të përcaktuara nga ERE;

ll) kryen një analizë vjetore të humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe harton e zbaton masat e reduktimit të humbjeve dhe masa të tjera të efikasitetit të energjisë;

m) mbledh pagesat që lidhen me kapacitetet e kufizuara dhe pagesat që lidhen me mekanizmin e kompensimit ndërmjet OST-ve të shteteve fqinje;

n) raporton çdo katër muaj në ERE për:

i) ndërprerjet e planifikuara, të nevojshme për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit;

ii) kërkesat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të përdoruesve të sistemit për zhvillimin e rrjetit të transmetimit;

iii) funksionimin e sistemit të transmetimit;

iv) alokimin dhe përdorimin e kapaciteteve ndërkufitare, në përputhje me detyrimet kontraktuale me OST-të e vendeve fqinje;

v) përdorimin për të ardhurat e siguruara nga kufizimet e kapaciteteve ndërkufitare;

vi) kontratat për sigurinë e shërbimeve ndihmëse, të lidhura me ofruesit e këtij shërbimi;

vii) kontratat e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit paraqet raporte vjetore pranë ERE-s, në përputhje me rregulloren për cilësinë e furnizimit me energji elektrike.

Neni 57

Operimi i tregut

1. Operimi i tregut të energjisë elektrike kryhet nga operatori i tregut, i licencuar nga ERE.



Operatori i tregut është struktura përgjegjëse për menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e rregullave të tregut.

2. Operatori i tregut funksionon në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike dhe parashikimet e këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos, brenda datës 31.12.2017, për ndarjen ligjërishit dhe financiarisht të Operatorit të Tregut nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Neni 58

Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

2. ERE përcakton kërkesat për aplikim për certifikim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, përfshirë dokumentacionin e nevojshëm që provon përmbushjen e kushteve, sipas nenit 54 të këtij ligji. Aplikimi për certifikim paraqitet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, në përputhje me kërkesat e miratuara nga ERE.

3. ERE merr një vendim lidhur me certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit brenda 4 muajve nga data e aplikimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar.

4. ERE mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e këtij detyrimi. ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.

5. ERE njofton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për fillimin e procedurave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe merr vendim brenda 2 muajve nga data e njoftimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke marrë në konsideratë rekomandimet e tij.

6. Nëse vendimi përfundimtar i ERE-s është i ndryshëm nga rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE duhet të publikojë

dhe të arsyetojë shkaqet e mospranimin të tyre, duke informuar Sekretariatit për këtë vendim.

7. Vendimi përfundimtar i ERE-s për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit si dhe relacioni përkatës publikohen në faqen e internetit të ERE-s.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit njofton ERE-n për çdo veprim që planifikon të kryejë, për të cilin mund të kërkohej një rivlerësim, lidhur me pajtueshmërinë e tij me kushtet e parashikuara në nenin 54 të këtij ligji.

9. ERE monitoron përputhshmërinë e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. ERE rishikon procedurën e certifikimit, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në rastet e mëposhtme:

a) pas njoftimit nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, në përputhje me pikën 8 të këtij neni;

b) me nismën e tij, kur ka një dyshim të arsyeshëm se një ndryshim i planifikuar ndikon në të drejtat ose në kontrollin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe mund të çojë në shkelje të dispozitave të nenit 64 ose në rastet kur një shkelje e tillë mund të ketë ndodhur;

Neni 59

Certifikimi në lidhje me shtetet e treta

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit njofton ERE-n, në rastet kur një person ose disa persona të një vendi të tretë, që nuk është anëtar i Komunitetit të Energjisë, marrin kontrollin e këtij operatori.

2. ERE njofton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në rastet:

a) kur kërkohej certifikimi nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, i cili kontrollohet nga një person ose persona nga një vend i tretë;

b) për çdo rrethanë që do të rezultojë, nëse një ose disa persona nga një vend i tretë marrin kontrollin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

3. ERE shqyrton kërkesën për certifikimin, brenda katër 4 muajve nga data e njoftimit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit. ERE ka të drejtë të refuzojë certifikimin nëse:

a) Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk përmbush kërkesat për pavarësinë dhe ndarjen e përcaktuar në këtë ligj;



b) dhënia e certifikimit vë në rrezik sigurinë e furnizimit me energji elektrike të vendit apo vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë. Kur ERE gjykon mbi këtë bazë, merr parasysh:

i) të drejtat dhe detyrimet e Komunitetit të Energjisë në lidhje me atë vend të tretë, që rrjedhin sipas së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të gjitha marrëveshjet e lidhura me një ose më shumë vende të treta, ku Komuniteti i Energjisë është palë dhe që adreson çështjet e sigurisë së furnizimit me energji;

ii) të drejtat dhe detyrimet e Shqipërisë lidhur me atë vend të tretë, që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura me të, për aq sa ato janë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë;

iii) fakte dhe rrethana të tjera specifike të lidhura me vendin e tretë në fjalë.

4. Para marrjes së vendimit ERE kërkon mendim nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë nëse:

a) subjekti i interesuar përmbush kërkesat e pavarësisë;

b) dhënia e certifikimit nuk vë në rrezik sigurinë e furnizimit me energji të vendeve të Komunitetit të Energjisë.

5. Në përgatitjen e opinionit, Sekretariati mund të kërkojë qëndrimin e ERE-s, ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe palëve të interesuara. Sekretariati do të japë mendimin e tij brenda 4 muajve pas marrjes së kërkesës, në përputhje me pikën 4 të këtij neni. Në mungesë të opinionit të Sekretariatit, brenda këtij afati ERE vijon procedurat për marrjen e vendimit.

6. Vendimi përkatës i ERE-s për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose refuzimin për dhënien e certifikimit do t'i njoftohet menjëherë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, së bashku me të gjitha informacionet e nevojshme.

7. Vendimi përfundimtar për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, kontrolli i të cilit merret nga një ose disa persona të një vendi të tretë, miratohet dhe publikohet në përputhje me nenin 58 të këtij ligji.

Neni 60

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton një plan dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, në konsultim me palët e interesuara, dhe e paraqet për miratim në ERE.

2. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet të marrë në konsideratë:

a) kërkesën dhe ngarkesën ekzistuese dhe atë të parashikuar;

b) planifikimin urban dhe rajonal të zonës ku shtrihen instalimet e transmetimit;

c) planet e investimeve për rrjetet rajonale të Komunitetit të Energjisë;

ç) legjislacionin e mbrojtjes së mjedisit.

3. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet të përmbajë:

a) masa efikase, në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit;

b) mjetet financiare të parashikuara për investimet në sistemin e transmetimit;

c) të gjitha investimet e miratuara dhe të identifikojë investimet e reja, të cilat duhet të zbatohen në tri vitet e ardhshme;

ç) afate të përcaktuara për të gjitha projektet e investimeve;

d) informacion për pjesëmarrësit e tregut për infrastrukturën transmetuese kryesore që duhet të ndërtohet ose të përmirësohet gjatë dhjetë viteve të ardhshme.

4. ERE shqyrton planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit dhe në rast se vëren se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, kërkon nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të plotësojë dhe/ose të ndryshojë planin e tij dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit paraqet pranë ERE-s, së bashku me aplikimin për miratimin e tarifës, planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit aplikon për një tarifë për një periudhë rregullatore më të madhe se 1 vit, programi i investimeve do të përmbajë një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse.



6. Kur ERE konstaton se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka realizuar për tre vite, një investim të parashikuar sipas planit 10-vjeçar, dhe gjykon se investimi është i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon atij të marrë një nga këto masa:

- a) të realizojë investimin në fjalë;
- b) të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori;
- c) të pranojë rritjen e kapitalit, me qëllim financimin e investimeve të nevojshme.

7. Kur ERE merr masa, sipas shkronjës “b”, të pikës 6, të këtij neni, mund të detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

- a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;
- b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;
- c) të administrojë asetet e reja pas ndërtimit.

Në këto raste tarifat përkatëse do të mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.

8. ERE në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë.

9. ERE harton dhe miraton një rregullore për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit.

Neni 61

Dispeçerimi i energjisë elektrike

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për dispeçerimin e energjisë elektrike nga centralët prodhuese dhe përdorimin e linjave të interkoneksionit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike.

2. Dispeçerimi i energjisë elektrike nga centralët prodhuese dhe përdorimi i linjave të interkoneksionit bëhet mbështetur në Kodin e Transmetimit, rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera në fuqi, të miratuara nga ERE.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i japë prioritet energjisë elektrike të prodhuar nga centralët që përdorin burime të rinovueshme të energjisë elektrike, për aq sa mund të lejojë siguria e operimit të rrjetit kombëtar të energjisë, duke u bazuar në kriteret transparente dhe jodiskriminuese. Në rastet kur Operatori i Sistemit të Transmetimit

apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes merr masa për të reduktuar kapacitetin prodhues nga centralët që përdorin burimet e rinovueshme të energjisë, për të garantuar sigurinë e operimit të sistemit elektroenergetik dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike të klientëve, informon Entin Rregullator të Energjisë për masat e marra dhe propozon masat të tjera korrigjuese që do të ndërmarrë në të ardhmen, në mënyrë që të parandalojë reduktimet e panevojshme të kapaciteteve prodhuese.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të përmbushë kërkesat për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, përfshirë edhe kapacitetet e interkoneksionit, në përputhje me parashikimet e Kodeve të Rrjetit.

Neni 62

Prokurimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit, shërbimet e balancimit dhe shërbimet ndihmëse

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.

2. Procedurat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, miratohen nga ERE pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të sigurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjet, shërbimet e balancimit dhe ato ndihmëse, me anë të kontratave bilaterale, të miratuara nga ERE për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. ERE është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të procedurave, të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 63

Kodi i Transmetimit

1. Operimi i sistemit të transmetimit kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit, i cili hartohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, në përputhje me kërkesat e Kodit të Rrjetit të ENTSO-e dhe miratohet nga ERE.



2. Kodi i Transmetimit parashikon:

a) metodat dhe kriteret për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit;

b) kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për akses në sistemin e transmetimit;

c) specifikimet minimale teknike dhe funksionale për dhënien e aksesit dhe lidhjen me sistemin e transmetimit të centraleve prodhuese, shoqërive shpërndarëse, konsumatorëve fundorë, si dhe linjave të interkoneksionit;

ç) afatin në të cilin Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i përgjigjet aplikimit të paraqitur, si dhe pasojat në rast se përgjigja nuk jepet brenda afatit të parashikuar;

d) shërbimet e balancimit dhe ato ndihmëse;

dh) planin operacional dhe rregullat e planifikimit;

e) administrimin dhe kontrollin e sistemit në kushtet normale dhe emergjente të operimit;

ë) rregullat e matjes;

f) kriteret e aplikuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për dispeçerimin e instalimeve prodhuese në dispozicion, si dhe për përdorimin e linjave të interkoneksionit.

g) mënyrën, afatin, kushtet dhe detyrimet, sipas të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit dispeçeron energjinë e prodhuar prej burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike.

gj) çdo veprimtari tjetër të nevojshme për administrimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit të transmetimit.

h) mënyrën e funksionimit dhe të operimit të operatorit të tregut.

Neni 64

Konfidencialiteti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit, duke respektuar në çdo rast përcaktimet e nenit 47, të këtij ligji, apo ndonjë detyrim tjetër ligjor për dhënien e informacionit, ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguar gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe parandalon përhapjen në mënyrë diskriminuese të informacionit për veprimtarinë e tij, me qëllim që të krijojë avantazh tregtar te një palë tjetër.

2. OST-ja nuk përhap të dhënat e ndjeshme tregtare te çdo i licencuar tjetër, përveçse kur kjo është e nevojshme për kryerjen e një transaksioni

tregtar. Për të siguruar respektimin e plotë të rregullave të përhapjes së informacionit dhe ndarjes së veprimtarive, ERE merr masa që Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe çdo i licencuar tjetër të mos përdorin shërbime të përbashkëta, të tilla si shërbime të përbashkëta ligjore, përveç funksioneve të thjeshta administrative apo të teknologjisë së informacionit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, nuk keqpërdor informacionin e ndjeshëm tregtar të siguar nga palët e treta, në kuadër të ofrimit apo negocimit të aksesit në sistem.

4. Informacioni i nevojshëm që garanton konkurrencën dhe funksionimin normal të tregut bëhet publik.

Neni 65

Alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit, e cila miratohet nga ERE.

2. Rregullorja për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit parashikon:

a) publikimin e informacionit për kapacitetet e interkoneksionit;

b) shkëmbimin e informacionit për kapacitetet e interkoneksionit me operatorët e vendeve fqinje;

c) menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve transmetuese disponibël të interkoneksionit;

ç) të dhëna për tregun sekondar të tregtimit të kapaciteteve të interkoneksionit;

d) parime të përgjithshme dhe procedura për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar;

dh) përdorimin e të ardhurave nga alokimi i kapaciteteve të linjave të interkoneksionit dhe nga menaxhimi i kapacitetit të kufizuar.

e) detyrimin e pjesëmarrësit të tregut për të njoftuar paraprakisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit, nëse do të përdorin kapacitetin e alokuar dhe periudhën e përdorimit të tij;

ë) rialokimin në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese të çdo kapaciteti të alokuar që nuk do të përdoret prej pjesëmarrësit të tregut.

3. Alokimi i kapaciteteve nuk duhet të diskriminojë pjesëmarrësit e tregut që dëshirojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre për zbatimin e kontratave dypalëshe të furnizimit apo për të ofertuar në tregun e hapur të energjisë elektrike.



4. Operatori i Sistemit të Transmetimit, së bashku me operatorët respektivë të vendeve fqinje, publikojnë kapacitetet e disponueshme që do të alokohen, duke përfshirë, sipas rastit, edhe kapacitetet e çliruara nga të drejtat e transmetimit të siguruara më parë, si dhe periudhën kohore, gjatë së cilës kapaciteti do të reduktohet ose nuk do të jetë i disponueshëm.

5. Në procedurat e alokimit të kapaciteteve mund të marrin pjesë të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Për të shmangur problemet në treg, që lidhen me krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të një apo disa pjesëmarrësve, ERE dhe/ose Autoriteti i Konkurrencës, sipas rastit, mund të vendosin kufizime të përgjithshme ose të veçanta ndaj një pjesëmarrësi të tregut, për shkak të pozitës dominuese të tij.

6. Në procedurat e alokimit të kapaciteteve nuk lejohet vendosja e çmimeve bazë, përveç rastit të linjave të reja të interkoneksionit, të cilat përjashtohen sipas nenit 32 të këtij ligji.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të pranojë të gjitha transaksionet e mundshme tregtare, përfshirë edhe ato që rrjedhin prej tregtisë me vendet kufitare.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do të zbatojë masa që kufizojnë aksesin e pjesëmarrësve të tregut në linjat e interkoneksionit, përveç rastit të kapacitetit të kufizuar.

9. Procedura e alokimit të kapaciteteve të disponueshme të transmetimit zhvillohet në afate të arsyeshme, përpara momentit të fillimit të shfrytëzimit të kapaciteteve.

10. Të drejtat e aksesit për alokimin e kapaciteteve konsiderohen si të drejta të fituara, bazuar në parimet e përcaktuara në rregulloren e alokimit të kapaciteteve.

Neni 66

Përdorimi i të ardhurave nga alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit

1. Çdo e ardhur që rezulton nga alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit përdoret për qëllimet e mëposhtme:

a) garantimin e disponueshmërisë së kapacitetit aktual; dhe/ose

b) mirëmbajtjen dhe rritjen e kapaciteteve të interkoneksionit, nëpërmjet realizimit të investimeve në rrjet, veçanërisht në shtimin e kapaciteteve të reja të interkoneksioneve të reja.

2. Në rastet kur këto të ardhura nuk mund të përdoren në mënyrë efikase për qëllimet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, atëherë, me miratimin paraprak të ERE-s, ato mund të konsiderohen si fitim deri në një vlerë të caktuar dhe merren parasysh në llogaritjen e tarifave të rrjetit, në përputhje me metodologjitë përkatëse.

Neni 67

Menaxhimi i kapacitetit të kufizuar

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar, e cila miratohet nga ERE.

2. Rastet e kapacitetit të kufizuar të rrjetit trajtohen në mënyrë jodiskriminuese, duke u siguruar pjesëmarrësve të tregut dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit trajtimin e tyre, mbështetur në parimet e tregut.

3. Rregullorja për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar, bazohet në parimet e mëposhtme:

a) procedurat e kapacitetit të kufizuar do të kryhen vetëm në rast situatash të jashtëzakonshme, në të cilat Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të veprojë në mënyrë të shpejtë dhe kur ridispeçerimi ose shkëmbimi i flukseve të energjisë nuk është i mundur. Çdo procedurë e tillë duhet të zbatohet në mënyrë jodiskriminuese;

b) pjesëmarrësit e tregut do të kompensohen për çdo kufizim të aplikuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për sa u takon kapaciteteve të alokuara, përveç rasteve të forcës madhore;

c) kapaciteti maksimal i linjave të interkoneksionit dhe/ose rrjetit të transmetimit, i cili ndikon në flukset ndërkufitare, është i disponueshëm për pjesëmarrësit e tregut, në përputhje me standardet e sigurisë së operimit të sistemit;

ç) Operatori i Sistemit të Transmetimit, për aq sa është teknikisht e mundur, balancon flukset e energjisë elektrike që vijnë në drejtimin e kundërt, në linjën e interkoneksionit me kapacitet të kufizuar, në mënyrë që të përdorë kapacitetin maksimal të saj;



d) në funksion të sigurisë së rrjetit, Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do të pengojë transaksione, të cilat ulin mundësinë e kufizimit të kapaciteteve.

SEKSIONI V SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 68

Shpërndarja e energjisë elektrike

1. Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në pikën 2, të nenit 54, të këtij ligji.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për:

a) sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;

b) përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike,

c) mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ofron pa diskriminim shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes respekton treguesit e cilësisë së shërbimit dhe kërkesat e parashikuara nga rregulloret teknike.

5. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike zhvillohet mbi parimin e kostos më të ulët, në përputhje me legjislacionin mbi planifikimin urban, të drejtat e pronësisë, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe përdorimin me eficiencë të energjisë.

6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve teknologjike. Në varësi të mundësive, pjesë të infrastrukturës së komunikimeve dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të

komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e veta brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-s.

Neni 69

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:

a) operon një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm;

b) zhvillon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe parashikimet e kërkesës për shpërndarjen e energjisë elektrike;

c) lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët dhe/ose prodhuesit, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi;

ç) siguron akses jodiskriminues të klientëve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

d) u siguron përdoruesve të rrjetit informacionin për akses dhe përdorim të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes;

dh) mbledh dhe paraqet tek Operatori i Sistemit të Transmetimit të dhënat e nevojshme për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj, rregullat e tregut dhe rregullat për ndryshimin e furnizuesit;

e) ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

ë) prokuron energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me procedura transparente jodiskriminuese. Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike miratohen nga ERE, pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

f) harton profile të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme;

g) mban evidencën e shoqërive të licencuara që furnizojnë me energji elektrike, në të gjitha pikat e lidhjes dhe pikat e matjes së rrjetit respektiv shpërndarës;

gj) i siguron, pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët



furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi. ERE përcakton formatin e të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave;

h) ofron shërbime të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve, sipas këtij neni.

Neni 70

Të drejtat e OSSH-së lidhur me burimet dytësore të energjisë

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton kushtet teknike, që miratohen nga ERE, për instalimin e një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike për klientët që kërkojnë këtë shërbim, përfshirë edhe kushtet që duhet të përmbushë burimi dytësor, me qëllim që të parandalohen çrregullimet në rrjet.

2. Çdo klient, që kërkon të instalojë burimin dytësor, dërgon paraprakisht një njoftim me shkrim pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe njëkohësisht u siguron përfaqësuesve të furnizuesit, me të cilin ka kontratë furnizimi, akses në burimin dytësor, me qëllim inspektimin e këtij instalimi.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me energji elektrike për një klient, në rast se nuk përmbush detyrimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 71

Të drejtat lidhur me sistemet e mbyllura të shpërndarjes

1. ERE mund të klasifikojë si sistem të mbyllur shpërndarjeje, atë sistem që shpërndan energji elektrike brenda një zone gjeografikisht të kufizuar industriale, tregtare apo shërbimesh të përbashkëta, nga i cili nuk shpërndahet energji për klientët familjarë ose klientët jofamiljarë të vegjël dhe nëse:

a) për arsye të veçanta teknike apo të sigurisë, veprimtaritë ose proceset e prodhimit të përdoruesve të këtij sistemi janë të integruara; ose,

b) ky sistem shpërndan energji elektrike kryesisht te pronari, tek operatori i sistemit të mbyllur apo shoqëri të lidhura me të.

2. ERE mund të përjashtojë operatorin e një sistemi të mbyllur shpërndarjeje nga:

a) detyrimi i përcaktuar në nenin 69, për të prokuruar energjinë që përdor për të mbuluar humbjet në rrjet dhe kapacitetin rezervë në sistemin e tij, sipas procedurave transparente, jodiskriminuese, konkurruese dhe të bazuara në treg;

b) detyrimi që tarifat ose metodologjitë e llogaritjes së tyre të jenë sipas parashikimeve të nenit 21, të këtij ligji, të miratuara nga ERE para hyrjes në fuqi të tyre.

3. Kur është dhënë një përjashtim, sipas pikës 2, të këtij neni, tarifat e aplikueshme ose metodologjitë për llogaritjen e tyre, me kërkesë të një përdoruesi të sistemit të mbyllur të shpërndarjes, do të shqyrtohen dhe do të miratohen nga ERE, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji.

4. Përjashtimi, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të jepet edhe në rastet kur energjia elektrike përdoret nga një numër i vogël i klientëve familjarë dhe jofamiljarë të vegjël, të cilët ndodhen në zonën e mbuluar nga një sistem i mbyllur i shpërndarjes dhe vjen si rrjedhojë e marrëdhënieve të punësimit ose raporteve të ngjashme me pronarin e sistemit të shpërndarjes.

5. Operatori i Sistemit të mbyllur të Shpërndarjes ushtron aktivitetin sipas licencës për sistemin e mbyllur të shpërndarjes dhe rregullave përkatëse të funksionimit, të miratuara nga ERE.

Neni 72

Ndarja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili ushtron këtë funksion përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përmbush detyrimin e ndarjes, jo më vonë se data 31.12.2017.

2. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie vertikalisht të integruar, në mënyrë që të provojë organizimin dhe funksionimin ligjor, të ndarë nga aktivitetet e tjera, duhet të mbajë një emër tregtar dhe markë



tregtare, të ndryshme nga emrat dhe markat tregtare të aktiviteteve të tjera që nuk lidhen me shpërndarjen e energjisë elektrike.

3. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie vertikalisht të integruar, me qëllim që të jetë i pavarur në aspektin organizativ dhe të vendimmarrjes nga aktivitetet e tjera që nuk lidhen me shpërndarjen e energjisë elektrike, ai duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes. Për plotësimin e këtyre kushteve, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, përfshirë ato njerëzore, teknike, fizike dhe financiare. Shoqëria mëmë (kontrolluese), në përputhje me legjislacionin në fuqi, gëzon të drejta lidhur me mbikëqyrjen ekonomike, menaxhuese dhe vendimmarrëse, për çështje, të cilat janë në kompetencë të saj. Shoqëria mëmë (kontrolluese) nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operacionale të sistemit të shpërndarjes së energjisë dhe as të marrë vendime të caktuara lidhur me ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit të të cilave nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë apo legjislacionin në fuqi;

b) të hartojë dhe të depozitojë në ERE një program vjetor, i cili përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe realizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në aktivitetin ekonomik e financiar të saj, përfshirë edhe mekanizmat për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Ky program përcakton detyrat specifike të punonjësve për arritjen e këtyre objektivave;

c) personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të marrin pjesë në strukturat përgjegjëse të shoqërisë së integruar, në mënyrë direkte ose indirekte, lidhur me veprimtarinë e përditshme operacionale të prodhimit, transmetimit dhe furnizimit me energji elektrike;

ç) personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes janë të aftë profesionalisht dhe veprojnë në mënyrë të pavarur

për përmbushjen e detyrave dhe objektivave të shoqërisë. Trajtimi financiar i personave përgjegjës për menaxhimin dhe personat përgjegjës për organet mbikëqyrëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që kontrollohet nga shteti, do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

d) në shoqërinë e integruar vertikalisht, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të marrë masa që të shmangë krijimin e paqartësive të palët e interesuara lidhur me emrin dhe markën tregtare të përdorur, në mënyrë që të demonstrohet identiteti i veçantë i tij, në raport me shoqërinë e furnizimit.

dh) aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes monitorohen nga ERE, e cila, në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, siguron shmangien e përfitimeve të mundshme nga operatori që cenon konkurrencën.

Neni 73

Kodi i Shpërndarjes

1. Kodi i Shpërndarjes përcakton kërkesat teknike për planifikimin, zgjerimin, funksionimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes dhe rregullat specifike për lidhjen dhe aksesin në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rregullat e matjes.

2. Kodi i Shpërndarjes miratohet nga ERE, me propozim të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, me qëllim hartimin, rishikimin apo përshtatjen e tij.

3. Funksionimi i rrjetit të shpërndarjes duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes.

Neni 74

Konfidencialiteti i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, duke respektuar në çdo rast përcaktimet e këtij ligji apo ndonjë detyrim tjetër ligjor për dhënien e informacionit, ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe parandalon përhapjen në mënyrë diskriminuese të informacionit për veprimtarinë e tij, me qëllim që të krijojë avantazh tregtar të një palë tjetër.



Neni 75

Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes për 5 vitet e ardhshme kalendarike dhe e paraqet për miratim në ERE.

2. Plani i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes, përmban masat që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes planifikon të ndërmarrë për:

- a) eficientë e energjisë;
- b) menaxhimin e kërkesës;
- c) zhvillimin apo përmirësimin e sistemit të shpërndarjes;

ç) informacion për mjetet financiare të siguruar për investimet në sistemin e shpërndarjes.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, gjatë hartimit të planit, merr në konsideratë zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe planifikimin urban dhe rajonal për zonën ku do të zhvillohet sistemi i shpërndarjes.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kur aplikon për tarifa, paraqet pranë ERE planin e përditësuar të investimeve që i korrespondon periudhës përkatëse rregullatore.

5. Kur ERE konstaton se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk ka realizuar për tre vite një investim të parashikuar sipas planit 5-vjeçar dhe gjykon se investimi është i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon të marrë një nga këto masa:

- a) të realizojë investimin në fjalë;
- b) të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori.

6. Kur ERE merr masa sipas shkronjës “b”, të pikës 5, të këtij neni, mund të detyrojë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

- a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;
- b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;
- c) të administrojë asetet e reja pas ndërtimit.

Tarifat përkatëse do të mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.

7. ERE në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 5 dhe 6 të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë.

8. ERE harton dhe miraton një rregullore për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit.

SEKSIONI VI**MATJA E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Neni 76

Matja e energjisë elektrike

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes janë përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse.

2. Me miratim të ERE-s, në përputhje me Kodin e Matjes, operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes mund të kontraktojnë operatorë të pavarur për kryerjen e veprimtarisë së matjes dhe/ose shërbimeve të leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse.

3. Energjia elektrike e hedhur në rrjet ose e furnizuar te klientët fundorë matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e Kodeve të Rrjetit dhe Kodin e Matjes, si dhe në legjislacionin në fuqi për metrologjinë. Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

4. Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

5. Matësi dhe/ose sistemi matës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për metrologjinë dhe pas instalimit duhet të bashkëvulosen nga operatori i sistemit dhe DPM-ja, ose nga personi juridik i autorizuar prej saj. Vula miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Klasa e saktësisë së matësve të energjisë elektrike përcaktohet në Kodin e Matjes.

Neni 77

Verifikimi i matësve

1. Verifikimi i matësve të energjisë elektrike kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose nga një person juridik i autorizuar prej saj. Personi juridik i autorizuar për këtë qëllim akreditohet sipas legjislacionit në fuqi.



2. Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike.

3. Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo personit juridik të autorizuar. Periodiciteti i verifikimit të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në Kodin e Matjes. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i operatorit të sistemit.

4. Gjatë procesit të verifikimit të matësve të energjisë elektrike nga DPM-ja ose nga personi juridik i autorizuar, përfaqësuesi i operatorit të sistemit duhet të jetë i pranishëm në çdo rast. DPM-ja miraton procedurat përkatëse të verifikimit të matësve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

5. Kostot financiare për verifikimin përpara vënies në përdorim dhe verifikimin periodik të matësit apo verifikime të iniciuara nga operatori i sistemit përballohen nga ky i fundit. ERE merr në konsideratë këto kosto të shkaktuara operatorit, gjatë miratimit të tarifave përkatëse.

6. Kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit të rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për verifikimin e aparatit matës. Procedura për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njofimit të kërkuarit miratohen me vendim të ERE-s. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.

7. Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, bëhen përlogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës dhe mënyra e rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.

8. Tarifat tavan për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për energjinë.

9. Operatori i sistemit nëse konstaton ndërhyrje të paligjshme, merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve, në të cilat

është ndërhyrë, përlogarit dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. ERE miraton rregulloren dhe metodologjinë përkatëse për vendosjen dhe përlogaritjen e dëmit ekonomik nga ana e operatorit të sistemit.

10. ERE miraton kontratën tip ndërmjet operatorit të sistemit dhe DPM-së ose subjektit të autorizuar nga ana e saj për verifikimin e matësve.

Neni 78

Sistemet matëse inteligjente

1. Në veprimtarinë e matjes së energjisë elektrike mund të implementohen sisteme matëse inteligjente te klientët fundorë.

2. Operatori i sistemit të shpërndarjes, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përgatit vlerësimin ekonomik i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje.

3. Në bazë të vlerësimit të përcaktuar në pikën 2, operatori i sistemit të shpërndarjes përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë.

4. ERE siguron ndërveprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në gjithë territorin e vendit.

PJESA E GJASHTË

FURNIZIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

SEKSIONI I

Neni 79

Veprimtaritë e furnizimit

1. Furnizimi me energji elektrike i klientëve fundorë mund të bëhet nga çdo i licencuar, i cili është i pajisur me licencë për furnizim me energji elektrike, të lëshuar nga ERE.

2. Furnizuesit blejnë energji elektrike për furnizimin e klientëve fundorë në tregun e brendshëm dhe/ose nëpërmjet importit.

3. Furnizimi me energji elektrike i klientëve fundorë bëhet me çmime të parregulluara, i cili



përcaktohet në bazë të kontratave të negociuara ndërmjet furnizuesit dhe klientit fundor.

4. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 2 dhe 3, të këtij neni, sipas parashikimit të nenit 109, pika 1, të këtij ligji, ERE përcakton çmime të rregulluara për kategori të caktuara klientësh, në kuadrin e vendosjes së detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve, sikurse përcaktohet në nenin 47 dhe 83 të këtij ligji.

Neni 80

Kontrata e furnizimit me energji elektrike

1. Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit dhe klientit të energjisë elektrike përcaktohen në kontratën e nënshkruar nga palët.

2. Kontrata, përveç kushteve të përcaktuara në legjislacionin civil, mund të përmbajë edhe kushte të tjera në varësi të karakterit specifik dhe llojit të shërbimit të ofruar nga furnizuesi si më poshtë:

a) kohën e lidhjes në rrjet të klientit, si dhe nivelet e cilësisë së shërbimit të ofruar;

b) parashikimet lidhur me kompensimin dhe rimbursimin, në rast mospërmbushjeje të nivelit të cilësisë së shërbimit të kontraktuar, duke përfshirë këtu edhe faturimin e pasaktë dhe të vonuar;

c) çmimin dhe mënyrën e njoftimit të ndryshimit të çmimit dhe të kushteve të tjera të furnizimit me energji elektrike;

ç) mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

3. Këto kushte duhet të jenë të drejta dhe të balancojnë interesat e palëve. Kontrata nuk duhet të përmbajë kushte që kufizojnë të drejtën e klientit apo që përcaktojnë tarifa financiare për të ndryshuar furnizuesin e energjisë elektrike.

4. Përpara lidhjes së kontratës, klientëve duhet t'u sigurohet një informacion i detajuar dhe transparent me shkrim për kushtet kryesore të kontratës.

Neni 81

Detyrimet e furnizuesve

1. Furnizuesi, në zbatim të këtij ligji, ka detyrimin të furnizojë klientët me energji elektrike, në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

2. Furnizuesi është përgjegjës përballë operatorit të sistemit të transmetimit për çdo disbalancë të shkaktuar. Klientët fundorë janë

përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara. ERE vendos përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, për kategori të caktuara të klientëve fundorë, të cilët furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik.

3. Furnizuesi, përveç detyrimeve të përgjithshme, të përcaktuara në kontratë, informon klientët e tij për:

a) të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të energjisë elektrike;

b) konsumin dhe kostot aktuale të energjisë elektrike, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të energjisë nga ana e klientëve;

c) mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm;

ç) mundësinë e përdorimit të procedurave të thjeshta për ndjekjen e ankesave të tyre;

d) ndryshimin e kushteve të kontratës të paktën 15 ditë përpara zbatimit të tyre, duke përfshirë informacionin në lidhje me të drejtën e klientëve për të zgjedhur në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit, me dhënien e njoftimit;

dh) të dhënat e konsumit të tij, duke i mundësuar çdo klienti akses ndaj të dhënave të matjes, në bazë të një marrëveshjeje të qartë dhe pa pagesë;

e) të drejtat e tyre, në përputhje me udhëzuesin e miratuar nga Komiteti i Energjisë.

4. Furnizuesit nëpërmjet faturës së konsumit të energjisë elektrike dhe/apo materialeve promovuese, informon në mënyrë të qartë klientët për:

a) të dhëna për çdo burim energjie të siguruar nga furnizuesi gjatë vitit të mëparshëm;

b) elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse;

c) të dhënat për ndikimin në mjedis të gazit karbonik dhe mbeturinave radioaktive të emetuara gjatë prodhimit të energjisë elektrike, të siguruar nga furnizuesi në vitin e mëparshëm.



Neni 82

Të drejtat e furnizuesit

Furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 80, të këtij ligji, kanë këto të drejta:

a) të përdorin, sipas kushteve të rregulluara, shërbimet e operatorit të tregut, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në bazë të rregullave të tregut, Kodeve të Rrjetit dhe kontratave përkatëse;

b) të kenë akses në sistemin e transmetimit dhe sistemin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat për aksesin e palëve të treta, të përcaktuar në nenin 29, të këtij ligji.

c) të kërkojnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kur klienti nuk përmbush detyrimet kontraktore, dhe rilidhjen e energjisë elektrike, kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktuan ndërprerjen e furnizimit.

Neni 83

Shërbimi universal i furnizimit si detyrim i shërbimit publik

1. Furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, furnizojnë vetëm klientët fundorë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE. Furnizuesit, në funksion të detyrimit të shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, nuk furnizojnë klientët fundorë që dalin në treg të liberalizuar, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 109, të këtij ligji.

2. Furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, blejnë energji elektrike sipas procedurave transparente, jodiskriminuese, bazuar në çmimet e tregut, pavarësisht nëse blerja bëhet në tregun bilateral apo të organizuar.

Neni 84

Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik

1. ERE miraton kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike, që lidhet ndërmjet klientit fundor dhe furnizuesit të ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit, si një detyrim i shërbimit publik.

2. Furnizuesi universal, përveç kushteve të kontratës, të parashikuara në nenin 80, të këtij ligji, duhet:

a) të informojë klientët për të drejtat e tyre dhe për kushtet e furnizimit sipas shërbimit universal;

b) të njoftojë klientët për kushtet e furnizimit dhe çmimin e energjisë elektrike, përfshirë informimin për të drejtën e tyre për të zgjedhur një furnizues tjetër;

c) të furnizojë me energji elektrike, në kushtet e shërbimit universal, kategori të caktuara të klientëve brenda territorit, për të cilin janë licencuar, për të kryer shërbimin universal, sipas parashikimeve të neneve 83 dhe 85 të këtij ligji;

ç) të njoftojë klientin për marrjen e masave për ekzekutimin e detyrueshëm për detyrimet e papaguara;

d) të furnizojë klientët në nevojë, duke respektuar kushtet e përcaktuara në nenin 96 të këtij ligji;

dh) të paguajë për energjinë e lëvruar, sipas shërbimit universal të furnizimit, në përputhje me çmimet e miratuara nga ERE, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji;

e) të publikojë në faqen e internetit çmimet e furnizimit në kushtet e shërbimit universal, të miratuara nga ERE.

3. Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit publikohen në faqen e internetit të ERE-s, si dhe në faqet e internetit të furnizuesit.

Neni 85

Kushtet për çmimet e rregulluara

1. ERE përcakton çmime të rregulluara vetëm për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal të furnizimit, sipas parashikimit të nenit 83, pika 1, të këtij ligji.



2. Çmimet e energjisë, objekt rregullimi, për qëllim të shërbimit universal të furnizimit, reflektojnë kostot e përcaktuara në metodologjitë përkatëse.

3. ERE përcakton afatin e aplikimit të çmimeve të rregulluara për kategoritë e caktuara të klientëve dhe rishikon mbi baza vjetore nivelin e çmimit të miratuar.

Neni 86

Furnizuesi i mundësisë së fundit

1. Furnizuesi i mundësisë së fundit është i detyruar të furnizojë klientët, të cilët mbeten pa furnizues, kur:

- a) furnizuesi i mëparshëm është në kushtet e paaftësisë paguese ose është në proces falimentimi;
- b) furnizuesit të mëparshëm i është hequr ose i është pezulluar përkohësisht licenca;
- c) klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg.

2. Në rastin kur furnizuesi nuk është i aftë për të furnizuar me energji elektrike klientin fundor, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, ai është i detyruar të njoftojë furnizuesin e mundësisë së fundit, klientin fundor, ERE-n dhe operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes jo më vonë se 15 ditë përpara datës, në të cilën do të ndërpresë furnizimin me energji elektrike.

3. Në rastin kur furnizuesi nuk është i aftë për të furnizuar me energji elektrike klientin fundor, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, ERE njofton furnizuesin e mundësisë së fundit, klientin fundor, operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, jo më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të vlefshmërisë së licencës ose nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, për heqjen ose pezullimin e licencës.

4. Kontrata për furnizimin e klientit fundor nga furnizuesi i mundësisë së fundit, pavarësisht nëse është nënshkruar apo jo, do të konsiderohet e lidhur në datën për të cilën është njoftuar se do të ndërpritet furnizimi i energjisë, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij neni, apo në datën kur klienti njofton furnizuesin e mundësisë së fundit se kërkon të furnizohet prej tij, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni.

5. Klienti fundor, që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 60 ditëve nga fillimi i kontratës. Në përfundim të kësaj periudhe operatori i sistemit ndërpret furnizimin me energji elektrike të këtij klienti.

Neni 87

Përcaktimi i furnizuesit të mundësisë së fundit

1. Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit.

2. ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, cakton furnizuesin e mundësisë së fundit.

3. Furnizuesi i mundësisë së fundit caktohet për një periudhë prej tre vjetësh. Vendimi i caktimit përmban kushtet e shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit, informacion në lidhje me përcaktimin e çmimeve dhe ndryshimet e tij, si dhe kushtet kontraktore.

4. Çmimi, me të cilin furnizuesi i mundësisë së fundit furnizon me energji elektrike, përcaktohet nga ERE sipas metodologjisë së miratuar prej saj, në përputhje me përcaktimet e nenit 21 të këtij ligji.

5. Furnizuesi i mundësisë së fundit vë në dispozicion të klientit fundor kontratën e furnizimit me energji elektrike, brenda tri ditëve nga dita e fillimit të furnizimit.

6. Furnizuesi i mundësisë së fundit publikon në faqen e tij të internetit, të paktën një herë në vit, një informacion për numrin e klientëve të furnizuar, sasinë totale të energjisë elektrike të lëvruar, periudhën mesatare të furnizimit, të ndarë sipas kategorive të klientëve.

7. Furnizuesi i mundësisë së fundit, i caktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron këtë funksion deri në caktimin e furnizuesit të ri nga ERE, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 88

Ndryshimi i furnizuesit

1. Ndryshimi i furnizuesit bëhet me kërkesë të klientit fundor dhe pa kosto shtesë për të. Furnizuesi aktual është i detyruar të furnizojë klientin fundor deri në përfundimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit.



2. Rregullat për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike miratohen nga ERE dhe përmbajnë:

a) afatin maksimal, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni;

b) kushtet që duhet të plotësojë furnizuesi i ri lidhur me rregullat për balancimin;

c) detyrimet e operatorit të sistemit në të cilin është i lidhur klienti fundor;

ç) detyrimin e klientëve fundorë që të kenë ekzekutuar të gjitha detyrimet në raport me furnizuesin e parë.

3. Çdo ankesë, lidhur me procedurën e ndryshimit të furnizuesit, paraqitet në ERE. Ankesa nuk pezullon afatin për ndryshimin e furnizuesit dhe/ose të hyrjes në fuqi të kontratës së re të furnizimit.

Neni 89

Ruajtja e të dhënave

1. Të licencuarit për furnizimin e energjisë elektrike ruajnë të dhëna për kontratat e furnizimit me energji elektrike, për kontratat me operatorët e shitjes me shumicë dhe operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, për një periudhë të paktën pesëvjeçare. Këto të dhëna, nëse kërkohet, mund t'i vihen në dispozicion ERE-s dhe/ose Autoritetit të Konkurrencës.

2. Të dhënat përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve, të tilla si kohëzgjatja, rregullat e shpërndarjes dhe të shlyerjes, sasia, afatet e ekzekutimit, çmimet e transaksionit, mjetet e identifikimit të operatorit të shitjes me shumicë në fjalë, detajet e specifikuara për të gjitha kontratat e pashlyera të furnizimit me energji elektrike, si dhe derivativët e energjisë elektrike.

3. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut pjesë të këtij informacioni, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.

Neni 90

Situatat emergjente në furnizimin me energji elektrike

1. Këshilli i Ministrave mund të shpallë gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike në rast të:

a) një force madhore, përfshirë edhe një thatësirë, e cila redukton prodhimin e hidrocentraleve në Shqipëri;

b) masave të marra nga strukturat shtetërore për garantimin e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e vendit;

c) aksidenteve dhe avarive në pajisjet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së sistemit të energjisë elektrike;

ç) mungesave afatgjata të burimeve parësore energjetike për prodhimin e energjisë elektrike.

2. Gjatë situatave emergjente, të licencuarit dhe klientët duhet të respektojnë kufizimet në përdorimin e energjisë elektrike. Ministri përgjegjës për energjinë përcakton shtrirjen dhe mënyrën e kufizimit të furnizimit me energji elektrike.

3. Kufizimet e furnizimit në situata të jashtëzakonshme bazohen në kritere të paracaktuara, që kanë të bëjnë me menaxhimin e disbalancave prej Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Çdo masë mbrojtëse merret në konsultim të ngushtë me operatorët e sistemeve të transmetimit të vendeve ndërkufitare, duke respektuar marrëveshjet përkatëse dypalëshe, përfshirë edhe marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit.

4. Të licencuarit nuk janë përgjegjës për sanksionet e ardhura si rezultat i ndërprerjes ose kufizimit të energjisë elektrike, për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur situata e emergjencës vjen si rezultat direkt i fajit të të licencuarit.

5. Në situata emergjente, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe pas marrjes së mendimit të Komitetit për Emergjencat Civile, Këshilli i Ministrave mund të vendosë mbi të licencuarit detyrimin e shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit, duke përfshirë detyrimin e importit të energjisë elektrike, detyrimin e furnizimit vetëm të kategorive të caktuara të klientëve ose kushte të tjera të veçanta në kryerjen e aktiviteteve të licencuara. Ky detyrim do të jetë në përpjesëtim me emergjencën dhe nuk duhet të shtrihet përtej periudhës së nevojshme për kapërcimin e kësaj situatë.

6. Çdo kosto shtesë e shkaktuar ndaj të licencuarit, për shkak të vendosjes së detyrimit të shërbimit publik, pasi vlerësohet nga Ministria e Financave dhe ERE, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe Komitetit për Emergjencat Civile, kompensohet nga Buxheti i Shtetit. Ky kompensim do të jetë në përputhje me



nenin 47 të këtij ligji dhe me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

SEKSIONI II

PAGIMI I DETYRIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDAJ FURNIZUESIT TË NGARKUAR ME SHËRBIMIN UNIVERSAL TË FURNIZIMIT SI DETYRIM I SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 91

Pagesa e detyrimeve të energjisë elektrike ndaj furnizuesit të ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik

Klienti fundor i energjisë elektrike është i detyruar të paguajë detyrimet e energjisë, sipas përcaktimeve të kontratës së furnizimit. Nëse klienti nuk paguan detyrimin e energjisë elektrike, furnizuesi i energjisë elektrike, i ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik, njofton me shkrim klientin për masat që do të marrë për arkëtimin e detyrimit, sipas përcaktimeve të kontratës dhe/ose të këtij ligj.

Neni 92

Masat e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve të papaguara

Për të siguruar ekzekutimin e detyrimit të papaguar furnizuesi, në përputhje me parashikimet e kontratës, merr masat e mëposhtme:

a) fillon procedurën e ndërprerjes së energjisë elektrike;

b) fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, duke kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, të ndryshuar;

c) vendos barrën hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme që furnizohet me energji elektrike, në rast se detyrimi i papaguar, që rrjedh nga një kontratë furnizimi energjie elektrike, është mbi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për klientin jofamiljar.

Neni 93

Vendosja e barrës hipotekore

1. Për detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të përcaktuara në shkronjën “c”, të nenit 92, të këtij ligji, furnizuesi njofton klientin për fillimin e procedurës për vendosjen e barrës hipotekore. Njoftimi bëhet me shkrim dhe i dërgohet klientit me postë me lajmërim marrjeje.

2. Klienti brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit, ka të drejtë të ankimojë fillimin e procedurave për vendosjen e barrës hipotekore pranë furnizuesit. Furnizuesi shqyrton ankimin brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

3. Kur ankesa e klientit vlerësohet e drejtë nga furnizuesi dhe/ose konstatohet se klienti ka shlyer detyrimet e papaguara brenda afatit të ankimit, furnizuesi nuk vijon me procedurën për vendosjen e barrës hipotekore.

4. Kërkesa për të vendosur barrën hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme, bëhet me shkrim nga furnizuesi dhe i drejtohet zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku gjendet pasuria e paluajtshme. Kërkesa i njoftohet me postë me lajmërim marrjeje klientit fundor. Kërkesa për vendosjen e barrës hipotekore duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për të identifikuar klientin, detyrimin e papaguar dhe pasurinë objekt të barrës hipotekore.

5. Me vendosjen e barrës hipotekore, furnizuesi fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm nëpërmjet përmbarduesit gjyqësor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, të ndryshuar.

6. Klienti ka të drejtë të ankimojë vendosjen e barrës hipotekore në gjykatë.

PJESA E SHTATË KLIJNTËT DHE MBROJTJA E KLIJNTIT

Neni 94

Të drejtat dhe detyrimet e klientëve

1. Të gjithë klientët kanë të drejtë të zgjedhin furnizuesin e tyre të energjisë elektrike, vendas ose të huaj, me çmime të parregulluara, sipas një marrëveshjeje furnizimi, e cila është në përputhje



me rregullat e tregut dhe kushtet e përgjithshme për furnizim, të miratuar nga ERE.

2. Klienti fundor ka të drejtë:

a) të furnizohet me energji elektrike në përputhje me kushtet e vendosura në kontratë;

b) të paraqesë ankesë pranë ERE-s, nëse nuk furnizohet sipas kushteve të vendosura në kontratë;

c) të përfitojë nga furnizuesi një trajtim jodiskriminues;

ç) të marrë të gjitha informacionet e nevojshme nga furnizuesit, në përputhje me nenin 81 të këtij ligji;

d) të marrë informacion të plotë për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike;

dh) të përdorë mekanizma të ndryshëm të pagesës dhe të mbrohet prej metodave të padrejta të faturimit;

e) të mos paguajë asnjë kosto shtesë lidhur me ndryshimin e furnizuesit;

ë) të përfitojë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre, të cilat kur është e mundur, parashikojnë një sistem rimbursimi dhe/ose kompensimi.

f) të informohet për të drejtën e tij për sa i përket shërbimit universal të furnizimit, në përputhje me nenin 83 të këtij ligji;

g) të informohet për konsumin e tij dhe kostot respektive të energjisë elektrike, në varësi të pajisjeve matëse, me të cilat është i pajisur klienti. Ky shërbim ofrohet pa kosto shtesë për klientin;

gj) të marrë një informacion për konsumin dhe gjendjen financiare të mbylljes, pas çdo ndryshimi të furnizuesit të energjisë elektrike, jo më vonë se 20 ditë nga ndryshimi i tij.

3. Klienti fundor ka detyrim:

a) të paguajë për energjinë elektrike, në përputhje me kushtet e kontratës;

b) t'i mundësojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ose Operatorit të Sistemit të Transmetimit instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të energjisë elektrike;

c) të respektojë kushtet e kontratës së furnizimit.

4. Klientët jofamiljarë, të lidhur në rrjetin e tensionit të mesëm dhe rrjetin e tensionit të lartë, kanë të drejtë të kontraktojnë në të njëjtën kohë disa furnizues.

Neni 95

Klientët në nevojë

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Financave, dhe në konsultim me ERE-n e grupet e interesit, harton kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë marrin në konsideratë:

a) klientët me të ardhura më të ulëta, të cilët e përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit tyre të përhershëm;

b) klientët që kanë konsum të energjisë elektrike të lidhur në rrjetin njëfazor me një fuqi maksimale prej 16 amper;

c) nivelin maksimal të konsumit të energjisë për person, në varësi të sezonit;

ç) mënyrën e përkrahjes së drejtpërdrejtë nga Buxheti i Shtetit.

3. Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, regjistrohen në një regjistër të veçantë nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale. Ky informacion i dërgohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit të energjisë elektrike.

4. Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, duhet të përdorin fondet e përfituara për të paguar detyrimet e energjisë elektrike.

5. Financimi për mbështetje të klientëve në nevojë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese, duke mos lejuar ndërfinancimin nga kategoritë e tjera të klientëve të energjisë elektrike.

6. Nëse për shkak të ndryshimit të rrethanave, klienti humb statusin e klientit në nevojë, struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale e heq nga regjistri i klientëve në nevojë dhe njofton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe



furnizuesin. Të dhënat e klientit të hequr nga regjistri i klientëve në nevojë duhet të ruhen për një periudhë prej 5 vjetësh pas çregjistrimit.

7. Mbi bazën e të dhënave të përcjella, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesi krijojnë dhe ruajnë një regjister të të dhënave të klientëve në nevojë. Të dhënat e regjistrimit mund t'i vihen në dispozicion klientit në nevojë, në çdo kohë që kërkohen nga ky i fundit.

Neni 96

Furnizimi për klientët në nevojë

1. Klientët familjarë, të cilët kanë përfutur statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 95, të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit të furnizimit universal, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë fillon në ditën që klienti regjistrohet prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si klient në nevojë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes paraqet informacion për furnizuesit e shërbimit universal për klientët në nevojë, brenda 5 ditëve nga regjistrimi i tyre.

3. Furnizuesi i klientit në nevojë i paraqet këtij të fundit kontratën dhe e informon rreth të drejtave dhe kushteve të furnizimit nën shërbimin universal.

4. Klienti në nevojë furnizohet me energji elektrike sipas tarifave të miratuara nga ERE dhe në përputhje me nenin 85 të këtij ligji.

5. Furnizuesi, që furnizon me energji elektrike klientin në nevojë, mund të ndërpresë shërbimin, bazuar në kushtet specifike për këtë kategori klientësh, të miratuara nga ERE.

6. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë përfundon në fund të muajit të dytë, nga momenti i çregjistrimit të klientit si klient në nevojë prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dërgon informacion te furnizuesi për klientët e çregjistruar, sipas njoftimit për daljen nga kategoria e klientit në nevojë, në fund të çdo muaji.

PJESA E TETË

TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 97

Tregu i energjisë elektrike

1. Tregu i energjisë elektrike është tregu ku energjia elektrike shitet dhe blihet drejtpërdrejt, ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, në bazë të kontratave dypalëshe dhe/ose tregu i organizuar nëpërmjet platformës për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë.

2. Parashikimet e këtij ligji nuk pengojnë hyrjen në marrëdhënie të ndërsjella me vendet e tjera për krijimin dhe funksionimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike si pjesë e një tregu të integruar.

3. Ministri përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me palët e interesuara në sektorin e energjisë elektrike dhe pasi merr mendimin e Autoritetit të Konkurrencës, harton modelin e tregut të energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen të paktën:

a) mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike;

b) marrëdhëniet kontraktore të nevojshme;

c) informacioni dhe shkëmbimi i të dhënave kryesore, të kërkuara mes pjesëmarrësve të tregut.

4. Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike kontribuojnë në mirëfunksionimin dhe transparencën e tregjeve me shumicë dhe pakicë.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për bashkëpunimin rajonal në kuadër të Komunitetit të Energjisë.

6. Tregtarët dhe furnizuesit e energjisë elektrike, të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, bazuar në parimet e reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 98

Rregullat e tregut

1. ERE, me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj dhe modelin e



tregut të energjisë elektrike, ku përfshihen rregullat për planifikimin, dispeçerimin, balancimin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kërkesat për menaxhimin e rezervës.

2. Rregullat e tregut miratohen nga ERE.

Neni 99

Përgjegjësia e balancimit të pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike

1. Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.

2. Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin, nëpërmjet një kontrate me Operatorin e Sistemit të Transmetimit duke marrë statusin e palës përgjegjëse për balancim ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut.

3. Operatori i tregut është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella për disbalancat e shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut.

4. Mënyra e trajtimit të disbalancave, të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe kostot përkatëse për mbulimin e tyre, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 100

Tregu i balancimit të energjisë elektrike

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron shërbimet e balancimit të sistemit prej ofruesve të këtij shërbimi në tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit, të miratuara nga ERE.

2. Rregullat e balancimit përcaktojnë kushte lidhur me:

a) ofruesit e shërbimit të balancimit, sigurimin e shërbimeve të balancimit, përcaktimin e sasive të energjisë për t'u përdorur prej ofruesve të shërbimit të balancimit dhe shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj ofruesve të shërbimit të balancimit;

b) pjesëtarët përgjegjës të grupit balancues, përfshirë krijimin dhe menaxhimin e llogarive të grupit balancues, përcaktimin e sasive të energjisë që do të përdoren për disbalancimin dhe përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të grupit të balancimit.

3. Deri në krijimin e tregut të balancimit, tarifat për realizimin e shërbimit të balancimit vendosen sipas metodologjisë së miratuar nga ERE. Kjo metodologji duhet të reflektojë kostot dhe bëhet publike.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit bashkëpunon me operatorët e tjerë të rrjeteve të transmetimit të vendeve fqinje për sigurimin e tregut balancues në nivel rajonal, me qëllim garantimin e sigurisë operationale dhe funksionimin e efektshëm të tregut të balancimit, bazuar në parimin e konkurrencës efektive, mosdiskriminimit dhe transparencës.

PJESA E NËNTË TË DREJTAT E PRONËSISË

Neni 101

Të drejtat e pronësisë të të licencuarve

1. Për sigurinë e shërbimit të energjisë elektrike, i licencuari mund të kërkojë përdorimin e një ose të disa prej të drejtave të mëposhtme mbi pronën:

- a) të drejtën për linjat;
- b) të drejtën e përdorimit;
- c) të drejtën e servitutit;
- ç) shpronësimin.

2. Kur ushtrohen të drejtat, sipas pikës 1, të këtij neni, dëmet e shkaktuara nga:

- a) vendosja e shenjave, matjeve apo testeve;
- b) instalimi i pajisjeve, aksesit apo kryerja e punës në to;

c) pengimi ose kufizimi i përdorimit të pronës, i rimbursohen pronarit ose përdoruesit të pronës nga i licencuari, në përputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik.

3. Në zonat natyrore të mbrojtura, të drejtat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, jepen me miratimin paraprak të autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura. Në zonat që janë në administrim të njësisë të qeverisjes vendore nevojitet miratimi paraprak i njësisë përkatëse vendore.

4. Në rast të përfundimit të të drejtave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, i licencuari merr masa për rehabilitimin e plotë të pronës së përdorur.



5. Kur klienti fundor ndodhet në një ndërtesë me shumë apartamente banimi ose strukturë me disa biznese, i licencuari ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, të cilat janë të nevojshme për sigurinë e furnizimit të këtij klienti.

Neni 102 Servituti ligjor

1. Bazuar në dispozitat e neneve 53 dhe 68, të këtij ligji, e drejta e servitutit ligjor i garantohet OST-së ose OSSH-së për instalimin dhe funksionimin e rrjetit të shpërndarjes ose transmetimit mbi pronën e të tretëve, duke garantuar përdorimin e pronës në përputhje me legjislacionin civil.

2. Në përputhje me servitutin ligjor, i licencuari për veprimtaritë e transmetimit ose shpërndarjes mund të kryejë në pronën e të tretit veprimet e mëposhtme:

a) instalon dhe vendos nën tokë dhe/ose mbi tokë linja elektrike dhe linjat e komunikimit elektronik;

b) instalon struktura mbajtëse, pajisjet e transformimit dhe ato kyçëse/shkyçëse të vendosura mbi to;

c) instalon dhe shfrytëzon në pronën e të tretit linja të varura (teleferik dhe linja) të përdorura për qëllimet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik, nënstationeve, linjave të transmetimit dhe të strukturave të saj mbështetëse;

ç) shfrytëzon, mban, riparon, transformon dhe heq pajisjet e instaluar, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike;

d) heq pemët, shkurret, degët e tyre dhe rrënjët e ndodhura brenda zonës së sigurisë së linjave, të cilat cenojnë sigurinë e funksionimit të tyre;

dh) mund të lidhet dhe të kapërcejë rrugët e transportit, lumenjtë, rrjedhat e ujërave, liqenet, kanalet dhe ndërtesat, sipas procedurave të parashikuara në rregulloret teknike dhe legjislacionin në fuqi.

3. Çdo e drejtë servituti, e vendosur sipas këtij neni, jepet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë të përjashtuar nga aplikimi i çdo takse apo tarife të vendosur prej organeve të qeverisjes vendore mbi

asetet, rrjetet dhe instalimet përkatëse që i përkasin këtyre operatorëve.

Neni 103

Detyrimet e operatorëve ndaj rrjeteve të tyre

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes administrojnë rrjetet dhe marrin masa që gjatë ndërtimit dhe operimit të tyre të respektojnë të gjitha kërkesat dhe kushtet teknike e të sigurisë, duke përfshirë edhe respektimin e distancave të sigurisë së rrjeteve në raport me objektet e tjera që u përkasin palëve të treta.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk kanë asnjë detyrim ndaj pretendimeve të personave fizikë ose juridikë për dëme të shkaktuara, si rezultat i distancës së rrjeteve të transmetimit apo shpërndarjes në raport me çdo objekt apo strukturë, në pronësi apo posedim të tyre, në rast se objekti ose struktura apo pjesë të tij/të saj janë ndërtuar apo vendosur në këto distanca pas ndërtimit të rrjetit të shpërndarjes apo transmetimit.

Neni 104

E drejta e përdorimit të përkohshëm

1. Pjesë të centraleve prodhuese, pajisje të sistemeve të transmetimit, shpërndarjes dhe ato ndihmëse mund të vendosen, të funksionojnë dhe të mirëmbahen në pronën e të tretëve, në bazë të së drejtës së përdorimit të përkohshëm.

2. E drejta e përdorimit të përkohshëm rregullohet sipas legjislacionit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.

Neni 105

Shpronësimi

1. Për vendosjen e centraleve, të nënstationeve, të kabinave elektrike ose të linjave të transmetimit të energjisë elektrike, i licencuari mund të kërkojë nisjen e procedurës së shpronësimit të pronës së një personi të tretë, në përputhje me legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.

2. Nisja e procedurës së shpronësimit, me qëllim instalimin dhe funksionimin e rrjeteve të

transmetimit e të shpërndarjes dhe të strukturave të tyre mbështetëse, mund të kërkohej vetëm nëse e drejta e servitutit, sipas nenit 102, të këtij ligji, pengon ose ndërpret në mënyrë thelbësore përdorimin e rregullt të pronës.

3. Procedura e shpronësimit për instalimin dhe funksionimin e pajisjeve të transformimit dhe të pajisjeve kyçëse/shkyçëse që nuk janë të vendosura në struktura mbështetëse, që i përkasin centralit të prodhimit të energjisë elektrike, mund të fillojë vetëm nëse palët nuk bien dakord për të drejtën e përdorimit, sipas neneve 101 dhe 102, të këtij ligji, ose nëse autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe rregullimit të territorit nuk e kanë miratuar atë.

PJESA E DHJETË DISPOZITA TË TJERA

Neni 106

Hetimet administrative

1. ERE, në përmbushje të detyrimeve të saj, sipas nenit 19, të këtij ligji, në bazë të fakteve të siguruar për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, mund të vendosë fillimin e hetimit administrativ për këto shkelje të evidentuara.

2. Hetimet administrative bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave, të miratuara nga ERE.

Neni 107

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, të kryera prej të licencuarve, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga ERE me gjobë nga 0,1 për qind deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit:

a) moszbatim i vendimeve të ERE-s;

b) refuzimi i paraqitjes së të dhënave dhe raporteve periodike apo dërgimi me vonësë i tyre ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licencuari;

c) moszbatim i detyrimeve lidhur me llogaritjen dhe aplikimin e kostove dhe tarifave;

ç) moszbatim i detyrimeve të shërbimit publik, të vendosura sipas nenit 47 të këtij ligji;

d) moszbatim i detyrimeve për ndarjen e veprimtarive të licencuara;

dh) moszbatim i detyrimeve për mbajtjen e llogarive të ndara, sipas neneve 35, 54 dhe 72 të këtij ligji;

e) moszbatim i detyrimeve që lidhen me aksesin e palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet në dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

ë) moszbatim i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara;

f) mospublikimi i informacionit për tarifat dhe kushtet e përgjithshme të aksesit në rrjet, si dhe përdorimit të shërbimeve të rrjetit;

g) mosparaqitja e programeve të investimeve dhe/ose moskryerja e investimeve të planifikuara, sipas kërkesave të neneve 20, shkronja “P”, 60 dhe 75, të këtij ligji, dhe rregullores përkatëse të ERE-s;

gj) shkelja e kushteve dhe kërkesave të cilësisë së furnizimit të miratuar nga ERE;

h) moszbatim i vendimeve të ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

i) shkelja e detyrimeve dhe kushteve të licencës si dhe rregullave të ERE-s që nuk janë përmendur në pikat e mësipërme;

j) refuzimi i pjesëmarrësve të tregut për të nënshkruar kontrata të rregulluara brenda 15 ditëve kalendarike;

k) moskryerja e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar. Në këtë rast, ERE, përveç gjobës, ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, për çdo ditë vonësë në pagesën e saj. Vlera e kamatëvonesës përcaktohet në bazë të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar.

2. ERE aplikon gjobë progresive, për çdo ditë shkelje nga i licencuari për rastet e mëposhtme:

a) kur i licencuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korrigjimin e një shkeljeje brenda afateve të përcaktuara prej saj. Në këtë rast, i licencuari dënohet me gjobë në masën 0,1 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonësë nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s;

b) kur i licencuari nuk përmbush detyrimin e pagesës së taksës rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me gjobë në masën 0,2 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonësë nga dita e përcaktuar për pagesën.



3. Masat e gjobave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të reduktohen nga ERE, në masën dhe rastet si më poshtë:

a) në masën 50 për qind, në rastet kur shkelja, për të cilën parashikohet gjoba, është njoftuar nga vetë i licencuari;

b) në masën 1/3, në rastet kur i licencuari bashkëpunon në mënyrë aktive në procesin e hetimit administrativ të ERE-s për konstatimin e shkeljes në fjalë;

c) në masën 40 për qind, në rastet kur i licencuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja, përpara ose gjatë konstatimit të shkeljes nga ERE.

4. ERE harton dhe miraton një rregullore të posaçme lidhur me kushtet dhe procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.

5. Vendimi i ERE-s për konstatimin dhe vendosjen e gjobës ndaj të licencuarve është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

6. Gjobat e vendosura sipas këtij neni derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 108

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”; 6, pika 1; 31, pika 2; 33, pika 4; 34, pika 1; 36; 42, pika 5; 47, pika 1; 48, pika 2; 49, pika 2; 50, pika 3; 52, pika 2; 53, pika 3; 72, pika 3, shkronja “ç”; 87, pika 1; 95, pika 1; 97, pika 3; dhe 99, pika 4, të tij.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për energjinë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të nenit 5, pika 2, të tij.

3. Ngarkohet ERE që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 1; 9, pika 2; 11, pika 7; 14, pika 1; 16, pika 1; 17; 19; 20; 21, pika 6; 24, pika 1; 27, pika 3; 38, pika 1; 39, pika 1; 42, pika 3; 44, pika 2; 45, pika 1; 58, pika 2; 60, pika 9; 61, pika 2; 62, pika 2; 63, pika 1; 65, pika 1; 67, pika 1; 69, pikat 8 e 11; 70, pika 1; 71, pika 5; 73, pika 2; 75, pika 8; 76, pika 4; 77, pikat 6 e 10; 83, pika 1; 84,

pika 1; 87, pika 4; 88, pika 2; 96, pika 5; 98 pikat 1 e 2; 100, pikat 1 e 3; dhe 106, pika 2, të tij.

Neni 109

Dispozita kalimtare

1. Klientët e energjisë elektrike me tension 110 kV e sipër, si dhe çdo klient tjetër që, pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit të energjisë elektrike, në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madhe se 50 milionë kWh, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohet se kanë dalë në treg të liberalizuar. Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV janë të detyruar të dalin në tregun e liberalizuar jo më vonë se data 30 qershor 2016, klientët e lidhur në tension 20 kV, jo më vonë se data 31 dhjetor 2016, ndërsa klientët e lidhur në nivelin e tensionit 10 kV dhe 0,6 kV, jo më vonë se data 31 dhjetor 2017. Klientët e lidhur në tension 0,4 kV kanë të drejtë të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre.

2. Licenca për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, e lëshuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të jetë e vlefshme për kryerjen e aktiviteteve të licencuara, deri në certifikimin e tij, sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj dhe lëshimin e një licence të re.

3. Kryetari dhe anëtarët e bordit, të cilët kryejnë këtë funksion në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë ta kryejnë deri në përfundimin e mandatit të tyre.

4. Deri në vendosjen e detyrimit të shërbimit publik për të licencuarit, sipas përcaktimeve të nenit 47, të këtij ligji, përmbushja e këtyre funksioneve do të vazhdojë të kryhet nga të licencuarit që ushtrojnë këto funksione në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 110

Shfuqizimi i akteve

1. Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.



2. Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Neni 111
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9115, datë 25.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 44/2015

**KODI I PROCEDURAVE
ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**KREU I
QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT DHE
PËRKUFIZIME**

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky Kod zbatohet kur organi publik, në ushtrimin e funksioneve publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative:

a) vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave, si dhe çdo rast tjetër, kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ;

b) lidh një kontratë administrative apo kryen një veprim tjetër administrativ, i cili ka të bëjë me të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave.

2. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për rastet kur:

a) personat juridikë, publikë apo privatë, që ushtrojnë funksione vetë-rregulluese në fushën e profesioneve të rregulluara, të krijuara me ligj apo që u është dhënë e drejta e ushtrimit të këtyre funksioneve, në bazë të legjislacionit në fuqi, vendosin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni;

b) personat privatë, të cilëve u është dhënë e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi, vendosin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni;

c) personat juridikë, publikë apo privatë, të cilët ofrojnë shërbime publike, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve të shërbimit.

3. Parimet e sanksionuara në këtë Kod zbatohen për aq sa është e mundur edhe mbi aktet normative nënligjore.

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akti administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi



subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

c) “Akti i garancisë” është një akt administrativ individual, me anë të të cilit organi publik, nëse kjo parashikohet me ligj të veçantë, mund të sigurojë paraprakisht, se ai do të nxjerrë ose nuk do të nxjerrë një akt të caktuar administrativ individual në një datë të mëvonshme.

2. “Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij.

3. “Diskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.

4. “Kontrata administrative” është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik.

5. “Kompetenca administrative” është tërësia e kompetencave lëndore dhe kompetencave territoriale të organit të administratës publike, siç është parashikuar në ligj dhe aktet nënligjore.

6. “Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike.

7. “Palë” është:

a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një

procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose

b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.

8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.

9. “Procedurë administrative” është veprimtaria e një organi publik, me qëllim përgatitjen dhe miratimin e veprimeve konkrete administrative, ekzekutimin e tyre dhe rishikimin e tyre me mjete ligjore administrative.

10. “Veprim administrativ” është akti administrativ, kontrata administrative dhe çdo veprim tjetër administrativ.

11. “Veprim tjetër administrativ” është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, që nuk plotëson kriteret për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjell pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitimë.

12. “Veprimtari administrative” është tërësia e akteve dhe veprimeve, që përbëjnë dhe shprehin vullnetin e administratës publike, si dhe ekzekutimin e vullnetit.

KREU II

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 4

Parimi i ligjshmërisë

1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.



Neni 5

Parimi i transparencës

Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.

Neni 6

Parimi i informimit

1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit.

2. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

Neni 7

Parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror

Çdo nëpunës publik, si dhe çdo person që merr pjesë ose thirret për pjesëmarrje në një procedurë administrative, është i detyruar të mos përhapë të dhëna që i janë bërë të ditura gjatë procedurës administrative, kur ato përbëjnë “Sekret shtetëror”, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit

Pjesëmarrësit në një procedurë administrativ kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale dhe konfidenciale të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Parimi i mbrojtjes së të dhënave

1. Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarre masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre.

2. Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin shtrihet edhe mbi nëpunësin publik, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

Neni 10

Parimi i dhënies së ndihmës aktive

1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik.

3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit.

Neni 11

Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit

Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- a) është i parashikuar me ligj;
- b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;
- c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe;
- ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.

Neni 12

Parimi i proporcionalitetit

1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.



2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:

a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;

b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe

c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Neni 13

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë

Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Neni 14

Parimi i objektivitetit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.

Neni 15

Parimi i përgjegjësisë

Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 16

Parimi i marrjes së vendimeve

Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, një organ publik merr vendime për të gjitha çështjet e ngritura nga një palë, të cilat janë në kompetencë të tij.

Neni 17

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit

1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.

2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.

3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.

Neni 18

Parimi i deburokratizimit dhe i efikasitetit

1. Procedura administrative nuk i nënshtrohet ndonjë forme të caktuar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.

2. Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.

Neni 19

Parimi i mospagimit në procedurat administrative

1. Procedura administrative është pa pagesë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

2. Tarifa për zhvillimin e një procedure administrative nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e procedurës, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj.

3. Organi publik që zhvillon procedurën nuk kërkon pagesën e tarifave edhe në rastet kur kjo parashikohet me ligj, kur palët janë në pamundësi për të paguar. Kategoritë që janë në kushte pamundësie përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Gjuha dhe përkthimi në procedurën administrative

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, procedura administrative kryhet në gjuhën dhe shkrimin shqip.

2. Nëse pala duhet të paraqesë një kërkesë



brenda afatit dhe e bën këtë në një gjuhë të huaj, organi publik e njofton palën për detyrimin për ta paraqitur kërkesën në gjuhën dhe shkrimin shqip. Nëse për arsye teknike pala nuk është në gjendje të sigurojë përkthimin brenda datës së përfundimit të afatit të rregullt për paraqitjen e kërkesës, organi publik cakton një afat shtesë të përshtatshëm, brenda të cilit duhet të sigurohet një përkthim i kërkesës dhe dokumenteve të nevojshme.

3. Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, fjalia e parë konsiderohet se është respektuar vetëm nëse organi publik merr përkthimin brenda afatit shtesë të caktuar dhe të njoftuar nga organi publik.

4. Nëse kërkesat, të cilat përcaktojnë fillimin e afatit, brenda të cilit organi publik duhet të veprojë, merren në një gjuhë të huaj, afati fillon në datën kur organit publik i vihet në dispozicion një përkthim i tyre.

5. Nëse organi publik nuk përcakton dhe nuk i njofton palës një afat shtesë për përkthimin dhe pasojat ligjore, sipas fjalisë së dytë, të pikës 2, të këtij neni, kërkesa në gjuhë të huaj vlerësohet e paraqitur brenda afatit.

Neni 21

Parimi i kontrollit

Veprimtaria administrative i nënshtrohet:

a) kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi;

b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; dhe/ose

c) çdo kontrolli tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

PJESA E DYTË

JURIDIKSIONI, KOMPETENCA, DELEGIMI DHE ZËVENDËSIMI

KREU I

JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCA

Neni 22

Përcaktimi i juridiksionit dhe kompetencës

1. Fusha e ushtrimit të veprimtarisë dhe tërësia e kompetencave të organeve publike, të rregulluara nga legjislacioni në fuqi, përbën juridiksionin administrativ.

2. Kompetencat e organeve publike janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre. Ushtrimi i tyre është i detyrueshëm.

3. Delegimi ose zëvendësimi i kompetencave mund të bëhet vetëm nëse:

a) parashikohet shprehimisht në ligj;

b) ligji parashikon organin ose nëpunësin zëvendësues ku bëhet delegimi ose zëvendësimi.

Neni 23

Verifikimi i kompetencës

1. Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.

2. Çdo ndryshim ligjor ose nënligjor i mëvonshëm i kompetencës nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi, në të cilin procedura ka nisur, nuk ekziston më, ose kur legjislacioni i ri parashikon ndryshe.

Neni 24

Mungesa e kompetencës

1. Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë.

2. Afatet për kërkuesin vlerësohen të respektuara nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent, ndërsa afatet përkatëse për organin publik kompetent fillojnë të llogariten nga data e marrjes së kërkesës.

3. Palët nuk mund të përcaktojnë apo të ndryshojnë, me marrëveshje, kompetencën e organit publik.

Neni 25

Ndalimi i heqjes dorë nga kompetenca

1. Çdo veprim administrativ, që ka për qëllim heqjen dorë të organit publik nga e drejta për të ushtruar kompetencat ligjore, është i pavlefshëm.

2. Detyrimi për ushtrimin e kompetencave lëndore dhe tokësore dhe parashikimi i pikës 1, të këtij neni, nuk përjashtojnë të drejtën e organit publik për të deleguar kompetencën e tij ligjore në favor të organeve të tjera të administratës, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod.



Neni 26

Kompetenca në rastet urgjente

Nëse organi publik kompetent nuk mund të veprojë apo të veprojë menjëherë për shmangien e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm që mund t'i shkaktohet interesit publik apo të drejtave a interesave të të tretëve, prefekti në nivel vendor dhe Kryeministri në nivel qendror, kryesisht apo me kërkesë, marrin masa urgjente për shmangien e dëmit. Në këto raste, informohet menjëherë organi publik kompetent për masat e marra.

Neni 27

Mosmarrëveshjet e kompetencave

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, konkurrimi i kompetencave ndërmjet dy ose më shumë organeve publike zgjidhet me marrëveshje me shkrim midis tyre.

2. Në rast se ato nuk arrijnë në një marrëveshje, konflikti zgjidhet nga:

a) Kryeministri, në rast të konfliktit ndërmjet ministrive të ndryshme;

b) ministri ose titullari i institucionit qendror ose epror, për institucionet e varësisë;

c) gjykata administrative, për të gjitha rastet e tjera, për të cilat ajo është kompetente.

3. Zgjidhja e konfliktit mund të kërkohej nga secili prej organeve të përfshira, me marrjen dijeni të konfliktit.

4. Konflikti sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, zgjidhet brenda 10 ditëve nga dita e depozitimit të kërkesës.

KREU II

**DELEGIMI I KOMPETENCAVE DHE
ZËVENDESIMI I TYRE**

Neni 28

Delegimi i kompetencave

1. Organet publike kompetente mund të delegojnë kompetencat e tyre ligjore te një organ tjetër publik.

2. Organet publike kompetente mund të delegojnë kompetencat e dhëna me ligj ose me akte nënligjore tek organet e tyre vartëse.

3. Organet kolegjiale të administratës publike nuk mund t'i delegojnë kompetencat e tyre në favor të drejtuesve të tyre.

Faqe | 4634

4. Organi i deleguar ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes delegimit.

5. Çdo vendim i organit delegues, që ka për qëllim autorizimin e organit të deleguar për të nëndeleguar kompetencat e nëndeleguara, është i pavlefshëm.

Neni 29

Procedura e delegimit

1. Kur ligji e lejon, delegimi i kompetencave bëhet në çdo rast me vendim të organit delegues për organet në varësi të tij dhe me vendim ose me marrëveshje në ato raste kur organi i deleguar nuk është në varësi të organit delegues.

2. Në aktin e delegimit përcaktohen:

a) kompetencat e deleguara;

b) financimi i detyrave të deleguara;

c) institucioni i ngarkuar me mbikëqyrjen, si dhe objekti e instrumentet e mbikëqyrjes;

ç) kriteret e ndërprerjes dhe mekanizmat për kryerjen e detyrave të deleguara, në rast të ndërprerjes së delegimit;

d) datën e fillimit të ushtrimit kompetencave të deleguara.

3. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare ose në buletinet e njoftimeve publike. Në rastet e organeve të qeverisjes vendore, delegimi botohet në gazetën e njësisë së qeverisjes vendore apo në buletinet zyrtare të akteve të njësisë të qeverisjes vendore dhe, kur nuk ekziston një i tillë, njoftimi përkatës afishohet në vende publike.

PJESA E TRETË

**GARANTIMI I PAANSHMËRISË SË
ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Neni 30

Pengesat ligjore

Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse, në rastet kur:

a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;

b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;



c) nëpunësi publik, ose anëtari i organit kolegjal ose edhe personat e parashikuar në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;

ç) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;

d) personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim;

dh) ndaj nëpunësit publik ose personave të parashikuar në shkronjën “b”, të këtij neni, ka nisur një proces gjyqësor nga palët në procedurën administrative në shqyrtim;

e) çështja në shqyrtim është një ankim kundër një vendimi të marrë nga nëpunësi publik ose nga personat e parashikuar në shkronjën “b” të këtij neni;

ë) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, janë debitorë ose kreditorë të palëve të interesuara në procedurën administrative në shqyrtim;

f) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të procedurës administrative shqyrtim;

g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim;

gj) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, janë përfshirë në çdo lloj mënyre në:

i) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e nëpunësit apo personave të përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat, pas lënies së detyrës, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

ii) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profe-

sionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;

h) në çdo rast kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 31

Vetëdeklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përjashtim

1. Nëse nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal të organit publik vëren një nga pengesat e parashikuara në nenin 30, të këtij Kodi, ai njofton menjëherë me shkrim eprorin e tij ose organin kolegjal.

2. Çdo nëpunës tjetër, i cili ka dijeni mbi rastet e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 30, të këtij Kodi, njofton në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Pala mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtari të organit kolegjal nga një procedurë administrative, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet eprorit dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet.

4. Në çdo rast, deri në marrjen nga eprori të një vendimi përfundimtar, nëpunësi pezullohet nga procesi vendimmarrës.

Neni 32

Vendimmarrja dhe efektet e përjashtimit

1. Eprori ose organi kolegjal, i njoftuar sipas nenit 31, të këtij Kodi, merr vendim për përjashtimin ose konfirmimin e nëpunësit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit ose kërkesës së palëve.

2. Kur eprori vendos përjashtimin e nëpunësit, në vendimin e përjashtimit caktohet edhe nëpunësi zëvendësues. Nëse organi kolegjal përjashton një anëtar dhe ligji nuk parashikon anëtarë zëvendësues, procedura administrative vazhdon pa zëvendësuar anëtarin e përjashtuar.

3. Kur, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës konkrete, vërtetohet se është i pamundur zëvendësimi i një zyrtari me një zyrtar tjetër, lejohet vendimmarrja nga nëpunësi publik.

4. Në rastet e përjashtimit dhe pamundësisë së zëvendësimit, organi funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar.



PJESA E KATËRT
PROCEDURA ADMINISTRATIVE

KREU I
PJESËMARRJA NË PROCEDURËN
ADMINISTRATIVE

Neni 33

Pala në procedurën administrative

1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;

b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose

c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.

2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.

3. Organi publik që zhvillon procedurën administrative, me kërkesë apo kryesisht, përfshin si palë në procedurë çdo person tjetër, të përcaktuar ose lehtësisht të përcaktueshëm, të ndryshëm nga ato të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, të cilin, rezultati i procedurës administrative mund ta cenojë në të drejtat apo interesat e tij të ligjshëm.

Neni 34

Zotësia për të vepruar në procedurën administrative

1. Një organ publik, palë në një procedurë administrative, vepron nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të përcaktuar sipas ligjit ose titullarit të institucionit, kur nuk ka përfaqësues ligjor të caktuar.

2. Zotësia për të vepruar, në një procedurë administrative, e personave të tjerë rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 35

Përfaqësimi i palës

1. Pala mund t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, në përputhje me parashikimet e këtij Kodi.

2. Në rastin kur pala vepron e përfaqësuar, organi publik kryen veprimet procedurale me përfaqësuesin.

3. Organi publik mund të kërkojë kryerjen e një ose disa veprimeve procedurale drejtpërdrejt nga pala, në rastet kur parashikohet shprehimisht nga ligji. Në këtë rast, organi publik njofton edhe përfaqësuesin.

Neni 36

Përfaqësuesi i caktuar kryesisht

1. Organi publik, që kryen procedurën, e pezullon procedurën dhe i kërkon autoritetit kompetent sipas ligjit, caktimin e përfaqësuesit ligjor ose përkatësisht zëvendësimin e tij, kur konstaton se palës që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar ose ka zotësi të kufizuar për të vepruar nuk i është caktuar ende përfaqësuesi ligjor ose ai ka konflikt interesash me të përfaqësuarin.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nëse është urgjente dhe nëse e kërkon interesi i palës, organi publik cakton një përfaqësues të përkohshëm për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural, ose deri në caktimin apo zëvendësimin e përfaqësuesit ligjor.

3. Organi publik, që kryen procedurën administrative, mund të caktojë një përfaqësues sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, edhe kur:

a) identiteti i palës është i panjohur;

b) megjithëse identiteti i palës njihet, është i pamundur njoftimi i saj;

c) pala është në pamundësi objektive për të ndjekur interesat e vet dhe nuk ka zgjedhur një përfaqësues;

ç) pala nuk ka vendqëndrim në Shqipëri dhe nuk ka zgjedhur një përfaqësues brenda afatit të dhënë nga organi publik.

4. Organi publik njofton menjëherë palën për caktimin e përfaqësuesit. Në rastet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 3, të këtij neni, organi publik njofton caktimin e përfaqësuesit



nëpërmjet njoftimit publik, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

5. Përfaqësuesi i caktuar kryesisht, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, merr pjesë dhe e përfaqëson palën në gjithë procedurën administrative, ose vetëm në veprimin procedural për të cilin është caktuar, deri në paraqitjen e palës apo të përfaqësuesit të zgjedhur prej saj.

Neni 37

Përfaqësuesi i përbashkët

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dy ose më shumë palë mund të marrin pjesë së bashku në të njëjtën procedurë administrative. Në këtë rast, palët mund të zgjedhin njërin prej tyre si përfaqësues të përbashkët, apo mund të zgjedhin një përfaqësues tjetër të përbashkët, sipas parashikimeve të nenit 38 të këtij Kodi.

2. Edhe kur zgjedhin njërin prej tyre si përfaqësues të përbashkët, secila nga palët mund të marrë pjesë në procedurën administrative personalisht, mund të paraqesë deklarata dhe të ushtrojë mjetet e ankimit në mënyrë të pavarur.

Neni 38

Përfaqësuesi i zgjedhur

1. Pala mund të zgjedhë një përfaqësues, me qëllim kryerjen e disa ose të gjitha veprimeve procedurale në procedurën administrative, përveç rastit kur kërkohet që vetë pala personalisht, të japë një deklaratë ose të kryejë një veprim tjetër procedural.

2. Zgjedhja e përfaqësuesit, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në formë të shkruar, deklarohet verbalisht përpara organit publik dhe regjistrohet nga ky fundit ose në çdo formë tjetër të përshtatshme.

3. Zgjedhja e përfaqësuesit është e vlefshme nëse bëhet në formën e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Kjo formë zbatohet edhe në rastin e zgjedhjes së një përfaqësuesi të përbashkët ndërmjet palëve, sipas parashikimit të nenit 37 të këtij Kodi.

4. Pala, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kryejë personalisht veprime procedurale apo të japë deklarata, edhe nëse ka zgjedhur një përfaqësues. Pala e pranishme, kur përfaqësuesi jep një deklaratë verbale, menjëherë mund ta ndryshojë ose revokojë këtë deklaratë.

Neni 39

Ndihmësi

1. Pala mund të paraqitet në organin publik në një seancë dëgjimore, e shoqëruar nga një ndihmës, i cili e ndihmon atë në çështje specifike, të nevojshme për procedurën administrative.

2. Çdo deklaratë e ndihmësit konsiderohet si e dhënë nga pala kur kërkohet shprehimisht prej tij/saj. Në çdo rast, pala mund të kundërshtojë aty për aty deklaratën e ndihmësit.

Neni 40

Zotësia për të qenë përfaqësues apo ndihmës

Çdo person që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, në bazë të Kodit Civil, mund të veprojë si përfaqësues apo ndihmës, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

KREU II

PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME MBI PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

Neni 41

Fillimi i procedurës administrative

1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë.

2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur:

a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës;

b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik.

3. Procedura administrative konsiderohet e filluar:

a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose

b) me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë.

Neni 42

Komunikimi me palët

1. Në rastet kur procedura administrative fillohet nga organi i publik, ky i fundit njofton të gjitha palët në proces për fillimin e veprimeve.



2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim apo në një takim me palën dhe përmban këto të dhëna:

a) adresën postare dhe/ose elektronike të organit publik, që zhvillon procedurën dhe nëpunësin përgjegjës për të;

b) informacion lidhur me kompetencën e organit publik, qëllimin e procedurës dhe çështjet për të cilat do të merren vendime;

c) palët në procedurën administrative;

ç) informacion për të drejtën e njohjes së dosjes dhe zyrën ose vendin ku mund të njihet dosja;

d) informacion për të drejtën e palës për të dëgjuar, mënyrat dhe afatin e ushtrimit të kësaj të drejte;

dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi përfundimtar, në rast se zbatohet një afat i tillë.

3. Kur njoftimi bëhet me takim, organi publik mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer.

4. Organi publik nuk është i detyruar të komunikojë me palën në rastet kur çështja është “Sekret shtetëror”, sipas klasifikimeve të bëra me ligj ose kur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme komunikimi mund të cenojë efektivitetin e procedurës administrative.

Neni 43

Njësia dhe nëpunësi përgjegjës

1. Në një procedurë administrative, të filluar sipas parashikimeve të nenit 41, të këtij Kodi, organi publik vepron nëpërmjet nëpunësit përgjegjës, të përcaktuar sipas rregullave të këtij neni.

2. Titullari i organit publik, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj ose akt nënligjor, cakton paraprakisht një njësi përgjegjëse për çdo tip procedure administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij. Ky vendim bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm.

3. Drejtuesi i njësies përgjegjëse merr përsipër vetë ose cakton me akt të shkruar nëpunësin përgjegjës për zhvillimin e procedurës administrative. Nëpunësi përgjegjës zhvillon procedurën administrative dhe në përfundim propozon me shkrim vendimin përfundimtar,

ndërsa vendimi merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore. Nëse vendimi është i ndryshëm nga ai i propozuar, duhet të shoqërohet me arsyetimin përkatës.

4. Në rastet e parashikuara nga ligji nëpunësi përgjegjës, pasi zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen me vendim përfundimtar dhe e nënshkruan atë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.

5. Organi kolegjial mund të ngarkojë njërin nga anëtarët e tij të zhvillojë veprime procedurale administrative. Në këtë rast, anëtari i ngarkuar vë në dijeni mbi rezultatet e procedurës administrative organin kolegjial, i cili vendos për çështjen.

Neni 44

Fillimi i procedurës administrative me kërkesë

1. Kur procedura administrative fillon me kërkesë të palës, organi publik duhet të marrë masat e nevojshme për përgatitjen sa më mirë të çështjes.

2. Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji dhe në përfundim:

a) njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës;

b) njofton palën kërkuese me shkrim për plotësimin e të metave lidhur me plotësimin e kriterëve formale ligjore, duke caktuar një afat të arsyeshëm. Në këtë rast organi publik ndihmon në mënyrë aktive palën për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi pala mund të ankohet sipas procedurës të parashikuar në këtë Kod;

c) njofton palën kërkuese se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative para se të vendosë pranimin ose jo të kërkesës. Në këtë rast organi cakton edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme.



KREU III

TË DREJTAT E PALËVE GJATË
PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Neni 45

E drejta e palëve për njohje me dosjen

1. Të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre.

2. Organi publik, i përfshirë në procedurën administrative, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, siguron në mjediset e tij të punës kushte për mbajtjen e të dhënave, si dhe kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve, sipas pikës 1 të këtij neni. Në raste të veçanta, kur është më e përshtatshme për kërkuesin, njohja me dosjen mund të bëhet edhe në mjediset e një organi tjetër publik ose në përfaqësitë konsullore dhe diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

3. Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale, tregtare ose profesionale, mund të merren ose të përdoren nga të tretët vetëm me pëlqimin e individit, të cilit i përket kjo të dhëna. Pëlqimi nuk kërkohet nëse dokumentet do të përdoren për qëllime të parashikuara në ligj ose akte nënligjore.

4. Kur dokumentacioni administrohet në formë elektronike, organi publik i siguron palës mjetet e nevojshme teknike për njohjen me të. Organi publik mund t'i bëjë dokumentet elektronike të aksesueshme nga interneti, nëse kjo nuk cenon sigurinë e të dhënave të mbrojtura sipas ligjit.

5. Lëshimi i kopjeve të dokumenteve bëhet kundrejt një pagese, që përcaktohet në vendimin e organit publik dhe në çdo rast nuk kalon koston e riprodhimit të tyre.

Neni 46

Kufizimi i së drejtës së palëve për njohje me dosjen

E drejta e palëve, sipas nenit 45, të këtij Kodi, kufizohet vetëm në ato raste dhe në atë masë që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 47

E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime

Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethanat apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes.

Neni 48

Detyrimi i vlerësimit

Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi.

KREU IV

NJËSIMI I DOKUMENTEVE DHE
VËRTETIMI I NËNSHKRIMIT

Neni 49

Njësimi i akteve të veta

1. Çdo organ publik, me kërkesë, mund të lëshojë kopje ose pjesë të njësuara me origjinalin të akteve të nxjerra nga ai vetë ose të dokumenteve të tjera nën administrimin e tij.

2. Njësimi me origjinalin nuk bëhet nëse, sipas rrethanave, rezulton se origjinali përmban ndryshime, mospërputhje, fshirje, fjalë, figura ose shenja të palexueshme, gjurmë të fshirjes së tyre, ose kur vazhdimësia e dokumentit të përbërë nga disa fletë është ndërprerë.

3. Përjashtimisht, në rastet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, kur origjinali është ekzemplari i vetëm ekzistues i dokumentit, njësimi mund të bëhet duke bërë shënimin për mangësitë e konstatuara.

4. Njësimi me origjinalin bëhet nëpërmjet vendosjes së shënimit të njësimit në fund të kopjes. Ky shënim duhet të përmbajë:

- a) një përshkrim të saktë të dokumentit që njësohet;
- b) deklarinë që kopja është e njëjtë me origjinalin ose që është një ekstrakt i tij;
- c) vendin dhe datën e njësimit;
- d) organin publik që bën njësimin dhe vulën e tij zyrtare;



d) emrin dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës për njësimin.

5. Afati për lëshimin e kopjes së njësuar është 10 ditë nga dita kur depozitohet kërkesa.

6. Në rast të mospërbushjes së kërkesës apo refuzimit nga ana e organit publik, kërkesit i lind e drejta për t'u ankuar për moslëshimin e kopjes së njësuar, sipas këtij Kodi.

7. Parashikimet e këtij neni zbatohen për aq sa është e mundur për njësimin me origjinalin të dokumenteve të tjera, të ruajtura në formën e fotografimit, filmimit apo të ruajtura në çdo mjet tjetër teknik.

Neni 50

Njësimi në lidhje me dokumentet elektronike

Njësimi i kopjeve në letër të një dokumenti elektronik lidhur me një nënshkrim elektronik, të kopjeve të një dokumenti elektronik, prodhuar për të riprodhuar një dokument me shkrim, si dhe certifikimin e kopjeve të një dokumenti elektronik në një tjetër format teknik, të ndryshëm nga dokumenti origjinal i lidhur me nënshkrimin elektronik, dhe çdo vërtetim tjetër në lidhje me dokumentet në formë elektronike, rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 51

Njësimi i dokumenteve të lëshuara nga organe të tjera publike

1. Një organ publik mund të njësojë kopje ose pjesë të dokumenteve të lëshuara nga një organ tjetër publik, nëse kopja ose pjesa e dokumentit janë të nevojshme për zhvillimin e procedurës përpara vetë organit që bën njësimin dhe nëse pala e interesuar paraqet origjinalin e dokumentit të lëshuar nga organi tjetër.

2. Rregullat për njësimin, të parashikuara në nenin 49, të këtij Kodi, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Shënimi i njësimiit përmban të dhëna identifikuese të personit që ka paraqitur dokumentin origjinal.

3. Organi publik regjistron çdo njësim të kryer dhe mban një kopje të njësuar të aktit.

Neni 52

Vërtetimi i nënshkrimeve

1. Çdo organ publik i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vërteton nënshkrimet kur dokumenti i nënshkruar kërkohej t'i paraqitet një autoriteti ose organi tjetër publik, të cilit duhet t'i paraqitet dokumenti i nënshkruar.

2. Vërtetimi i nënshkrimit bëhet vetëm kur nënshkrimi është bërë ose pranuar në prani të nëpunësit të organit publik të ngarkuar për këtë qëllim.

3. Shënimi i vërtetimit vendoset afër nënshkrimit që vërtetohet dhe duhet të përmbajë:

a) një deklaratë se nënshkrimi është i vërtetë;

b) identitetin e saktë të personit, nënshkrimi i të cilit vërtetohet, si dhe shënimin nëse nëpunësi përgjegjës për vërtetimin është bindur për identitetin e personit dhe nëse nënshkrimi është bërë ose pranuar në prani të tij;

c) deklaratën se vërtetimi bëhet vetëm për paraqitjen pranë një autoriteti ose një organi tjetër publik dhe emrin e këtij autoriteti apo organi;

ç) vendin dhe datën e vërtetimit, si dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës për vërtetimin dhe vulën zyrtare.

4. Pikat 1 deri në 3 të këtij neni zbatohen për aq sa është e mundur edhe për vërtetimin e shenjave të tjera të identifikimit personal.

KREU V
AFATET

Seksioni 1

Afatet e veprimeve procedurale për palët, shtyrja dhe rivendosja në afat

Neni 53

Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale

1. Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim "afatet procedurale", përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në



përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

Neni 54

Rivendosja në afat

1. Përveçse kur ndalohet shprehimisht me ligj, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv.

2. Rivendosja në afat mund të kërkohej:

a) për afatet e përcaktuara për paraqitjen e kërkesës fillestare;

b) në lidhje me afatet për kryerjen e veprimeve gjatë procedurës administrative;

c) për afatet për paraqitjen e mjeteve të ankimit; si dhe

ç) për çdo afat tjetër në dëm të palës.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet kryer edhe veprimi procedural, për të cilin pala ka humbur afatin për shkaqe të arsyeshme.

4. Afati 1-vjeçar, i përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e forcës madhore.

Neni 55

Vendimi dhe pasojat e rivendosjes në afat

1. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet dhe shqyrtohet nga organi publik kompetent që zhvillon procedurën administrative ose organi kompetent që vendos mbi mjetet ligjore administrative, ose organi që vazhdon ekzekutimin në përputhje me çështjen. Organi para të cilit është paraqitur kërkesa për rivendosjen në afat merr vendim brenda 15 ditëve.

2. Depozitimi i kërkesës shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit.

3. Kundër vendimit të organit publik për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat, mund të bëhet ankim sipas rregullave të parashikuara nga ky Kod dhe legjislacioni në fuqi.

4. Pranimi i kërkesës për rivendosjen në afat shkakton anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, të kryera si pasojë e humbjes së afatit.

Seksioni 2

Llogaritja e afateve

Neni 56

Llogaritja e afateve

1. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.

2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

Neni 57

Prezumime për llogaritjen e afateve

1. Dita e paraqitjes së kërkesës, për efekt të llogaritjes së afateve procedurale që ecin në dëm të palës, konsiderohet ajo e:

a) depozitimit të kërkesës në postë, kur kërkesa dërgohet me postë të porositur;

b) depozitimit të kërkesës në kutinë postare të organit publik;

c) paraqitjes së kërkesës në degët e institucionit, në prefekturë apo përfaqësitë diplomatike ose zyra konsullore;

ç) paraqitjes në komandën ose institucionin e ndalimit të personave;



d) regjistrimit nga pajisja përkatëse për marrjen e mesazheve, nëse dokumenti elektronik dërgohet elektronikisht ose kërkesa në formë të shkruar dërgohet me faks. Ky komunikim nuk passjell humbjen e afateve. Nëse dokumenti i dërguar nuk është i lexueshëm, organi publik njofton pa vonesë dërguesin duke i kërkuar ta ridërgojë në një mënyrë tjetër të përshtatshme.

2. Dita e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, konsiderohet edhe si dita kur ka ndodhur ngjarja, për efekt të llogaritjes së afateve që ecin kundër organit publik.

KREU VI KËRKESA DHE PARAQITJA E SAJ

Neni 58 Forma dhe përmbajtja e kërkesës

1. Përveçse kur ligji parashikon një formë të caktuar, çdo kërkesë, me të cilën personat i drejtohen organit në një procedurë administrative, mund të jetë:

- a) në formë të shkruar;
- b) të deklarohet verbalisht para organit publik dhe të regjistrohet nga ky i fundit; ose
- c) të bëhet në çdo formë tjetër të përshtatshme.

2. Kërkesa duhet të jetë mjaftueshëm e qartë për të përcaktuar kërkuuesin dhe qëllimin e saj, përveçse kur ligji parashikon një përmbajtje të caktuar.

3. Kërkesa konsiderohet në formë të shkruar edhe kur ajo dërgohet me faks ose në rrugë elektronike, me kusht që të tregojë qartë autorin e saj. Ligji mund të kërkojë që kërkesa të nënshkruhet me dorë.

Neni 59 Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa paraqitet drejtpërdrejt në organin publik kompetent ose në çdo zyrë apo degë të tij. Kërkesa drejtuar një organi publik qendror mund të paraqitet edhe në çdo prefekturë, në territorin e së cilës pala ka vendqëndrimin, nëse organi publik qendror nuk ka zyrë ose degë në atë territor.

2. Kërkesa mund të paraqitet edhe në përfaqësitë diplomatike, zyrat konsullore të Republikës së Shqipërisë, në shtetin ku pala ka vendqëndrimin apo vendbanimin e saj.

3. Zyrat, degët, prefektura, përfaqësitë diplomatike apo zyrat konsullore ia dërgojnë pa vonesë kërkesën dhe, në çdo rast, brenda 48 orëve nga paraqitja e saj, organit publik kompetent dhe njoftojnë kërkuuesin.

4. Personat që shërbejnë në Forcat e Armatosura mund ta paraqesin kërkesën e tyre në komandën përkatëse ku kryejnë shërbimin, ndërsa personat e ndaluar apo që ekzekutojnë dënimin penal me burgim mund ta paraqesin atë pranë institucionit ku gjenden të ndaluar ose ku ekzekutojnë dënimin penal me burgim.

5. Në përputhje me pikat 1 deri në 4, të këtij neni, kërkesa mund t'i paraqitet drejtpërdrejt organit publik brenda orarit zyrtar. Për paraqitjen e kërkesave verbale, organi publik mund të caktojë një orar të posaçëm brenda orarit zyrtar. Orari i posaçëm nuk është i zbatueshëm kur paraqitja e kërkesës lidhet me ndonjë afat që ecën në dëm të kërkuarit.

6. Kërkesa me shkrim mund të dërgohet edhe me postë të porositur, mjete elektronike ose faks, drejtpërdrejt në adresën përkatëse zyrtare të organit kompetent, të cilit i drejtohet ose në kutinë postare të organit publik. Kërkesat urgjente mund të bëhen edhe me telefon, nëse është e mundur, sipas natyrës së kërkesës.

7. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim organet publike dhe procedurat administrative, në të cilat paraqiten kërkesat me mjete elektronike dhe kërkesat teknike përkatëse. Kërkesat teknike duhet të jenë jodiskriminuese dhe t'i referohen produkteve dhe teknologjive përgjithësisht të disponueshme dhe ndërvepruese me produktet e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në përdorim të përgjithshëm. Çdo organ publik publikon kërkesat teknike në faqen e tij zyrtare të internetit.

Neni 60 Regjistrimi dhe vërtetimi i paraqitjes së kërkesës

1. Marrja e kërkesës regjistrohet në organin publik ku paraqitet, sipas rendit kronologjik të paraqitjes në një regjistër të posaçëm. Regjistri i kërkesave për fillimin e procedurës administrative përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin e kërkesës;

- b) datën e dorëzimit;
- c) objektin e kërkesës;
- ç) numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës; dhe
- d) identitetin dhe adresën e kërkuarit.

2. Nëse dy ose më shumë kërkesa mbërrinë me të njëjtën dërgesë postare pranë organit publik, ato konsiderohen të depozituara pranë këtij organi, në të njëjtën kohë.

3. Personit që paraqet kërkesën, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim që konfirmon faktin e pranimit të kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, nëse ka të tilla. Depozitimi me postë të porositur vërtetohet nga dokumenti postar që duhet të përmbajë të njëjtat të dhëna.

4. Me kërkesë të personit, në rastin e dërgimit të kërkesës me mjete elektronike ose faks, vërtetimi sipas pikës 3, të këtij neni, i dërgohet pa vonesë në të njëjtën adresë dhe me të njëjtat mjete, me të cilat është kryer dërgimi.

Neni 61

Depozitime të tjera

Rregullat e përcaktuara në këtë Kod për paraqitjen e kërkesës zbatohen edhe për paraqitjen e mendimeve, shpjegimeve, komenteve, deklaratave, si dhe dokumenteve të tjera, në kuadër të procedurës administrative.

Neni 62

Pasaktësitë në kërkesën e palës së interesuar për fillimin e procedurës administrative

1. Në qoftë se kërkesa e palës së interesuar për fillimin e procedurës administrative nuk është paraqitur në përputhje me kërkesat e neneve 58 dhe 59, të këtij Kodi, kërkuarit i kërkohet me shkrim që të korrigjojë pasaktësitë ekzistuese.

2. Me përjashtim të rasteve kur në ligjet e veçanta parashikohet ndryshe, organi publik i drejtohet kërkuarit për korrigjimin e pasaktësive brenda 7 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës dhe i cakton kërkuarit një afat për plotësimin e pasaktësive.

3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, dhe për aq sa është e mundur, organi publik i korrigjon vetë pasaktësitë e kërkesës, duke mos i dëmtuar interesat ligjorë të palëve të interesuara.

4. Kur kërkuari plotëson pasaktësitë brenda afatit të përcaktuar, ajo quhet e regjistruar nga dita që është regjistruar në organin publik.

5. Kur kërkuari nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar dhe këto pasaktësi nuk mund të plotësohen nga organi publik, sipas pikës 3, të këtij neni, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuarit bashkë me aktet e tjera.

Neni 63

Kërkesa verbale për fillimin e procedurës administrative

Nëse paraqitet një kërkesë verbale, nëpunësi regjistron të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin e kërkesës;
- b) datën e deklarimit;
- c) objektin e kërkesës verbale;
- ç) numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës, nëse ka të tilla; dhe
- d) identitetin dhe adresën e kërkuarit.

Neni 64

E drejta e plotësimit, ndryshimit dhe e tërheqjes së kërkesës

1. Një palë që ka dorëzuar një kërkesë mund ta plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

2. Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka.

3. Vendimi i organit publik për t'i dhënë fund procedurës administrative, pas tërheqjes së njëres prej palëve, mund të ankimohet nga çdo palë tjetër.

4. Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera.



Neni 65

Verifikimi paraprak përpara fillimit të procedurës administrative

Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

- a) nëse të drejtat apo interesat e kërkuara nga palët janë subjekt i ndonjë kufizimi kohor;
- b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative;
- c) nëse afati i përcaktuar me ligj për dorëzimin e kërkesës është respektuar;
- ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

KREU VII

DHE VENDIMET E NDËRMJETME

Neni 66

Çështjet paraprake

1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

2. Nëse shqyrtimi i çështjes paraprake mund të fillojë vetëm me kërkesë të palës, organi kompetent për zhvillimin e procedurës pezullon procedurën, duke njoftuar njëkohësisht palën për të drejtën që ajo ka për të paraqitur kërkesën për çështjen konkrete.

3. Nëse zgjidhja e çështjes paraprake kërkon iniciativën kryesisht të organit tjetër publik, organi kompetent për zhvillimin e procedurës kërkon fillimin e procedurës nga organi tjetër.

Neni 67

Vendimet e ndërmjetme

1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se

mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktojnë një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara.

3. Vendimi për marrjen e masave të ndërmjetme duhet të jetë i arsyetuar, me afat të përcaktuar dhe u njoftohet palëve.

Neni 68

Përfundimi i vendimeve të ndërmjetme

1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme:

- a) përfundon procedura administrative ose mbaron afati, brenda të cilit duhet të ishte dhënë vendimi përfundimtar;
- b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm;
- c) në rastet e tjera të parashikuara shprehimisht me ligj.

2. Organi publik shfuqizon vendimet e ndërmjetme, nëse gjatë procedurës bie shkak u parashikuar në pikën 1, të nenit 67, të këtij Kodi.

Neni 69

Pajtimi i palëve

1. Gjatë gjithë zhvillimit të një procedure administrative me palë kundërshtare, nëpunësi përgjegjës i organit publik duhet të përpiqet t'i pajtojë palët në procedurë, kur e lejon natyra e çështjes.

2. Akti i pajtimit mes dy ose më shumë palëve në një procedurë administrative bëhet në formë të shkruar dhe pasi të lexohet dhe të nënshkruhet nga palët bëhet i plotfuqishëm. Një kopje e këtij akti u jepet palëve në procedurë.

3. Akti i pajtimit mes dy ose më shumë palëve në një procedurë administrative ka efekt të njëjtë me atë të aktit administrativ.

4. Organi kompetent publik nuk pranon pajtim mes palëve në procedurë në qoftë se pajtimi është në dëm të interesit publik ose në dëm të interesave të ligjshëm të personave të tjerë fizikë dhe juridikë.



KREU VIII
VENDIMARRJA E PËRBASHKËT DHE
NDIHMA NDËRMJET ORGANEVE
PUBLIKE

Neni 70

**Vendimmarrja e përbashkët e organeve
publike**

1. Kur sipas ligjit, dy ose më shumë organe publike vendosin për një çështje administrative, në kuadër të një procedure administrative të vetme, ato përcaktojnë me marrëveshje organin që do të nxjerrë aktin administrativ të përbashkët, i cili përfshin edhe vendimin e organit tjetër.

2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, secili prej organeve të përfshira merr vendimin, në përputhje me kompetencën përkatëse.

3. Nëse, sipas ligjit, vendimmarrja e një organi publik bazohet në një pëlqim paraprak, konfirmim, miratim ose mendim të një organi tjetër publik, ky i fundit vendos dhe njofton organin publik brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, përveç rasteve kur ligji parashikon një afat të ndryshëm.

4. Nëse organi publik, të cilit i lind detyrimi për të dhënë pëlqimin, konfirmimin, miratimin apo mendimin e nevojshëm për miratimin e aktit, nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar në pikën 3, të këtij neni, prezumohet se qëndrimi i tij është pozitiv.

5. Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, mosmarrëveshjet lidhur me pikën 1, të këtij neni, zgjidhen sipas nenit 27 të këtij Kodi.

Neni 71

Ndihma administrative

1. Organi publik, mund t'i kërkojë ndihmë administrative një organi tjetër publik, për kryerjen e një apo disa veprimeve të nevojshme, në kuadër të një procedure administrative.

2. Ndihma administrative kërkohet në rastet kur:

a) për arsye të ligjshme, organi kërkues nuk mund t'i kryejë vetë këto veprime;

b) kryerja e veprimeve nga organi kërkues nuk është efektive apo kostot për kryerjen e tyre janë shumë më të larta, në krahasim me koston e kryerjes së tyre nga organi tjetër;

c) është e nevojshme njohja me dokumente, fakte, apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër.

3. Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, organi publik mund ta zgjedhë organin të cilit i kërkon ndihmë, duke vlerësuar koston dhe efektivitetin.

Neni 72

**Refuzimi i kërkesës për ndihmë
administrative**

1. Organi, të cilit i kërkohet ndihma administrative, nuk mund ta refuzojë atë, me përjashtim të rasteve të pamundësisë objektive për kryerjen e veprimeve të kërkuara. Në këtë rast, organi kërkues njoftohet menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se 2 ditë nga marrja e kërkesës për ndihmë administrative.

2. Mosmarrëveshja ndërmjet dy organeve zgjidhet nga organi epror i organit të cilit i kërkohet ndihmë. Në rastet kur ky organ nuk ekziston, veprimi kryhet nga organi që kërkon ndihmën administrative.

Neni 73

Procedura e ndihmës administrative

1. Organi, të cilit i kërkohet ndihmë administrative, i nënshtrohet procedurave dhe detyrimeve ligjore të parashikuara në ligj për organin, që ka kërkuar ndihmën administrative, dhe kryen veprimet e kërkuara sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Organi kërkues, në kërkesën për ndihmë, informon organin tjetër për procedurat dhe detyrimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

KREU IX

PIKAT E SHËRBIMIT ME NJË NDALESË

Neni 74

Pikat e shërbimit me një ndalesë

Për të gjitha shërbimet, për të cilat është përcaktuar sipas ligjeve të posaçme një pikë e shërbimit me një ndalesë, zbatohen dispozitat e këtij Kodi. Në këto raste, të gjitha procedurat administrative kryhen nëpërmjet pikave të shërbimit me një ndalesë.



Neni 75

Përgjegjësitë e pikave të shërbimit me një ndalesë

1. Pikat e shërbimit me një ndalesë janë përgjegjëse për:

a) këshillimin e të interesuarve në të njëjtën mënyrë si organi publik kompetent;

b) pranimin e kërkesave për nxjerrjen e një akti administrativ apo kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, si dhe paraqitjen e mendimeve, shpjegimeve, propozimeve, komenteve, dokumenteve apo mjeteve ligjore administrative, në përputhje me këtë Kod, dhe transferimin e tyre organit publik kompetent;

c) njoftimin e kërkuarit për çdo akt dhe veprim procedural të organit publik kompetent, si dhe për çdo komunikim ndërmjet palës së interesuar dhe organit publik kompetent, në lidhje me aktivitetin specifik.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, ekzistenca e pikave të shërbimit me një ndalesë nuk cenon kompetencën e secilit prej organeve publike, të përfshira në procedurën administrative, si dhe të drejtën e të interesuarve t'i drejtohen drejtpërdrejt organit publik kompetent.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, pika e shërbimit me një ndalesë është organi publik kompetent për aktin më të rëndësishëm administrativ, të lidhur me fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga organet publike të përfshira. Mosmarrëveshjet ndërmjet organeve publike të përfshira në veprimtaritë, të cilat kryhen nëpërmjet pikave të shërbimit me një ndalesë, zgjidhen në përputhje me nenin 27 të këtij Kodi.

Neni 76

Informimi dhe procedura

1. Pikat e shërbimit me një ndalesë informojnë apo vënë në dispozicion të të interesuarve, të gjithë informacionin e nevojshëm për procedurën administrative. Informacioni përfshin edhe të dhëna për mjetet dhe kushtet për aksesin në regjistrat publikë dhe në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe për mjetet e ankimit, në rast mosmarrëveshjeje. Shërbimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të këtij Kodi, dhe në këtë pikë kryhen drejtpërdrejt në pikën e shërbimit me një

ndalesë, si dhe nëpërmjet postës apo mjeteve elektronike.

2. Afatet për organin publik fillojnë të llogariten me depozitimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të plotë në pikën e shërbimit me një ndalesë, apo sipas rregullave të përcaktuara në nenin 57, të këtij Kodi, pavarësisht nga koha e nevojshme për transferimin tek organi publik kompetent.

3. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim:

a) veprimtaritë ekonomike, si dhe procedurat administrative, lidhur me fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë, të cilat kryhen nëpërmjet pikave të shërbimit me një ndalesë;

b) organet publike që shërbejnë si pika shërbimi me një ndalesë apo krijon organe publike të posaçme për këtë qëllim;

c) procedurat e brendshme të komunikimit ndërmjet pikës së shërbimit me një ndalesë dhe organit publik kompetent;

ç) procedurat dhe standardet për sportelet pritëse të qytetarëve dhe zyra mbështetëse përgjegjëse për përpunimin e të dhënave dhe finalizimin e shërbimeve publike në qendrat e shërbimit me një ndalesë.

KREU X**HETIMI ADMINISTRATIV****Seksioni 1****Parimet e hetimit administrativ**

Neni 77

Parimi i hetimit kryesisht

1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm elementet e nevojshme për identifikimin e tyre.



Neni 78

Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ

1. Pala bashkëpunon me organin publik në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Ligji mund të parashikojë shprehimisht detyrimin e mëtejshëm të palës për të paraqitur informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara organit publik.

2. Palëve nuk mund t'u kërkohej të paraqiten personalisht pranë organit publik, nëse komunikimi me to mund të sigurohet me mjete të tjera më të përshtatshme.

3. Palët mund t'i paraqesin deklaratat e tyre në formë të shkruar apo verbale. Për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, palëve mund t'u kërkohej t'i paraqesin deklaratat e tyre me shkrim.

Neni 79

Subjektet e procedurës hetimore

1. Procedura hetimore zhvillohet nga organi publik, në kompetencën e të cilit është marrja e vendimit përfundimtar.

2. Organi publik kompetent për marrjen e vendimit mund t'ia delegojë të drejtën për zhvillimin e procedurës hetimore organit vartës, me përjashtim të rasteve kur delegimi ndalohet me ligj.

3. Organi publik, që ka kompetencë për zhvillimin e procedurës hetimore, mund t'i ngarkojë organit vartës detyra specifike hetimore.

Seksioni 2

Mjetet e kërkimit të provës

Neni 80

Kuptimi dhe mjetet e kërkimit të provës

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:

a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;

b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;

c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.

2. Dispozitat e parashikuara ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave

administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për atë që është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

Neni 81

Vlerësimi i provave

Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

Neni 82

Barra e provës

1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.

4. Palët mund t'i kërkojnë organit publik që të marrë masat e nevojshme për të siguruar përdorimin e provave të zotëruara prej tij gjatë procedurës administrative.

Neni 83

Paraqitja e provave para një organi tjetër

1. Nëse paraqitja e provave para organit publik që zhvillon procedurën është e vështirë, kërkon kohë ose ka kosto të lartë, organi publik mund të vendosë, kryesisht apo me kërkesë të palës, që



marrja tërësisht e provave ose e një pjese të tyre të bëhet nga një organ tjetër publik.

2. Në këtë rast zbatohen, për aq sa është e mundur, parashikimet e neneve 71 dhe 73, të këtij Kodi, për ndihmën administrative.

Neni 84

Metodat për paraqitjen e informacionit dhe provave

Në rastet kur palët janë të detyruara të paraqesin informacion ose prova, pala duhet të njoftohet me shkrim apo në mënyrë verbale, sipas afateve dhe parashikimeve të këtij Kodi.

Neni 85

Mosparaqitja e provave

1. Në qoftë se palët nuk i përgjigjen njoftimit, administrata mund të bëjë një njoftim të ri ose të ndërpresë procedurën, kur një gjë e tillë nuk cenon ndonjë interes publik.

2. Mungesa e përgjigjes ndaj njoftimit mund të merret në konsideratë për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes, por në asnjë rast kjo nuk e çliron organin publik nga detyrimi për t'i kërkuar vetë provat dhe faktet dhe për të dhënë një vendim përfundimtar.

3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë.

Neni 86

Sigurimi i provave

1. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, organi publik, kryesisht apo me kërkesën e justifikuar të palës, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).

2. Organi publik që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi organin publik që zhvillon procedurën.

Faqe | 4648

3. Shpenzimet që krijohen gjatë veprimeve të ndërmarra nga administrata për sigurimin e provave, përveç atyre provave që zotërohen prej saj, mbulohen nga pala e interesuar që i kërkon ato.

Seksioni 3

Njoftimi dhe dëgjimi i palëve

Neni 87

Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar

1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna:

a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës;

b) palët e përfshira;

c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet;

c) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës;

d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte;

dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm.

3. Afati i parashikuar sipas shkronjës “dh”, të pikës 2, të këtij neni, nëse nuk parashikohet nga ligji ose aktet nënligjore, përcaktohet nga organi publik, në përputhje me nenin 53 të këtij Kodi.

Neni 88

Ushtrimi i së drejtës për t'u dëgjuar

1. E drejta e palës për t'u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik.

2. Palët, në ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar, mund të paraqesin komente edhe për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës.



3. Organi publik merr vendimin përfundimtar vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga pala. Mosushtrimi i kësaj së drejte nga ana e palës në afatin e përcaktuar, nuk shkakton shtyrjen e marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 89

Përfundimi nga e drejta për t'u dëgjuar

Procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar, vetëm në rastet e mëposhtme:

a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet për shkak të vonësës interesit publik;

b) palët kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative;

c) gjatë zhvillimit të procedurës administrative rezulton qartë se vendimi do të jetë tërësisht në favor të palës;

ç) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike; ose kur

d) është parashikuar shprehimisht me ligj.

KREU XI

PËRFUNDIMI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Neni 90

Përfundimi i procedurës administrative

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.

2. Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji.

3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.

Neni 91

Afati për përfundimin e procedurës administrative

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.

2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.

3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre.

4. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, procedura administrative përfundon brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.

5. Mosrespektimi i afateve kohore, të parashikuara në këtë nen, duhet të justifikohet nga organi përgjegjës para organit epror ose nga nëpunësi përgjegjës përpara eprorit të tij, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit ose nga përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme.

Neni 92

Zgjatja e afatit të procedurës

1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit.

Neni 93

Vdekja e palës, mbarimi i personit juridik

1. Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen. Në



çdo rast tjetër, nëse organi publik vlerëson nëse pjesëmarrja e palës është e domosdoshme, pezullon procedurën përkohësisht deri në identifikimin e trashëgimtarëve.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, edhe në rastin e mbarimit të personit juridik, kur ky i fundit është palë, organi publik deklaron përfundimin e procedurës administrative pa marrë një vendim përfundimtar.

Neni 94

Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës

1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.

2. Organi publik mund të deklarojë përfundimin e procedurës së nisur me kërkesë, pa vendim përfundimtar edhe nëse rezulton qartazi nga rrethanat se pala që ka paraqitur kërkesën, nuk ka më interes për vazhdimin e procedurës dhe e ka braktisur atë.

3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e palës.

4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij Kodi.

5. Braktisja e procedurës nuk e shuan të drejtën, të cilën individit kishte kërkuar të njëj.

Neni 95

Pamundësia në objekt apo qëllim

Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

Neni 96

Mospagimi i tarifave

1. Procedura e nisur me kërkesë, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, si pasojë e mospagimit brenda afatit të përcaktuar, të tarifave, pagimi i të cilave, sipas ligjit është kusht për nxjerrjen e vendimit përfundimtar, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë Kod.

2. Nëse pala paguan dyfishin e shumës brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit fillestar për pagesën e tarifës, organi publik përfundon procedurën administrative duke marrë vendimin përfundimtar përkatës.

Neni 97

Miratimi në heshtje

1. Nëse pala ka kërkuar në procedurën administrative nxjerrjen e një akti administrativ shkresor dhe organi publik nuk njofton vendimin brenda afatit të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor për përfundimin e procedurës dhe nuk njofton zgjatjen e afatit ose nuk njofton vendimin brenda afatit të zgjatur, kërkesa konsiderohet si e miratuar dhe akti administrativ shkresor i kërkuar si i miratuar në heshtje (akti në heshtje) në rastet kur është parashikuar nga ligje të veçanta.

2. Pala ka të drejtë të kërkojë nga autoriteti publik, i cili nuk ka nxjerrë aktin administrativ të kërkuar, një konfirmim me shkrim se kërkesa e saj konsiderohet të jetë miratuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Konfirmimi përmban tekstin e kërkesës, datën e paraqitjes së saj dhe faktin që organi publik nuk ka njoftuar vendimin e tij brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Nëse autoriteti nuk nxjerr një konfirmim në përputhje me pikën 2, të këtij neni, brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës së palës sipas pikës 2, të këtij neni, ose në të njëjtën kohë nuk nxjerr aktin administrativ të kërkuar, pala mund të ngrejë padi në gjykatën kompetente për çështjet administrative, për të saktësuar të drejtat dhe detyrimet ndërmjet paditësit dhe organit publik.



PJESA E PESTË
VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

KREU I
AKTI ADMINISTRATIV

Seksioni 1
Kërkesat formale të aktit administrativ

Neni 98
Forma e aktit administrativ

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ ka formë të shkruar në letër ose elektronike, verbale, ose çdo formë tjetër të përshtatshme.

2. Akti administrativ verbal konfirmohet në formë të shkruar në letër ose elektronike, kur pala e kërkon këtë menjëherë.

3. Organi publik është i detyruar të konfirmojë pa vonesë përmbajtjen e aktit verbal, në formë të shkruar në letër ose elektronike.

4. Konfirmimi, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, megjithëse nuk është akt administrativ, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 99 të këtij Kodi.

5. Aktet e organeve kolegjiale bëhen në formë shkresore. Këto akte regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike.

Neni 99
Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.

2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

- a) pjesën hyrëse, që përmban:
 - i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;
 - ii) palët të cilave u drejtohet akti;
 - iii) datën e miratimit;
 - iv) bazën ligjore;
- b) pjesën arsyetuese;
- c) dispozitivin që tregon:
 - i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;
 - ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;
 - iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e

ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.

3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjial.

4. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3, të këtij neni, zëvendësohen me nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 100
Arsyetimi i aktit

Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:

- a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;
- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;
- ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

Neni 101
Aktet që nuk kërkohen të arsyetohen

Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, nuk kërkohet të jetë i arsyetuar në rastet kur:

- a) përjashtohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
- b) akti administrativ, i nxjerrë me kërkesën e palës, përbën pranimin e plotë të saj dhe nuk cenon të drejtat apo interesat e palëve;
- c) aktet që miratojnë vendimet e marra nga bordet, juritë apo komisionet e ngritura nga organet publike, si dhe urdhrat e eprorëve, që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit të brendshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe;



ç) akti shpall publikisht një akt administrativ kolektiv;

d) organi nxjerr një akt administrativ në vijim të praktikës së ndjekur për zgjidhjen e çështjeve objektivisht të njëjta.

Neni 102

Kushte shtesë për aktin administrativ dobiprurës

1. Një akt administrativ dobiprurës mund të shoqërohet me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme shtesë:

a) një ngjarje, e cila nuk është e sigurt se do të ndodhë dhe me ndodhjen e së cilës varet fillimi apo fundi i një të drejte, përfitimi ose barre (kushti);

b) një datë ose një periudhë kohore, në të cilën një e drejtë, një përfitim ose barrë, përkatësisht do të fillojë, përfundojë ose zgjasë;

c) një rezervë nga ana e organit publik sa i përket shfuqizimit; dhe/ose

ç) një kusht shtesë që kërkon që përfituesi të kryejë, të ndalojë një veprim të caktuar ose të lejojë një veprim të caktuar.

2. Kushti shtesë, i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, lejohet vetëm në rastet kur:

a) ai nuk kundërvepron me qëllimin e aktit administrativ; dhe

b) ai nuk është i ndaluar me ligj.

Neni 103

Akti i garancisë

1. Akti i garancisë nxirret nga organi publik kompetent vetëm me kërkesë të palëve dhe ka në çdo rast formë të shkruar.

2. Nëse para lëshimit të aktit të garancisë, organi publik kompetent vlerëson se duhet të ketë dëgjues me një ose më shumë persona ose, sipas ligjit, kërkohet pjesëmarrja e një organi tjetër publik, akti i garancisë nxirret pas dëgjësës së personit apo personave ose pjesëmarrjes së organit publik.

3. Nëse pas lëshimit të aktit të garancisë, faktet ose baza ligjore e çështjes ndryshojnë në një masë të tillë që nëse organi do të ishte në dijeni të këtij ndryshimi, nuk do ta kishte lëshuar aktin e garancisë, atëherë ky i fundit nuk është më i detyrueshëm për organin publik.

Seksioni 2

Pasojat juridike të aktit administrativ

Neni 104

Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ

1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.

2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.

3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 105

Efektet prapavepruese

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Neni 106

Botimi i akteve në Fletoren Zyrtare

1. Botimi i akteve administrative në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm, kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji.



2. Mosbotimi i aktit në Fletoren Zyrtare, kur kjo kërkohet shprehimisht nga ligji, shkakton moshyrjen në fuqi të aktit.

Seksioni 3

Ligjshmëria, pavlefshmëria dhe korrigjimi i aktit administrativ

Neni 107

Ligjshmëria e aktit administrativ

Akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 108

Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

- i) kompetencën e organit publik;
- ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose
- iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;

ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Neni 109

Paligjshmëria e aktit administrativ

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;

b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;

c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;

ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;

d) është në kundërshtim me ligjin material;

dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo

e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Neni 110

Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute

1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.

2. Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit.

3. Në rast se një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme dhe kjo pjesë është aq e rëndësishme sa që organi publik nuk do ta kishte nxjerrë aktin pa të, i gjithë akti është i absolutisht i pavlefshëm.

Neni 111

Konstatimi i detyrueshëm i aktit absolutisht të pavlefshëm

Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi.

Neni 112

Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ

1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.

2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.



Seksioni 4

Anulimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ

Neni 113

Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit

1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.

2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.

3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

Neni 114

Anulimi dhe shfuqizimi diskrecionar i një akti administrativ të paligjshëm

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108, të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë.

2. Nëse pala përfituese është në mirëbesim, një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet.

3. Pala përfituese nuk vlerësohet se është në mirëbesim nëse ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit ose nuk ka qenë në dijeni të tyre për shkak të pakujdesisë së rëndë apo nëse akti është nxjerrë, bazuar në informacionin materialisht të gabuar apo jo të plotë të dhënë, me faj, nga vetë pala.

Neni 115

Anulimi i një akti administrativ të ligjshëm

Një akt administrativ i ligjshëm mund të anulohet, nëse pala në një akt administrativ që i nënshtrohet një detyrimi sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 102, të këtij Kodi, nuk e ka plotësuar tërësisht detyrimin apo nuk e ka bërë këtë brenda afatit të caktuar kohor.

Neni 116

Shfuqizimi i një akti administrativ të ligjshëm

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtrim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike dhe kjo nuk mund të bëhet në mënyra tjera që cenojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të fituar të palës.

2. Pala përfituese, në rast të shfuqizimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ka të drejtën e kompensimit nëse ka hyrë në marrëdhënie financiare nga të cilat nuk mund tërhiqet ose mund të tërhiqet vetëm duke pësuar dëme që nuk do të ishte e arsyeshme të kërkohej nga ajo.

3. Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë interesin e arsyeshëm që ka pala në vazhdimin e sjelljes së pasojave juridike të aktit që shfuqizohet. Pala nuk përfiton kompensim për fitimin e munguar.

Neni 117

Afati për anulimin dhe shfuqizimin

1. Shfuqizimi, në rastin e parashikuar në pikën 1, të nenit 116, të këtij Kodi, mund të bëhet në çdo kohë.

2. Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.

Neni 118

Kthimi i pagesave dhe kontributeve në rastin e anulimit

1. Të gjitha pagesat apo kontributet, të cilat tashmë janë paguar nga pala dhe/ose nga organi publik, në bazë të një akti të anuluar, duhet të kthehen.

2. Masa e kthimit të pagesave dhe kontributeve, e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përcaktohet në aktin e anulimit dhe llogaritet nga organi publik, sipas dispozitave për begatimin pa shkak, në përputhje me legjislacionin civil.



KREU II

KONTRATA ADMINISTRATIVE

Neni 119

Kushtet dhe kërkesat e kontratës administrative

1. Organi publik, për realizimin e një interesi publik, të cilit i shërben, por pa cenuar interesat apo të drejtat e palëve të treta, mund të lidhë një kontratë administrative, nëse plotësohen këto kushte:

a) forma kontraktore nuk ndalohej shprehimisht nga ligji ose nuk bie në kundërshtim me vetë natyrën e çështjes administrative; dhe

b) organi publik është i autorizuar nga ligji të vendosë për çështjen me diskrecion.

2. Kontrata administrative lidhet në formë të shkruar, përveç rasteve kur ligji parashikon një formë tjetër të posaçme.

3. Kontrata nënshkruhet nga palët apo përfaqësuesit në mënyrë manuale apo elektronike, në përputhje me modalitetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nënshkrimi në emër të organit publik bazohet mbi një autorizim të lëshuar nga organi përkatës.

Neni 120

Kontrata administrative zëvendësuese

1. Organi publik mund të lidhë një kontratë administrative zëvendësuese me palën, së cilës mund t'i drejtonte një akt administrativ, nëse interesi publik realizohet më mirë nëpërmjet kontratës administrative.

2. Në kontratën zëvendësuese, pala tjetër, jo organ publik, detyrohet të kryejë a të mos kryejë një veprim, ose të japë diçka kundrejt kryerjes së një veprimi nga organi publik. Ky detyrim i shërben organit publik për përmbushjen e një funksioni publik administrativ, sipas qëllimit të përcaktuar në kontratë.

3. Në tekstin e kontratës administrative zëvendësuese arsyetohet se interesi publik mbrohet më mirë me lidhjen e kësaj kontrate.

Neni 121

Kontrata administrative ndërmjet organeve publike

Organet publike mund të lidhin ndërmjet tyre kontrata për rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët.

Neni 122

Pavlefshmëria e kontratës administrative

Pavlefshmëria e kontratës administrative rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil që parashikojnë pavlefshmërinë e veprimit juridik. Gjithashtu, kontrata administrative është e pavlefshme në rastet e mëposhtme:

a) nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në nenin 119 të këtij Kodi;

b) nuk janë respektuar kërkesat për lidhjen e kontratës administrative zëvendësuese, të parashikuara në nenin 120 të këtij Kodi.

Neni 123

Ndryshimi, prishja apo tërheqja nga kontrata administrative

1. Nëse, për shkak të rrethanave të shfaqura pas lidhjes së kontratës dhe të paparashikueshme në kohën e lidhjes së saj, vazhdimi i ekzekutimit të detyrimeve të kontratës bëhet shumë i vështirë për njërin nga palët kontraktuese, ato mund të bien dakord për ndryshimin apo prishjen e kontratës.

2. Organi publik mund të tërhiqet nga kontrata administrative në mënyrë të njëanshme për të shmangur ose për të ndaluar cenimin e interesit publik.

3. Tërheqja bëhet me akt administrativ të shkruar dhe të arsyetuar, kundrejt kompensimit të dëmit që i është shkaktuar palës tjetër.

Neni 124

Zbatimi i dispozitave të tjera ligjore

Për çështjet e parregulluara shprehimisht nga ky Kod për kontratën administrative, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë apo të parashikimeve të posaçme ligjore.

Neni 125

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese, që buron nga një kontratë administrative, zgjidhet drejtpërdrejt nga gjykata kompetente për çështjet administrative.



KREU III
VEPRIMET E TJERA ADMINISTRATIVE
NËN REGJIMIN
E SË DREJTËS ADMINISTRATIVE

Neni 126

Veprime të tjera administrative nën regjimin e së drejtës administrative

1. Veprime të tjera administrative, nën regjimin e së drejtës administrative, janë çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, të cilat nuk plotësojnë kriteret për të qenë një akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjellin pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitimë.

2. Veprimi tjetër administrativ, nën regjimin e së drejtës publike, është i ligjshëm nëse është në përputhje me parimet e këtij Kodi dhe brenda kompetencës së organit publik.

KREU IV
KRYERJA E TËRTHORTË E
SHËRBIMEVE PUBLIKE

Neni 127

Kryerja e tërthortë e shërbimeve publike

1. Në rastin e veprimtarisë në funksion të dobishmërisë publike apo të shërbimeve publike, që kryhen nga subjektet private apo ato publike, nën regjimin e së drejtës private, organi rregullator, mbikëqyrës a licencues, sipas ligjit, duhet të sigurojë, nëpërmjet ushtrimit të mbikëqyrjes, vazhdimësinë, universalitetin, koston e pranueshme, cilësinë e përshtatshme të shërbimit, objektivitetin dhe transparencën e procedurave dhe mosdiskriminimin e përfituesit të shërbimit publik.

2. Kryerja e tërthortë e shërbimeve publike nuk duhet t'i ofrojë përfituesit të shërbimit më pak mbrojtje ligjore, në krahasim me situatën kur ky shërbim kryhej drejtpërdrejtë nga organi publik.

PJESA E GJASHTË
MJETET LIGJORE ADMINISTRATIVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 128

Legjitimimi dhe mjetet e ligjore administrative

1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, mjetet ligjore administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë.

3. Mjetet ligjore administrative janë:

a) ankimi administrativ, i cili përfshin:

i) Ankimin administrativ ndaj aktit administrativ ose mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit të brenda afatit të parashikuar dhe/ose veprimit procedural të organit publik gjatë procedurës administrative (Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ); ose

ii) kundërshtimi administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ nën regjimin e së drejtës administrative (Kundërshtimi administrativ);

b) rishikimi.

4. Pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjtën çështje.

Neni 129

Shterimi i mjeteve ligjore administrative

Shterimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, përveç rasteve kur:

a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar drejtpërdrejtë në gjykatë;

c) organi më i lartë në shqyrtimin e ankimit administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një



personi, i cili nuk ka qenë palë në procedurën administrative.

KREU II

ANKIMI ADMINISTRATIV NDAJ AKTIT ADMINISTRATIV

Seksioni 1

Kërkesat formale të ankimit administrativ ndaj aktit administrativ

Neni 130

Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ dhe qëllimi tij

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi administrativ mund të paraqitet ndaj një akti administrativ ose ndaj mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit të brenda afatit të parashikuar.

2. Një veprim procedural i organit publik gjatë procedurës administrative, mund të ankimohet veçmas, vetëm kur ankimi parashikohet shprehimisht nga ligji.

3. Veprimi procedural, sipas pikës 2, të këtij neni, është çdo akt, veprim apo mosveprim i organit publik gjatë procedurës administrative, që nuk është një akt administrativ përfundimtar apo akti administrativ i përfundimit të procedurës administrative, parashikuar në nenin 90 të këtij Kodi.

Neni 131

Përmbajtja e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ

1. Ankimi administrativ ndaj aktit përcakton:

- a) subjektin që ushtron ankimin administrativ;
- b) organin që shqyrton ankimin administrativ;
- c) aktin administrativ, i cili kundërshtohet ose

aktin administrativ të kërkuar, i cili nuk është nxjerrë;

ç) objektin dhe shkaqet për të cilat bëhet ankimi.

2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, çdo kërkesë drejtuar organit publik vlerësohet si ankim administrativ ndaj aktit edhe nëse nuk është emërtuar shprehimisht si i tillë. Në këtë rast, qëllimi për t'u ankuar ndaj një akti administrativ, apo për të kërkuar nxjerrjen e një akti, duhet të jetë mjaftueshëm i qartë.

Neni 132

Afatet e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ

1. Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrativ.

2. Në rastin e mosveprimit administrativ, me përjashtim kur miratimi në heshtje është i zbatueshëm, ankimi duhet të paraqitet jo më parë se 7 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e përfundimit të afatit të caktuar ose të shtyrë, për përfundimin e procedurës administrative.

Neni 133

Efektet e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi administrativ ndaj aktit, i paraqitur në përputhje me kërkesat e neneve 130-132, të këtij Kodi, pezullon ekzekutimin e aktit deri në njoftimin e vendimit të ankimit.

2. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjtë, ankimi administrativ ndaj aktit të paraqitur nga njëra nga palët, i shtrin efektet e pezullimit ndaj të gjitha palëve të përfshira.

3. Zbatimi i aktit administrativ ndaj aktit nuk pezullohet kur:

a) akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera buxhetore;

b) akti administrativ ka të bëjë me masa policore;

c) organi publik, i cili shqyrton ankimin, vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe të interesave të tjerë publikë.

4. Kundër aktit që vendos ndalimin e efektit pezullues të ankimit, mund të bëhet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Neni 134

Organi të cilit i drejtohet ankimi

1. Përveçse kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi ndaj një akti administrativ mund t'i drejtohet organit publik që:



a) ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin;

b) organit publik epror të organit të parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni; ose

c) një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj.

2. Nëse ankimi i është drejtuar njërit prej organeve të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, ato ia përcjellin pa vonesë organit kompetent.

3. Ankimi ndaj mosveprimit administrativ mund t’i drejtohet drejtpërdrejt organeve të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni. Nëse ankimi i është drejtuar organit të parashikuar në shkronjën “a”, të këtij neni, ai ia përcjell, pa vonesë, një prej organeve të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, së bashku me dosjen e çështjes dhe një raport të shkruar për arsyet e heshtjes.

Neni 135

Kushtet për pranimin e ankimit

Ankesa është e pranueshme nëse plotëson këto kushte:

a) nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji;

b) ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 128 të këtij Kodi;

c) është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 132 i këtij Kodi; dhe

ç) çfarëdo kushti tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Seksioni 2

Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ ndaj aktit

Neni 136

Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent

1. Ankimi ndaj një akti administrativ shqyrtohet, në radhë të parë, nga vetë organi publik kompetent, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

2. Organi publik kompetent fillimisht shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar. Nëse është e nevojshme, organi publik

kompetent mund të kryejë hetime administrative shtesë.

3. Nëse anulimi, shfuqizimi ose ndryshimi i aktit administrativ të ankimuar apo nxjerrja e aktit të refuzuar do t’i shkaktonte dëm një pale tjetër, organi kompetent duhet t’i japë asaj mundësinë për t’u dëgjuar, sipas neneve 87 dhe 88, të këtij Kodi, përpara marrjes së vendimit për ankimin e paraqitur.

4. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, ai me një akt të ri administrativ anulon, shfuqizon ose ndryshon aktin e ankimuar, ose përkatësisht nxjerr aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala.

5. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi nuk është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, pa vonesë dhe pa u shprehur mbi të, e përcjell atë për shqyrtim dhe vendimmarrje tek organi epror, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të dosjes dhe një raport me shkrim të qëndrimit të tij.

Neni 137

Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi epror

1. Në rastin e parashikuar nga pika 5, e nenit 136, të këtij Kodi, organi epror shqyrton ankimin e përcjellë nga organi kompetent dhe, nëse është e nevojshme, zhvillon hetime shtesë, apo urdhëron organin kompetent që të zhvillojë hetime shtesë dhe të njoftojë për to. Pikat 2 dhe 3, të këtij neni, zbatohen edhe në këtë rast.

2. Organi epror, me akt administrativ, refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar.

3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese e aktit administrativ të ankimuar është e ligjshme, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai refuzon ankimin dhe paraqet arsyetimin e ri.

4. Nëse organi epror vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, ai vendos përfundimisht me një akt të ri duke anuluar, shfuqizuar apo ndryshuar, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, ose përkatësisht duke nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.



5. Nëse nuk është parashikuar shprehimisht ndryshe nga ligji, akti i organit epror mund të jetë vetëm në dobi të palës ankuese.

Neni 138

Ankimi ndaj mosveprimit administrativ

1. Ankimi ndaj mosveprimit administrativ shqyrtohet drejtpërdrejtë nga organi epror. Organi epror i kërkon menjëherë organit kompetent, që pa vonesë të paraqesë dosjen e çështjes dhe një raport me shkrim mbi arsyet e heshtjes administrative.

2. Organi epror, fillimisht, shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, vendos mbi kërkesën e palës, siç i është parashtruar organit kompetent.

3. Organi epror vendos mbi kërkesën në bazë të dosjes së çështjes apo, nëse është e nevojshme, zhvillon hetime administrative shtesë, apo urdhëron organin kompetent që të zhvillojë këto hetime shtesë dhe ta njoftojë për rezultatet e hetimit.

4. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, organi epror zgjidh çështjen duke nxjerrë një akt përfundimtar.

Neni 139

Përmbajtja dhe pasojat e aktit që zgjidh ankimin

1. Përveç kërkesave të nenit 100 të këtij Kodi, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankimin, përmban edhe një vlerësim të të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankim.

2. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe me ligj, akti që zgjidh ankimin ka pasoja juridike në të kaluarën. Pikat 2 dhe 3, të nenit 114, të këtij Kodi, zbatohen për sa është e mundur edhe në këtë rast.

Neni 140

Afati për njoftimin e aktit që zgjidh ankimin

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ që zgjidh ankimin nxirret dhe i njoftohet palës brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit.

2. Afati i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të zgjatet kur është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë. Neni 92, i këtij Kodi, zbatohet gjithashtu për shtyrjen e afatit të parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Neni 93, i këtij Kodi, nuk zbatohet në rastin e ankimit administrativ.

KREU III

KUNDËRSHTIMI ADMINISTRATIV

Neni 141

Objekti i kundërshtimit administrativ

1. Në rastin e kundërshtimit administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ, nën regjimin e së drejtës administrative, pala mund të kërkojë nga organi publik:

a) ndalimin e kryerjes së një veprimi tjetër administrativ;

b) kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, për të cilin pala ka të drejtë, nëse ky veprim është kërkuar nga pala, por organi publik nuk ka vepruar;

c) tërheqjen apo ndryshimin e një deklarate publike;

ç) shpalljen të paligjshëm të një veprimi tjetër administrativ dhe ndreqjen e pasojave të shkaktuara prej tij.

2. Pala, në rastin e kundërshtimit administrativ për kryerjen e tërthortë të shërbimeve të dobishmërisë publike dhe të shërbimeve të tjera publike, mund të kërkojë ushtrimin e funksioneve rregullatore apo të mbikëqyrjes nga organi rregullator, mbikëqyrës apo licencues, me qëllim përfitimin nga pala kundërshtuese të një shërbimi, për të cilën ka të drejtë sipas ligjit, dhe respektimin nga subjekti privat apo publik të detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 127, të këtij Kodi.

Neni 142

Përmbajtja e kundërshtimit administrativ dhe afati

1. Neni 131, i këtij Kodi, zbatohet, për aq sa është e mundur, për formën e kundërshtimit administrativ.

2. Kundërshtimi administrativ paraqitet brenda 15 ditëve nga data që pala ka marrë dijeni për faktin të cilin e kundërshton.

Neni 143

Shqyrtimi i kundërshtimit administrativ

1. Kundërshtimi administrativ, në rastin e kryerjes së tërthortë të shërbimeve publike, i drejtohet dhe shqyrtohet nga organi publik rregullator, mbikëqyrës, apo licencues. Pala e



ankimuar vihet në dijeni pa vonesë për masat e marra nga ky organ.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjat “a”, “c” e “ç”, të nenit 141, të këtij Kodi, kundërshtimi i drejtohet dhe shqyrtohet nga organi kompetent.

3. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të nenit 141, të këtij Kodi, kundërshtimi i drejtohet dhe shqyrtohet nga organi epror. Nëse organi epror vendos në favor të palës, ai i cakton organit kompetent një afat për kryerjen e veprimit tjetër administrativ të kërkuar.

4. Vendimi i shqyrtimit të kundërshtimit merret dhe i njoftohet palës brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tij. Kundër vendimit mund të ngrihet padi drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

KREU IV RISHIKIMI

Neni 144 Rishikimi

1. Rishikimi është mjeti ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod.

2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk diheshin dhe mund të diheshin prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.

Neni 145 Afati kohor dhe paraqitja

1. Kërkesa për rishikim duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se 2 vjet nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit.

2. Kërkesa i dorëzohet organit që ka nxjerrë apo ka refuzuar aktin administrativ, i cili kërkohet që të rishikohet.

Neni 146 Vendimi për rishikimin

Organi që ka nxjerrë ose ka refuzuar aktin administrativ, kur konstaton se akti administrativ

ose refuzimi administrativ do të ishin të paligjshëm, nëse do të nxirrej në rrethanat aktuale mbizotëruese, përkatësisht e anulon aktin, e ndryshon atë, ose nxjerr aktin e refuzuar. Në rast të kundërt, rishikimi refuzohet.

PJESA E SHTATË NJOFTIMI

KREU I RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË NJOFTIMIT

Neni 147 Njoftimi i përshtatshëm

1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit.

2. Në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të vendosë mënyrën e duhur të njoftimit të veprimeve administrative apo ndonjë njoftim tjetër, në kuadrin e procedurës administrative, shqyrtimit të mjeteve ligjore administrative ose procedurës së ekzekutimit të aktit administrativ.

3. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston.

Neni 148 Format e njoftimit

1. Njoftimi, kur pala është e pranishme, mund të bëhet verbalisht, apo në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të njoftimit.

2. Një dokument i shkruar mund të njoftohet nëpërmjet dërgimit me postë, mjeteve elektronike, faks apo njoftimit formal, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

Neni 149 Marrësi i njoftimit

1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kod, njoftimi i bëhet palës personalisht. Përgjithësisht, kur organi publik është njoftuar për caktimin e një përfaqësuesi ose personit përgjegjës për njoftimet, njoftimi i bëhet këtij të fundit.



2. Njoftimi që i bëhet përfaqësuesit ose personit përgjegjës të njoftimeve, vlerësohet se i është bërë personalisht palës.

Neni 150

Personi përgjegjës për njoftimet

1. Në rast se 20 apo më shumë palë, me kërkesa të njëjta, nuk kanë një përfaqësues të përbashkët, ato me kërkesë të organit publik, janë të detyruara të caktojnë një person përgjegjës të përbashkët për njoftimet, brenda një afati të përcaktuar nga organi publik.

2. Nëse personi përgjegjës për njoftimet nuk përcaktohet brenda afatit, organi publik cakton si person përgjegjës për njoftimin një nga palët, pasi të ketë marrë miratimin e tij. Në çdo rast, caktimi i personit përgjegjës për njoftimin kryhet në përputhje me procedurën e parashikuar në pikën 2, të nenit 38, të këtij Kodi.

3. Në aktin që i njoftohet personit përgjegjës të përbashkët për njoftimet përcaktohen të gjitha palët, të cilave u drejtohet njoftimi.

Neni 151

Vendi i njoftimit

1. Njoftimi bëhet në:

- a) vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit;
 - b) çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
 - c) selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik;
 - ç) vendin e punës;
 - d) vendin e ushtrimit të veprimtarisë ose zyrën e marrësit;
 - dh) çdo vend tjetër, i specifikuar dhe i njoftuar paraprakisht nga pala.
2. Pika 1 zbatohet për aq sa është e mundur edhe në rastet e njoftimit të përfaqësuesit të palës ose personit përgjegjës për njoftimet.

Neni 152

Njoftimi ndërkombëtar

Njoftimi për shtete të huaja, organizatat ndërkombëtare, apo personat që gëzojnë imunitet diplomatik, bëhet nëpërmjet institucionit që mbulon çështjet e jashtme, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Neni 153

Njoftimi në raste të posaçme

1. Njoftimi i personave që ndodhen në shërbim në Forcat e Armatosura ose në njësitë e ministrisë që mbulon çështjet e brendshme, bëhet nëpërmjet administratës së tyre.

2. Njoftimi i personave të privuar nga liria në vendet e ndalimit ose institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, bëhet nëpërmjet administratës së institucionit përkatës ku ndodhet personi. Në çdo rast, administrata e institucionit duhet të dokumentojë marrjen e njoftimit.

Neni 154

Gabimi në njoftim

Nëse palës marrëse, për shkak të një gabimi në kryerjen e njoftimit të bërë nga organi publik, i shkaktohet përkeqësim i situatës ligjore, njoftimi vlerësohet se është bërë në ditën kur marrësi provon se ka marrë dijeni për njoftimin.

KREU II

MËNYRAT DHE MJETET E NJOFTIMIT

Seksioni 1

Njoftimi me postë dhe mjete elektronike

Neni 155

Njoftimi nëpërmjet postës

1. Njoftimi me postë bëhet nëpërmjet postës së thjeshtë apo të porositur.

2. Për efekt të këtij Kodi, një shkresë, dërguar me postë të thjeshtë apo të porositur, vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e postimit të dokumentit për adresat brenda Republikës së Shqipërisë, dhe ditën e pestë për adresat jashtë territorit të vendit.

3. Pika 2, e këtij neni, nuk zbatohet nëse marrësi provon se dokumenti nuk është marrë, apo është marrë në një ditë të mëvonshme.

Neni 156

Njoftimi nëpërmjet mjeteve elektronike

1. Njoftimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik apo me faks bëhet kur marrësi ka rënë paraprakisht dakord për këtë mënyrë njoftimi dhe nëse ligji nuk parashikon një formë tjetër të detyrueshme njoftimi. Nëse njoftimi është i palexueshëm, marrësi mund t'i



kërkojë organit publik ta ridërgojë njoftimin në një formë tjetër më të përshtatshme.

2. Një shkresë, dërguar me mjete të komunikimit elektronik, vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e ligjit për komunikim elektronik.

3. Një shkresë e dërguar me faks vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e dërgimit.

4. Pikat 2 dhe 3, të këtij neni, nuk zbatohen nëse marrësi provon se shkresa nuk është marrë, apo është marrë në një datë të mëvonshme.

Seksioni 2 Njoftimi formal

Neni 157 Njoftimi formal

Njoftimi i një shkrese mund të bëhet edhe nëpërmjet njoftimit formal, në rastet kur kjo parashikohet shprehimisht nga ligji, apo kur vendoset nga vetë organi publik.

Neni 158 Mënyrat e njoftimit formal

Njoftimi formal bëhet nëpërmjet dorëzimit personalisht, njoftimit nëpërmjet të tretit apo postës, si dhe nëpërmjet publikimit elektronik, njoftimit publik apo botimit zyrtar, sipas parashikimeve të neneve 159 deri në 163 të këtij Kodi.

Neni 159 Dorëzimi personalisht

1. Nëpunësi i organit publik i dorëzon personalisht shkresën marrësit në një nga vendet e njoftimit të parashikuara nga ky Kod. Dorëzimi personalisht pasqyrohet në një procesverbal. Procesverbali përfshin të dhënat për identifikimin e shkresës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga nëpunësi dhe marrësi.

2. Nëse marrësi nuk gjendet në vendin e njoftimit, nëpunësi i organit publik bën një përpjekje të dytë për dorëzimin personalisht, jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 72 orë nga përpjekja e parë.

3. Kur marrësi nuk gjendet përsëri apo kur ai refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi bën

shënimin përkatës në një procesverbal dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast, nëpunësi i organit publik vendos një shënim në mjediset e vendit të njoftimit, duke përcaktuar marrësin dhe zyrën përkatëse në organin publik ku mund të tërhiqet shkresa. Në shënim përcaktohet data dhe ora e lënies së shënimit, dhe data që vlerësohet si data e kryerjes së njoftimit sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni.

4. Dorëzimi, sipas pikës 3, të këtij neni, vlerësohet i kryer pas 3 ditëve nga data e vendosjes së shënimit.

5. Dorëzimi bëhet vetëm gjatë ditëve të punës, nga ora 7⁰⁰ deri në 19⁰⁰.

Neni 160 Njoftimi nëpërmjet të tretit

1. Kur nuk është i mundur njoftimi, sipas nenit të mësipërm, dhe marrësi nuk gjendet, nëpunësi i organit publik bën dorëzimin nëpërmjet një të tretit, që pranon t'ia dorëzojë njoftimin marrësit, sipas kësaj radhe preference:

a) një personi të familjes që ka mbushur moshën 16 vjeç, në vendin e njoftimit të parashikuar në nenin 151, pika 1, shkronja “a”, e këtij Kodi;

b) një fqinji madhor, në vendin e njoftimit, të parashikuar në nenin 151, pika 1, shkronja “a”, e këtij Kodi;

c) një punonjësi apo portierit, në vendin e njoftimit, të parashikuar në nenin 151, pika 1, shkronjat “c” deri në “d”, të këtij Kodi.

2. Dorëzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mund të bëhet nëpërmjet një personi që merr pjesë në të njëjtën procedurë dhe ka interesa të kundërt me marrësin.

3. Personi i tretë, që pranon të bëjë dorëzimin, nënshkruan procesverbal, ku merr përsipër t'ia dorëzojë njoftimin personit të thirrur. Nëpunësi publik pasqyron në procesverbal të dhënat lidhur me marrëdhënien e personit të tretë me marrësin, të dhënat për identifikimin e shkresës së dorëzuar dhe datën e dorëzimit personit të tretë.

4. Nëse personi i tretë refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi bën shënimin përkatës në një procesverbal dhe, kur është e mundur, e vërteton



refuzimin me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.

5. Në rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij neni, shkresa lihet në kutinë postare të vendbanimit apo të vendqëndrimit të marrësit. Data dhe ora e lënies në kutinë postare dhe data, e cila vlerësohet si dita e kryerjes së njoftimit, sipas pikave 6 dhe 7, të këtij neni, shënohen nga nëpunësi në zarin e shkresës dhe reflektohen në procesverbalin përkatës.

6. Dorëzimi vlerësohet i bërë pas 3 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të shkresës nga personat e tretë ose nga data e lënies në kutinë postare.

7. Dorëzimi, sipas këtij neni, bëhet vetëm gjatë ditëve të punës, nga ora 7⁰⁰ deri në 19⁰⁰.

Neni 161

Njoftimi nëpërmjet publikimit elektronik

1. Njoftimi mund të bëhet nëpërmjet publikimit në një regjistër elektronik, të hapur për publikun, në rastin e parashikuar nga ligji i posaçëm dhe vetëm nëse marrësi është vënë në dijeni paraprakisht për datën e saktë kur bëhet publikimi.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, vlerësohet si i bërë në datën e përcaktuar për publikimin vetëm nëse dokumenti është publikuar faktikisht në atë datë.

3. Njoftimi i një dokumenti elektronik mund të bëhet edhe nëpërmjet shkarkimit nga një server i caktuar, i mbyllur për publikun, vetëm nëse palës i sigurohet, paraprakisht, akses nëpërmjet mjeteve elektronike autentike të identifikimit, dhe nëse ajo është vënë në dijeni me një njoftim paraprak për datën, apo periudhën e saktë kur dokumenti mund të shkarkohet.

4. Njoftimi, sipas pikës 3, të këtij neni, vlerësohet si i bërë në datën e shkarkimit të tij nga serveri. Nëse shkresa nuk është shkarkuar në datën e përcaktuar, organi publik i dërgon palës një njoftim të dytë. Nëse shkresa nuk është shkarkuar në datën e caktuar në njoftimin e dytë, ajo njoftohet në një mënyrë tjetër të përshtatshme.

Neni 162

Njoftimi publik

1. Njoftimi publik bëhet në këto raste:

a) kur palët janë të panjohura;

b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi;

c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur;

ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji.

2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet.

3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetat me tirazh më të madh.

5. Në rastin e njoftimit të një akti administrativ, teksti i shpallur përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 99, të këtij Kodi, me përjashtim të pjesës arsyetuese. Ai shoqërohet me të dhëna për zyrën, vendin dhe mënyrën e njohjes me përmbajtjen e plotë të aktit administrativ.

Neni 163

Botimi zyrtar

1. Njoftimi nëpërmjet botimit në Fletoren Zyrtare ose në buletinet e njoftimeve zyrtare është i detyrueshëm kur:

a) njoftimi i drejtohet një grupi personash, anëtarët e të cilit janë ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme dhe çdo formë tjetër njoftimi vlerësohet si e pamundur apo e papërshtatshme; ose

b) parashikohet shprehimisht në ligj.

2. Neni 162, pika 5, e këtij Kodi, zbatohet për aq sa është e mundur edhe për botimin zyrtar.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj, njoftimi, sipas këtij neni, vlerësohet i kryer brenda 10 ditëve nga data e botimit.



PJESA E TETË
EKZEKUTIMI I AKTIT ADMINISTRATIV

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Neni 164

Akti i ekzekutueshëm

1. Akti administrativ mund të ekzekutohet vetëm pasi ka hyrë në fuqi.

2. Akti administrativ fillon të ekzekutohet:

a) pas përfundimit të afatit të ankimit administrativ, nëse nuk është bërë ankim;

b) pas njoftimit të aktit administrativ, në qoftë se ankimi administrativ nuk lejohet;

c) pas njoftimit të aktit administrativ, në qoftë se, sipas ligjit, ankimi administrativ nuk ka efekt pezullues;

ç) pas njoftimit të vendimit për heqjen e efektit pezullues të ankimit, në përputhje me nenin 133 të këtij Kodi;

d) pas njoftimit të vendimit që zgjidh ankimin, nëse ky i fundit e ka refuzuar apo nuk e ka pranuar apelimin.

3. Vendimi organit publik, i cili ndryshon aktin e ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm pasi i njoftohet palës.

Neni 165

Parimet e ekzekutimit të detyrueshëm

1. Përveç rasteve të ekzekutimit të menjëhershëm, të parashikuara në nenin 179, të këtij Kodi, organi publik nuk mund të kryejë asnjë veprim ekzekutimi përveçse në zbatim të një akti administrativ, i cili është bërë i ekzekutueshëm sipas këtij Kodi.

2. Ekzekutimi i akteve administrative realizohet me mënyrën dhe mjetet e ekzekutimit, të cilat garantojnë ekzekutimin, duke shkaktuar dëmin më të vogël të mundshëm ndaj të drejtave dhe interesave të ligjshëm të subjektit, ndaj të cilit kryhet ekzekutimi.

Neni 166

Aktet që nuk mund të ekzekutohen

Përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, akti administrativ i ekzekutueshëm, sipas nenit 164, të këtij Kodi, nuk ekzekutohet nëse:

a) efekti i tij është pezulluar në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) kundër tij është bërë një ankim me efekt pezullues;

c) kanë kaluar 5 vjet nga data në të cilin akti është bërë i ekzekutueshëm.

Neni 167

Organi kompetent për ekzekutim të detyrueshëm

Përveçse kur ligji parashikon shprehimisht një organ tjetër, ekzekutimi i detyrueshëm është në kompetencën e organit publik që ka nxjerrë aktin fillestar, pavarësisht nëse ai është ndryshuar apo zëvendësuar nga organi epror, si pasojë e ankimit administrativ, apo nga gjykata.

Neni 168

Subjekti i ekzekutimit

Ekzekutimi kryhet ndaj palës, e cila duhet të përmbushë detyrimin, sipas aktit administrativ që ekzekutohet, apo edhe ndaj trashëgimtarëve të palës, nëse detyrimi nuk ka karakter ngushtësisht personal.

KREU II

EKZEKUTIMI VULLNETAR I AKTIT ADMINISTRATIV

Neni 169

Njoftimi për ekzekutimin vullnetar

1. Përveç rasteve të ekzekutimit të menjëhershëm, sipas nenit 179, të këtij Kodi, organi publik kompetent i dërgon subjektit të ekzekutimit një njoftim për të ekzekutuar detyrimin, sipas aktit administrativ, dhe i lë atij një afat të arsyeshëm.

2. Njoftimi i ekzekutimit vullnetar bëhet në formë të shkruar dhe i dërgohet formalisht subjektit të ekzekutimit.

Neni 170

Përmbajtja e njoftimit vullnetar

Njoftimi për ekzekutimin vullnetar duhet të përmbajë:

a) një shkurtim të aktit administrativ që do të ekzekutohet;

b) një informacion mbi mënyrën e ekzekutimit



dhe të dhëna të tjera të nevojshme për ekzekutimin;

c) paralajmërimin që i bëhet subjektit të ekzekutimit që në rastet e mosekzekutimit vullnetar, brenda afatit të caktuar në njoftim, fillon ekzekutimi i detyrueshëm.

KREU III

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM I AKTIT ADMINISTRATIV

Neni 171

Koha e ekzekutimit të detyrueshëm

Ekzekutimi i detyrueshëm në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, si dhe ekzekutimi ndërmjet orës 19⁰⁰ - 7⁰⁰ mund të kryhet vetëm në rast urgjence nëse, si pasojë e mosekzekutimit, cenohet interesi publik, bazuar në një urdhër me shkrim të arsyetuar të organit kompetent për ekzekutimin.

Neni 172

Njoftimi për ekzekutimin e detyrueshëm

1. Përveç rasteve të ekzekutimit të menjëhershëm, sipas nenit 179, të këtij Kodi, nëse detyrimi nuk zbatohet vullnetarisht, organi publik kompetent njofton subjektin e ekzekutimit për ekzekutimin e detyrueshëm.

2. Njoftimi i ekzekutimit vullnetar bëhet në formë të shkruar, i njoftohet formalisht subjektit të ekzekutimit dhe përbën akt administrativ.

3. Nëse paraqitja e ankimit nuk ka efekt pezullues, sipas ligjit të posaçëm ose nëse gjatë procedurës administrative rezulton qartazi se pala nuk e përmbush vullnetarisht detyrimin, njoftimi është pjesë e vetë aktit administrativ që ekzekutohet.

Neni 173

Përmbajtja e njoftimit për ekzekutimin e detyrueshëm

1. Njoftimi për ekzekutimin e detyrueshëm duhet të përmbajë:

a) një shkurtim të aktit administrativ që do të ekzekutohet;

b) datën dhe orën e planifikuar për kryerjen e ekzekutimit.

c) një informacion mbi mënyrën e ekzekutimit dhe të dhëna të tjera të nevojshme për ekzekutimin.

2. Në rastin kur ekzekutimi i detyrueshëm bëhet në përputhje me nenin 176, të këtij Kodi,

njoftimi përmban, nëse është e mundur, edhe shumën e shpenzimeve të ekzekutimit.

Neni 174

Ekzekutimi i detyrueshëm i detyrimeve në të holla

Ekzekutimi i detyrimeve në të holla kryhet nga organi publik kompetent, sipas dispozitave të ligjit që rregullon procedurat tatimore dhe ligjit për kundërvajtjet administrative, të cilat zbatohen, për aq sa është e mundur.

Neni 175

Ekzekutimi i detyrimeve jofinanciare

1. Detyrimet jofinanciare janë ato detyrime që kanë të bëjnë me kryerjen e një veprimi, lejimin e kryerjes së një veprimi apo ndalimin e kryerjes së një veprimi nga subjekti i ekzekutimit, me përjashtim të pagesës në të holla.

2. Ekzekutimi i detyrueshëm i detyrimeve jofinanciare kryhet nëpërmjet njërit prej instrumenteve të ekzekutimit, të parashikuara në nenet 176 deri në 178 të këtij Kodi.

Neni 176

Ekzekutimi i detyrimeve jofinanciare nëpërmjet të tretëve

1. Organi publik kompetent për ekzekutimin mund të ngarkojë një person të tretë për përmbushjen e detyrimeve jofinanciare nëse:

a) detyrimi jofinanciar është një veprim i një natyre të tillë, që mund të përmbushet nga një person i tretë;

b) subjekti i ekzekutimit nuk e ka përmbushur apo e ka përmbushur pjesërisht detyrimin jofinanciar.

2. Përmbushja e detyrimit nga personi i tretë bëhet me shpenzimet e subjektit të ekzekutimit.

3. Organi publik kompetent për ekzekutimin llogarit shpenzimet dhe urdhëron subjektin e ekzekutimit të depozitojë paraprakisht shumën e nevojshme për mbulimin e tyre.

4. Detyrimi, sipas pikës 3, të këtij neni, ekzekutohet në përputhje me rregullat për ekzekutimin e detyrimeve financiare, nëse subjekti i ekzekutimit nuk e depoziton shumën e shpenzimeve të ekzekutimit.



Neni 177

Detyrimi për bashkëpunim

1. Nëse përmbushja e detyrimit jofinanciar nuk mund të arrihet, sipas parashikimeve të nenit 176, të këtij Kodi, dhe subjekti i ekzekutimit nuk e ka përmbushur plotësisht ose pjesërisht këtë detyrim, organi publik kompetent zbaton forcërisht detyrimin jofinanciar, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionin në fuqi.

2. Policia e Shtetit mbështet organin publik për ekzekutimin e detyrimeve jofinanciare, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 178

Ekzekutimi i vendimeve të ndërmjetme

1. Ekzekutimi i vendimeve të ndërmjetme, në zbatim të nenit 67, të këtij Kodi, që parashikon detyrime jofinanciare, kryhet në përputhje me dispozitat e neneve 176 dhe 177, të këtij Kodi, edhe përpara bërjes së aktit të ekzekutueshëm.

2. Njoftimi i ekzekutimit, në rastin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, është pjesë e aktit që urdhëron marrjen e masës përkatëse.

3. Detyrimet, sipas vendimeve të ndërmjetme, ekzekutohen brenda 3 ditëve nga nxjerrja e aktit.

Neni 179

Ekzekutimi i menjëhershëm

1. Organi publik mund të ushtrojë në mënyrë përjashtimore një nga mënyrat e ekzekutimit të detyrueshëm, të parashikuara në nenet 176 dhe 177, të këtij Kodi, edhe pa nxjerrë paraprakisht një akt administrativ, nëse përmbushen të tre kushtet e mëposhtme:

a) është e nevojshme marrja e një mase urgjente për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, apo shmangur kërcënime a rreziqe të menjëhershme për jetën, shëndetin, apo pronën e personave;

b) për shkak të urgjencës ekstreme për marrjen e masës, akti administrativ, që urdhëron plotësimin e një detyrimi jofinanciar, nuk mund të nxirret në kohë;

c) nuk mund të gjendet menjëherë pala, apo përfaqësuesi, të cilit do t'i drejtohet akti, për urdhërimin e plotësimit të një detyrimi jofinanciar.

2. Me kërkesë të palës së cenuar nga ekzekutimi i masës urgjente dhe brenda 8 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, organi publik duhet të nxjerrë një akt në formë të shkruar, që konfirmon veprimin e kryer. Në çdo rast, kërkesa e palës mund të bëhet jo më vonë se 60 ditë nga data e ekzekutimit.

KREU IV

PEZULLIMI, PUSHIMI DHE ANKIMIMI I EKZEKUTIMIT

Neni 180

Pezullimi i ekzekutimit

1. Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur:

a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkaktimit të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin publik;

b) gjykata kompetente për çështjet administrative ka vendosur pezullimin e zbatimit të aktit, sipas dispozitave të legjislacionit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative;

c) ekzekutimi është kryer apo është duke u kryer ndaj një subjekti që nuk detyrohej;

c) sipas ligjit, ekzekutimi nuk lejohet;

d) në rastet e tjera, të parashikuara nga ligji.

2. Në të gjitha rastet, organi publik arsyeton vendimin e tij për pezullimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Neni 181

Pushimi i ekzekutimit

Ekzekutimi i detyrueshëm pushon në rastet kur:

a) subjekti i ekzekutimit e ka përmbushur detyrimin;

b) akti administrativ, që përbënte bazën e ekzekutimit, është shfuqizuar apo anuluar;

c) në rastet e tjera, të parashikuara nga ligji.

Neni 182

Shtyrja e ekzekutimit

Ekzekutimi i detyrueshëm shtyhet në rastet kur:

a) organi publik ka vendosur shtyrjen e tij për një afat të caktuar;



b) një akt tjetër zëvendëson aktin që ekzekutohet;

Neni 183

Pasojat e ekzekutimit të aktit të shfuqizuar ose të anuluar

1. Kur ekzekutimi vullnetar apo i detyrueshëm është kryer dhe akti është shfuqizuar ose anuluar më pas, subjekti i ekzekutimit ka të drejtë të kërkojë rikthimin në gjendjen e mëparshme apo gjendjen përkatëse, sipas aktit të ri.

2. Kërkesa shqyrtohet nga organi publik kompetent për ekzekutimin, me kërkesë të palës që ka qenë subjekt i ekzekutimit.

Neni 184

Ankimi ndaj veprimeve të ekzekutimit

1. Ndaj njoftimit për ekzekutim mund të bëhet ankim në përputhje me dispozitat e këtij Kodi. Ankimi shqyrtohet drejtpërdrejt nga organi epror i organit kompetent për ekzekutimin, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes. Ankimi mund të bëhet vetëm për mënyrën e ekzekutimit të zgjedhur dhe nuk ka efekt pezullues.

2. Pala mund të ankohet në organin epror të organit kompetent për ekzekutimin, kur veprimet e kryera për ekzekutimin e detyrueshëm tejkalojnë pjesën urdhëruese të aktit që ekzekutohet ose kur këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të këtij Kodi. Paraqitja e ankimit nuk ka efekt pezullues dhe ai shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së tij.

3. Përfundimisht, në rast se vazhdimi i ekzekutimit mund të përbëjë një kërcënim për shëndetin, jetën apo për pronën, pala mund t'i drejtohet drejtpërdrejtë gjykatës kompetente për çështjet administrative.

**PJESA E NËNTË
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË
FUNDIT**

Neni 185

Dispozitë kalimtare

Për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 186

Aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi:

a) Këshilli i Ministrave miraton aktet e përcaktuara në pikën 7, të nenit 59, dhe në pikën 3, të nenit 76, të këtij Kodi.

b) Organet publike miratojnë rregullat e brendshme të punës në zbatim të dispozitave të këtij Kodi.

Neni 187

Referencat në legjislacionin në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, çdo referim që dispozitat ligjore dhe nënligjore bëjnë në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, apo dispozita të veçanta të tij, vlerësohet si e bërë në këtë Kod, për aq sa është e mundur.

Neni 188

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi:

a) ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

b) Çdo dispozitë ligjore dhe nënligjore që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi shfuqizohet.

Neni 189

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9112, datë 22.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani





